

Anëtarësimi në

BASHKIMIN EVROPIAN:

**PËR ÇKA DO TË
NEGOCIOJMË ?**



ANËTARËSIMI NË
BASHKIMIN EVROPIAN:

PËR ÇKA DO TË NECOCIOJMË?

Shkup, 2010

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian: Për çka do të negociojmë?

Boton:

Fondacioni Instituti shoqëria e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vlladimir Millçin, drejtor ekzekutiv

Autorë:

Qendra maqedonase për arsim evropian

Përkthimi:

Abacus

Formësimi artistik-grafik:

Brigada dizajn

Shtyp:

Bato&Divajn

Tirazhi: 300 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

321.728 (497.7)

316.422 (497.7:4-672 EU)

ANËTARËSIMI në bashkimin Evropian : Për çka do të negociojme. -

Shkup : Fondacioni instituti shoqëria e hapur - Maqedoni, 2010. -

176 str.: ilustr.; 20cm

ISBN 978-608-218-050-2

а) Општествено-политички реформи - Македонија - Усогласување -

Европска унија

COBISS.MK-TD 81706250

PËRMBAJTJA:

KAPITULLI 1	7
LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE	
KAPITULLI 2	11
LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	
KAPITULLI 3	17
LIRIA E LËVIZJES SË SHËRBIMEVE	
KAPITULLI 4	23
LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	
KAPITULLI 5	27
FURNIZIMET PUBLIKE	
KAPITULLI 6	31
E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE	
KAPITULLI 7	37
E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE	
KAPITULLI 8	41
POLITIKA E KONKURENCËS	
KAPITULLI 9	47
SHËRBIMET FINANCIARE	
KAPITULLI 10	51
SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT	
KAPITULLI 11	55
BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL	
KAPITULLI 12	61
POLITIKA FITO-SANITARE	
KAPITULLI 13	67
PESHKATARIA	
KAPITULLI 14	73
POLITIKA E TRANSPORTIT	
KAPITULLI 15	77
ENERGJIA	
KAPITULLI 16	83
TATIMET	
KAPITULLI 17	87
UNIONI EKONOMIK DHE MONETAR	

KAPITULLI 18	93
STATISTIKA	
KAPITULLI 19	97
POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI	
KAPITULLI 20	101
NDËRMARRJET DHE PRONËSIA INDUSTRIALE	
KAPITULLI 21	105
RRJETET TRANS-EVROPIANE	
KAPITULLI 22	109
POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI	
KAPITULLI 23	115
GJYQËSIA DHE DREJTËSIA THEMELORE	
KAPITULLI 24	119
DREJTËSIA, SIGURIA DHE LIRIA	
KAPITULLI 25	125
SHKENCA DHE HULUMTIMI	
KAPITULLI 26	129
ARSIMI DHE SHKENCA	
KAPITULLI 27	133
MJEDISI JETËSOR	
KAPITULLI 28	137
MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE E SHËNDETIT	
KAPITULLI 29	143
UNIONI DOGANOR	
KAPITULLI 30	150
MARRËDHËNIET E JASHTME	
KAPITULLI 31	155
POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES	
KAPITULLI 32	159
KONTROLLI FINANCIAR	
KAPITULLI 33	163
DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE	
KAPITULLI 34	167
INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN	
KAPITULLI 35	173
PËR ÇËSHTJET TJERA	

Qendra maqedonase për arsim evropian (QMAE) punon për nxitje të procesit të integritit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian nëpërmjet trajnimit profesional, konsultimit, bashkëpunimit rajonal, lobimit për ndryshime dhe zhvillimit të politikave aplikative. Një pjesë e madhe e aktiviteteve të QMAE-së kanë të bëjnë me promovimin e vlerave evropiane dhe të përfitimeve nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Kjo broshurë është përpiluar për nevojat e projektit “Aksioni për Evropë”, të realizuar në partneritet me Fondacionin Instituti shoqëria e hapur - Maqedoni (ISHHM) dhe Forumit rinor arsimor (FRA), i cili parasheh promovim të BE-së në nivel lokal nëpërmjet debateve dhe trajnimeve.

Qëllimi i broshurës është që ta njoftojë qytetarin mesatar të Maqedonisë me reformat të cilat duhet patjetër t’i zbatojë Republika e Maqedonisë që të bëhet anëtare e BE-së. Në të shqyrtohen politikat sektoriale evropiane, të ndara sipas kapitujve përkatës, si dhe obligimet të cilat i ka marrë Republika e Maqedonisë me nënshkrimin e Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim.

Gjatë konceptimit të kësaj broshure, QMAE shfrytëzoi një pjesë të përvojës dhe materialeve promotive të cilat i hartonin shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore për promovim të BE-së para qytetarëve të tyre, veçanërisht broshurat dhe materialet promotive të Republikës së Kroacisë si shtet në proces të anëtarësimit në BE.

Me shpresë që kjo broshurë do t’ju ndihmojë që më lehtë ta kuptoni procesin nëpër të cilin duhet të kalojë Republika e Maqedonisë para se të bëhet anëtare e BE-së, ju përkujtojmë që QMAE edhe më tutje do të jetë në dispozicion nëse keni pyetje plotësuese.



Andreja Stojkovski

Kryetar

Qendra maqedonase për arsim evropian

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE



KAPITULLI 1

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 15

Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë gradualisht do të krijojnë zonë të lirë tregtare, për periudhë që do të zgjasë maksimalisht 10 vjet, me vetë hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me dispozitat e saj dhe në pajtim me dispozitat e GATT-it të vitit 1994 dhe të OBT-së. Gjatë kësaj, ato duhet t'i kenë parasysh kërkesat konkrete të shënuara më poshtë.

Në tregtinë mes dy Palëve, për klasifikim të mallrave do të aplikohet Nomenklatura e kombinuar për mallra.

Shkallët themelore doganore për secilin prodhim, për të cilin do të aplikohen ulje të njëpasnjëshme të shënuara në këtë marrëveshje, do të jenë ato të cilat janë të aplikueshme erga omnes në ditën para nënshkrimit të Marrëveshjes.

Nëse pas nënshkrimit të Marrëveshjes aplikohet ulje e doganave në bazë erga omnes, dhe veçanërisht ulje të cilat janë rezultat i negociatave për dogana me OBT-në, shkallët e këtilla të zvogëluara doganore do t'i zëvendësojnë shkallët themelore doganore.

Marrja e datës për fillim të negociatave të Republikës së Maqedonisë është tema më aktuale në shtet. Janë tridhjetepesë kapituj për negociata në të cilët Maqedonia duhet patjetër ta harmonizojë legjislacionin e vet me atë të Bashkimit Evropian. Pas përfundimit të shqyrtimit analitik dhe vlerësimit të harmonizimit të legjislacionit sipas kapitujve (i ashtuquajtur i proces “screening”), Komisioni Evropian harton raport në të cilin jep rekomandime për negociatat e mëtutjeshme. Në bazë të këtyre raporteve, shtetet-anëtare të BE-së vendosin për hapje të negociatave për secilin kapitull veç e veç ose paralelisht për më shumë kapituj.

Tregu i përbashkët është një prej arritjeve më të mëdha në funksionimin e përbashkët të Bashkimit Evropian, dhe ai përbëhet prej pesë lirive: lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve, shërbimeve, kapitalit dhe diturisë mes shteteve-anëtare. Strategjia për themelimin e tregut të përbashkët është pranuar në vitin 1985. Prej atëherë deri në vitin 1993, kur ka hyrë në fuqi tregu i përbashkët, ai ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit, me të cilat janë mënjeluar shumë kufizime teknike dhe administrative, si dhe masa të tregut nacional për mbrojtje të prodhimeve vendase.

Kapitulli i negociatave me titull Lëvizja e lirë e mallrave ka të bëjë me një varg çështjesh specifike të cilat janë të domosdoshme për krijim dhe për funksionim të tregut të përbashkët.

Çka do të thotë lëvizja e lirë e mallrave?

Lëvizja e lirë e mallrave jep mundësi të barabartë për qasje deri te tregu të prodhimeve të njëllota me prejardhje prej shteteve të ndryshme anëtare të Bashkimit Evropian, pa pengesa ligjore dhe pa kufizime të sasisë. Dobi prej kësaj kanë edhe prodhuesit, edhe konsumatorët: prodhuesit për shkak të zgjerimit të tregut për plasman të prodhimeve të tyre, kurse konsumatorët për shkak se u ofrohet zgjidhje më e madhe e prodhimeve me çmim më të ulët, që është pasojë e konkurrencës më të madhe. Kështu, për shembull, prodhimet nga Çekia ose Hungaria mund të plasohen në tregun gjerman me kushte të njëjta si edhe prodhimet gjermane.

Cilat kushte duhet patjetër t'i plotësojë shitësi që prodhimi i tij t'i plotësojë kërkesat e tregut?

Në Bashkimin Evropian ekzistojnë akte unike teknike të cilat duhet patjetër t'i plotësojë secili prodhim, dhe secili shtet-anëtar i merr ato në legjislacionin e vet nacional. Në mënyrë të detajuar janë përcaktuar aktet për prodhimet me rrezik më të madh: materiet kimike, barërat, prodhimet kozmetike, tekstili, këpucët, druri, qelqi i kristaltë dhe automjetet motorike. Për prodhimet tjera janë definuar vetëm kushtet minimale të cilat duhet patjetër t'i plotësojë prodhimi para se të plasohet në treg. Për shembull, përcaktohen kushte të caktuara teknike për sigurinë e lodrave, makinave, prodhimeve ndërtimore, vinçave, aparateve mjekësore dhe me gaz, etj. Shembull për këtë është Rregullorja për të qenët në rregull nga aspekti shëndetësor i një lloji të caktuar të prodhimit: për lodrat e fëmijëve



të cilat lëshohen në qarkullim përcaktohet ndalim për kërcënim të shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve, dhe në suaza të deklaratës - edhe atë në vetë lodrën ose në ambalazh - lodrat duhet të kenë shënim të qëndrueshëm të dukshëm për paralajmërim për rreziqet e mundshme, që posaçërisht ka të bëjë me lodrat e dedikuara për fëmijë deri në tri vjet. Gjithashtu, lodrat duhet patjetër të përmbajnë shenjë ndërkombëtare për atë se për cilën grup-moshë janë të dedikuara, përkatësisht për cilën grup-moshë nuk janë të dedikuara (zakonisht: për fëmijë deri në 3 vjet), kurse janë të përcaktuara edhe llojet e materialeve të cilat mund të shfrytëzohen në prodhim. Dispozita të ngjashme me këto janë përcaktuar edhe për të gjitha prodhimet tjera.

Masa dhe kufizime të posaçme vlejné vetëm në rast të lëvizjes së të mirave kulturore (për shembull të mirat artistike) dhe të armëve.

Çka për mallrat për prodhimin e të cilave ekzistojné rregulla të barabarta në nivel të tërë Bashkimit Evropian?

Në këtë rast aplikohet principi i njohjes së ndërsjellë. Shteti-importues i prodhimeve në tregun e vet vepron sipas ligjeve të cilat për atë prodhim i ka përcaktuar shteti në të cilin është prodhuar prodhimi. Për shembull, para ca kohësh Gjermania e ka ndaluar importin e birrës nga Belgjika për shkak se ajo përmban aditiv të cilin nuk e kanë birrat gjermane. Pas zbatimit të procedurës gjyqësore, Gjykata evropiane e drejtësisë solli vendim në dobi të Belgjikës, për shkak se asnjë shtet-anëtar i BE-së që ka standarde vetjake për prodhimet nuk mund të kërkojë që edhe shtetet tjera anëtare t'i zbatojné standardet e tyre, por duhet patjetër t'i respektojé standardet të cilat për atë prodhim i ka përcaktuar shteti i prejardhjes së tij. Shteti mund ta kushtëzojë

ose ta ndalojë qasjen e prodhimeve prej shteteve tjera anëtare në tregun nacional vetëm në kuptim të mbrojtjes së moralit publik, sigurisë publike, interesit publik, jetës dhe shëndetit, mbrojtjes së pasurisë nacionale (artistike, historike, arkeologjike), mbrojtjes së mjedisit jetësor, etj.

Për plotësim të kushteve të shënuara, shtetet-anëtare duhet patjetër të kenë institucione përkatëse (ente për standardizim, akreditim, metrologji, agjenci, shërbime inspektorale, etj.) dhe numër të mjaftueshëm të ekspertëve për vlerësim të të ashtuquajturës përputhje të prodhimeve me kërkesat dhe normat teknike, me çka do të sigurohej funksionimi efektiv i tregut të përbashkët. Edhe pse kjo ka filluar të funksionojë para më shumë se dhjetë viteve, sjellja e akteve dhe masave të lidhura me tregun e përbashkët zgjat edhe sot e kësaj dite.

LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE



KAPITULLI 2

LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 44

Varësisht nga kushtet dhe modalitetet të cilat zbatohen në secilin shtet-anëtar:

- Punëtorët të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe të cilët janë të punësuar në mënyrë ligjore në territorin e shtetit-anëtar do të jenë të liruar nga secili diskriminim në bazë nacionale, dhe sa u përket kushteve të punës, kompensimeve ose largimit nga puna, me ata do të veprohet si me shtetasit e vet;
- Bashkëshorti/bashkëshortja ose fëmijët e punëtorit që është i punësuar në mënyrë ligjore në territorin e shtetit-anëtar, të cilët qëndrojnë në mënyrë ligjore, me përjashtim të punëtorëve sezonalë dhe punëtorëve të cilët u nënshtrohen marrëveshjeve bilaterale, në kuptim të Nenit 45, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ato marrëveshje, do të kenë qasje të lirë deri te tregu i fuqisë punëtore i atij shteti-anëtar, për periudhën për të cilën është aprovuar punësimi i punëtorit.

Varësisht nga kushtet dhe modalitetet në atë shtet, Republika e Maqedonisë do të veprojë si që është shënuar në paragrafin 1 për punëtorët të cilët janë shtetas të shtetit-anëtar dhe të cilët janë të punësuar në mënyrë ligjore në shtetin e përmendur, si dhe me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të cilët qëndrojnë në mënyrë ligjore në shtetin e përmendur.

- Liria e lëvizjes së punëtorëve është një prej principeve themelore të BE-së dhe një prej pesë lirive të tregut të brendshëm. Njëkohësisht, kjo liri është një prej të drejtave më të rëndësishme të Bashkësisë.
- Liria e lëvizjes së punëtorëve është e lidhur me një varg çështjesh siç janë liria e lëvizjes dhe pushimit gjatë punësimit në ndonjë shtet tjetër anëtar dhe me të gjitha degët e sigurimit social siç janë sigurimi pensional, sigurimi shëndetësor, sigurimi në rast të papunësisë dhe e drejta e kompensimeve familjare.

• Kapitulli 2 i përfshin fushat në vijim:

1. Qasja në tregun e punës - duke e përfshirë EURES-in
2. Koordinimi i sistemit të sigurimit social - duke e përfshirë edhe Librezën shëndetësore evropiane.

Cilat të drejta i ka shtetasi i shtetit-anëtar të BE-së gjatë punësimit në ndonjë shtet tjetër anëtar të BE-së?

• Sipas dispozitave të përshkruara në aktet juridike të BE-së, punëtori i cili shpërngulet në shtet tjetër anëtar ka të drejta të caktuara. Kryesisht, këto të drejta janë:

- E drejta e punës pa leje për punë (përpos punëtorët prej shteteve të reja anëtare të cilat janë të përfshira me një periudhë të tranzicionit)

- Barazia e procedurave gjatë punësimit si me shtetasit e shtetit-anëtar në të cilin kryhet puna

- E drejta e privilegjeve të barabarta sociale me ato që i kanë edhe shtetasit e shtetit-anëtar në të cilin punësohet punëtori

- E drejta e anëtarëve të familjes që t'i bashkëngjiten punëtorit dhe të marrin kompensim familjar

- Koordinimi i plotë i sistemit të sigurisë sociale (të drejtat pensionale dhe kontributi për sigurim social)

- Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve.

Një prej qëllimeve të të drejtave të përmendura është edhe nxitja e lëvizshmërisë së fuqisë punëtore mes shteteve-anëtare të BE-së, që është faktor i rëndësishëm në realizimin e tregut të brendshëm.

Edhe përpos të drejtave të garantuara, fuqia punëtore në BE ka lëvizshmëri të ulët hapësinore dhe profesionale. Sot vetëm 2% e popullsisë punuese të BE-së punon në ndonjë shtet tjetër anëtar të BE-së. Sipas kësaj, liria e garantuar e lëvizjes së punëtorëve dhe ekspertëve në BE në masë të madhe është e pashfrytëzuar. Duke vënë re që niveli i ulët i lëvizshmërisë së fuqisë punëtore të BE-së ka pasoja negative mbi rritjen ekonomike, punësimin dhe aftësimin profesional të fuqisë punëtore, Bashkimi Evropian përpiqet t'i mënjanojë pengesat e përmendura me masa të ndryshme, me qëllim që të përmirësohet gjendja me punësimin dhe të motivohet lëvizshmëria e fuqisë punëtore. Miratimi i Planit aksionar për aftësim profesional dhe

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 45

Duke e pasur parasysh gjendjen në tregun e punës në shtetet-anëtare, në pajtim me legjislacionin e tyre dhe në pajtim me rregullat të cilat janë në fuqi në shtetet-anëtare, në fushën e lëvizshmërisë së punëtorëve:

- gjatë punësimit të punëtorëve nga Republika e Maqedonisë, duhet të respektohen dhe sipas mundësisë të avancohen lehtësimet ekzistuese të cilat i japin shtetet-anëtare me marrëveshje bilaterale;

- shtetet tjera anëtare do ta shqyrtojnë mundësinë që të lidhin marrëveshje të ngjashme.

Këshilli për stabilizim dhe asociim do t'i shqyrtojë edhe mundësitë tjera, duke e përfshirë qasjen për trajnim profesional në pajtim me rregullat dhe procedurat në fuqi në shtetet-anëtare dhe duke e pasur parasysh gjendjen në tregun e punës në shtetet-anëtare dhe në Bashkësi.

lëvizshmëri dhe krijimi i portalit me informata për lëvizjen e punëtorëve në suaza të BE-së për shkak të punësimit më të lehtë janë vetëm disa prej masave të ndërmarra. Përpos në nivel të BE-së, ndërmerren masa edhe në nivel nacional, si për shembull nxitja e aktiviteteve të punësimit sektorial (Austri), përkrahja e posaçme për nxitje të lëvizshmërisë së të papunësuarve (Gjermani dhe Suedi), promovimi i lëvizshmërisë në suaza të administratës publike (Danimarkë dhe Portugali), etj.



Periudha e tranzicionit - kufizim për shtetet e reja anëtare

BE tradicionalisht vë kufizime të caktuara në lëvizjen e lirë të punëtorëve prej shteteve të reja anëtare, në formë të periudhës së tranzicionit. Për shembull, Greqia ka pasur periudhë kalimtare prej 6 viteve për lëvizje të punëtorëve të saj, të cilët në atë periudhë kanë pasur obligim të posedojnë leje për punë dhe qëndrim, njëjtë si edhe ata që nuk janë shtetas të BE-së. Periudhë e ngjashme e tranzicionit është përcaktuar edhe për Spanjën dhe Portugalinë, në kohëzgjatje prej shtatë vitesh, gjatë së cilës për punëtorët e këtyre shteteve ka qenë e kufizuar qasja e lirë deri te punësimi. Liria e lëvizjes së tyre është realizuar gradualisht. Historia e zgjerimit të BE-së ka treguar që frika prej migrimeve të mëdha të punëtorëve prej shteteve të reja anëtare në tregun e punës të shteteve të vjetra anëtare është e pabazë. Përkundrazi, është dëshmuar që emigrimi pas zgjerimit të BE-së më shumë shënon rënie se rritje. Edhe përpos kësaj, shtete të caktuara anëtare të BE-së edhe më tutje parashtrojnë kërkesa për

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 46

Do të vendosen rregulla për koordinim të sistemit të sigurisë sociale të punëtorëve shtetas të Republikës së Maqedonisë të cilët janë të punësuar në mënyrë ligjore në territorin e shtetit-anëtar ose për familjet e tyre të cilat qëndrojnë në mënyrë ligjore. Për këtë qëllim, vendimi i Këshillit për stabilizim dhe asociim, i cili nuk duhet të ndikojë mbi cilat do të drejta ose obligime prej marrëveshjeve bilaterale nëse ato sigurojnë trajtim më të volitshëm, do t'i përcaktojë dispozitat në vijim:

- të gjitha periudhat e sigurimit, punësimit ose qëndrimit, të realizuara në territorin e shteteve të ndryshme anëtare, do të mblihen për shkak të sigurimit të pensionit dhe anuiteteve në bazë të moshës, invaliditetit dhe vdekjes dhe për shkak të kujdesit mjekësor për ata punëtorë ose anëtarët e familjes së tyre.
- të gjitha pensionet ose anuitetet në bazë të moshës, vdekjes, lëndimeve në punë ose sëmundjeve profesionale, ose invaliditetit që mund të paraqitet si rezultat i tyre, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuese, do të jenë të lira për bartje në nivel që aplikohet në ligjin e debitorit të shtetit ose shteteve-anëtare;
- punëtorët me të cilët ka të bëjë kjo do të marrin shtesa familjare për anëtarët e familjeve të tyre si që është definuar më lart.

Punëtorëve të cilët janë shtetas të shteteve-anëtare dhe të cilët janë të punësuar në mënyrë ligjore në territorin e saj, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilët qëndrojnë aty në mënyrë ligjore, Republika e Maqedonisë do t'u ndajë trajtim të ngjashëm me atë që është shënuar në alinenë e dytë dhe të tretë të paragrafit 1.

periudha të tranzicionit (më së shpeshti në kohëzgjatje prej 7 viteve) për lëvizjen e lirë të punëtorëve prej shteteve të reja anëtare për profesione të caktuara, varësisht nga kërkesa e vendeve të caktuara të punës. Në zgjerimin e fundit, të pestë, të Bashkimit Evropian, janë caktuar periudha të tranzicionit për të gjitha shtetet e reja anëtarë, përveç për Qipron dhe Maltën.

Vërejtje: Vendimin për periudhë të tranzicionit e sjell secili shtet-anëtar i BE-së veç e veç, varësisht nga gjendja në tregun nacional të punës dhe nga kërkesa për punëtorë në profesione të caktuara.

Në të ardhmen, pas hyrjes së Maqedonisë në BE, nëse caktohet periudhë e tranzicionit edhe për Maqedoninë, do të aplikohet rregulla për përparësi të Bashkësisë. Kjo do të thotë që punëdhënësit e shteteve të vjetra anëtare do të kenë obligim që gjatë punësimit t'u japin përparësi punëtorëve prej shtetit-aderues (në këtë rast Maqedonisë) para punëtorëve prej shteteve të treta. Shtetet e vjetra anëtare do të kenë obligim që gjatë punësimit t'u japin përparësi punëtorëve prej shtetit-aderues (në këtë rast Maqedonisë) para punëtorëve prej shteteve të treta. Edhe përpos të drejtave të garantuara, fuqia punëtore në BE ka lëvizshmëri të ulët hapësinore dhe profesionale. Sot vetëm 2% e popullsisë punuese të BE-së punon në ndonjë shtet tjetër anëtar të BE-së.

Megjithatë, në Kapitullin 3 ekzistojnë përjashtime: nuk i përfshin shërbimet financiare, bujqësore dhe transportuese.







LËVIZJA E LIRË E SHËRBIMEVE

Expert Consulting

We help you to make the right decisions to position your project for success.

Implementation

We recommend the most relevant partners for development, design, and hosting.

KAPITULLI 3

LËVIZJA E LIRË E SHËRBIMEVE

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 52

Për t'ua lehtësuar qytetarëve të Republikës së Maqedonisë ose të Bashkësisë atë që të fillojnë dhe të kryejnë aktivitete të rregullta profesionale në Bashkësi, përkatësisht në Republikën e Maqedonisë, Këshilli për stabilizim dhe asociim do të shqyrtojë se cilët hapa janë të domosdoshëm për njohje të ndërsjellë të kualifikimeve. Ai mund t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për këtë qëllim.

Liria e kryerjes së shërbimeve është një prej pesë lirive themelore të cilat mundësojnë funksionim të tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian (përpos kryerjes së shërbimeve, këtu bëhet fjalë edhe për lëvizjen e lirë të mallrave, njerëzve, kapitalit dhe diturisë). Korniza ligjore e cila mundëson lëvizje të lirë të shërbimeve, dhe e përfshin edhe të drejtën e entiteteve afariste, shqyrtohet në suaza të Kapitullit 3 të negociatave.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 55

Në pajtim me dispozitat në vijim, palët obligohen të ndërmarrin hapa të domosdoshëm që të mundësojnë ofertë të shpejtuar të shërbimeve prej kompanive ose prej shtetasve të Bashkësisë ose të Republikës së Maqedonisë, të cilat janë themeluar në Palë tjetër prej asaj të personit për të cilin janë dedikuar shërbimet.

Në hap me procesin e liberalizimit, të përmendur në paragrafin 1, Palët do të lejojnë lëvizje të përkohshme të personave fizikë të cilët kryejnë shërbime ose të cilët punojnë për kryerësin e shërbimeve si personel kyç, si që është definuar në nenin 53, duke i përfshirë personat profesionalë të cilët janë përfaqësues të kompanive nga Bashkësia ose nga Republika e Maqedonisë ose shtetas dhe kërkojnë hyrje të përkohshme me qëllim që të negociojnë për shitje të shërbimeve ose të lidhin marrëveshje për shitje të shërbimeve për kryerësin e shërbimeve, ku këta përfaqësues nuk do të jenë të angazhuar në shitjen e drejtpërdrejtë të shërbimeve publikut ose për vete.

Në fazën e dytë të periudhës kalimtare, Këshilli për stabilizim dhe asociim do të ndërmarrë masa të domosdoshme për implementim progresiv të dispozitave nga paragrafi 1. Do të merret parasysh përparimi i arritur i adaptimit të legjislacionit të Palëve.

Neni 56

Palët nuk do të ndërmarrin çfarëdo qoftë masash ose aktiviteteve nëpërmjet të cilave do të krijohen kushte për ofrim të shërbimeve prej shtetasve të Bashkësisë ose të Republikës së Maqedonisë ose kompanive të themeluara në Palë tjetër prej asaj të cilës i takon personi për të cilin janë dedikuar shërbimet, të cilat janë konsiderueshëm më restriktive në krahasim me gjendjen në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Nëse njëra Palë konsideron që masat e ndërmarra nga Pala tjetër pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes rezultojnë me gjendje e cila është konsiderueshëm më restriktive në lidhje me ofertën e shërbimeve në krahasim me gjendjen në ditën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Pala e parë mund të kërkojë prej Palës tjetër që të fillojnë konsultime.

Çka është e drejta e themelimit të ndërmarrjeve, e çka liria e kryerjes së shërbimeve?

Për lirinë e themelimit të ndërmarrjeve flasim në rast të zgjerimit të përhershëm të veprimtarisë prej një shteti-anëtar të BE-së në ndonjë shtet tjetër anëtar, të fillimit të veprimtarisë së pavarur ose të themelimit të shoqërisë tregtare, kurse liria e kryerjes së shërbimeve ka të bëjë me kryerjen e përkohshme ose të kohëpaskohshme të shërbimeve jashtë kufijve të shtetit amë.

Shtetet-anëtare duhet patjetër t'i harmonizojnë ligjet nacionale të cilat e kufizojnë të drejtën e themelimit të ndërmarrjeve dhe të kryerjes së lirë të shërbimeve në veprimtari të ndryshme, siç janë shërbimet artistike, shëndetësore, juridike, ndërtimore dhe të tjera, dhe të sigurojnë kushte të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh shtetësinë. Kufizimet gjatë themelimit të ndërmarrjeve ose kryerjes së shërbimeve në formë të vetëpunësimit janë të mundshme vetëm në raste rreptësisht të përcaktuara dhe duhet patjetër të vlejnjë për të gjithë në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga shtetësia ose vendi i qëndrimit.

Njohja e kualifikimeve profesionale

Kapitulli 3 përmban direktivë të posaçme për njohjen e kualifikimeve profesionale. Në të përfshihen përgjigje të një numri të madh të çështjeve me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo ditë: kur dhe në cilat kushte në një shtet-anëtar do të njihet ndonjë kualifikim i caktuar profesional, i marrë në ndonjë shtet tjetër anëtar, a do të duhet patjetër që poseduesi i ndonjë certifikate ose diplome të japë provime plotësuese për kontroll, a do të duhet patjetër të realizojë stazh të caktuar për njohje të kualifikimeve të tij, etj.

Sa i përket njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve, për disa profesione kualifikimet njihen në mënyrë automatike, me kusht që shtetet-anëtare të kenë pranuar standarde të caktuara minimale arsimore për profesionin në fjalë. Këtu bëhet fjalë për mjekë, stomatologë, veterinarë, motra medicinale, farmacistë dhe arkitektë. Personave të cilët merren me këto profesione duhet patjetër t'u njihen kualifikimet e marra në shtetet e tyre, me çka do të mund ta kryenin veprimtarinë kudo qoftë në BE.

Me qëllim që shtetet-aderuese në BE të adaptohen ndaj legjislacionit në lidhje me lëvizjen e lirë të shërbimeve, programet profesionale për arsim

duhet patjetër të harmonizohen me ato evropiane. Një prej masave për adaptim të sistemit unik të kualifikimeve të BE-së është edhe Procesi i Bolonjës, i cili ka të bëjë me arsimin e lartë, dhe shqyrtohet në suaza të Kapitullit 26 - Arsimi dhe kultura.

Megjithatë, në Kapitullin 3 ekzistojnë përjashtime: nuk i përfshin shërbimet financiare, bujqësore dhe transportuese.

Shërbimet postare

Shërbimet postare në Gjermani nuk i ofron ekskluzivisht Dojçe post (Deutsche Post) ose në Francë La Poste (La Posteu). Komisioni Evropian ka hartuar propozim me të cilin deri në janar të vitit 2011 tregu i shërbimeve postare tërësisht do t'ia hapte derën konkurrencës. Sipas propozim-vendimit, ndërmarrjet e deritanishme të cilat kanë ofruar shërbime postare në shtetet e tyre nuk do të kenë më monopol të dërgesave postare masa e të cilave është më e vogël se 50 gramë. Të gjitha shtetet-antëtare do të kenë obligim të sigurojnë shpërndarje

të këtyre punëve mes më shumë ofruesve të shërbimeve, me qëllim që t'i përmirësojnë cilësitë e ardhshme të shërbimeve postare për qytetarët e BE-së dhe me qëllim që nëpërmjet liberalizimit të plotë të shërbimeve postare të zvogëlohen shpenzimet e konsumatorëve dhe të ndërmarrjeve.

Sektori i shërbimeve postare ka rëndësi të jashtëzakonshme për subjektet afariste dhe për konsumatorët dhe konsiderohet si shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik. Tregjet e shërbimeve postare janë shumë dinamike dhe zhvillohen shpejt, duke e ndjekur zhvillimin e komunikimeve dhe të tregtisë elektronike.

Supozohet që në territorin e tërë Bashkimit Evropian dhënësit e shërbimeve postare distribuojnë thuhajse 135 miliardë dërgesa në vit, dhe prej kësaj realizojnë qarkullim vjetor prej 90 miliardë eurove, që paraqet thuhajse 1% të BPV-së së BE-së. Qëllimi i Komisionit Evropian është që të krijojë treg të përbashkët për shërbime postare dhe të sigurojë cilësi të shërbimeve, duke e hapur gradualisht garën e tregut në këtë sektor.

Neni 57

Në lidhje me ofertën e shërbimeve transportuese mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë, do të zbatohen dispozitat në vijim:

1. Në lidhje me transportin tokësor, marrëdhënia mes Palëve është e rregulluar me Marrëveshjen mes Bashkësisë Evropiane dhe Republikës së Maqedonisë në fushën e komunikacionit, e cila ka hyrë në fuqi më 28 nëntor të vitit 1997. Palët e vërtetojnë rëndësinë e zbatimit konsekuent të Marrëveshjes.
2. Në lidhje me transportin ndërkombëtar detar, Palët obligohen që në mënyrë efektive t'i zbatojnë principet e qasjes jorestriktive ndaj tregut të komunikacionit në bazë komerciale.
 - a) Dispozitat e lartshënuara nuk i kufizojnë të drejtat dhe obligimet sipas Kodit të sjelljes të KB-ve për Konferencën e transportuesve, si që janë zbatuar nga njëra ose nga tjetra Palë e kësaj Marrëveshjeje. Transportuesit të cilët nuk marrin pjesë në Konferencë do të mund të konkurrojnë lirisht me transportuesit e Konferencës derisa u përmbahen principeve të konkurrencës së drejtë në bazë komerciale;
 - b) Palët e vërtetojnë angazhimin e tyre për sigurim të konkurrencës së lirë si karakteristikë shumë e rëndësishme e tregtisë transportuese tokësore dhe ujore transportuese me ngarkesa kaba;
3. Duke i zbatuar dispozitat nga paragrafi 2, Palët:
 - c) nuk do të vendosin klauzola për ndarje të ngarkesës në marrëveshjet e ardhshme bilaterale me palë të treta, në rrethana tjera përveç në këto rrethana të jashtëzakonshme ku kompanitë transportuese të linjës prej njëres deri në Palën tjetër të kësaj Marrëveshjeje në mënyrë tjetër nuk do të kenë mundësi efektive të kryqëzojnë për qëllime tregtare deri në dhe prej shtetit të tretë të interesuar;
 - ç) në marrëveshjet e ardhshme bilaterale për tregti me prodhime të thata dhe të lëngshme të papaketuara do të ndalojnë aranzhmane për ndarje të ngarkesës;
 - d) me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do t'i anulojnë të gjitha masat e njëanshme dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera të cilat do të kishin efekt restriktiv ose diskriminues mbi ofertën e lirë të shërbimeve në transportin ndërkombëtar detar.
4. Me qëllim që të sigurohet zhvillim i koordinuar dhe liberalizim progresiv i transportit mes Palëve, të adaptuar ndaj nevojave të tyre reciproke komerciale, kushtet për qasje të ndërsjellë në tregun e transportit ajror do të rregullohen me Marrëveshje të posaçme të cilat do të jenë lëndë e marrëveshjes mes Palëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
5. Para lidhjes së Marrëveshjeve, të përmendura në paragrafin 4, Palët nuk do të ndërmarrin çfarëdo qoftë masash ose aktiviteteve të cilat janë më restriktive ose diskriminuese në krahasim me gjendjen e cila ka ekzistuar para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
6. Gjatë periudhës kalimtare, Republika e Maqedonisë duhet ta adaptojë legjisllacionin e saj, duke i përfshirë normat administrative, teknike dhe të tjera, ndaj atyre në Bashkësi në fushën e transportit ajror dhe tokësor, të cilat shërbejnë për qëllimet e liberalizimit të shërbimeve dhe qasjes së ndërsjellë në tregjet e Palëve dhe për lehtësim të lëvizjes së udhëtarëve dhe mallrave.
Në hap me përparimin e përgjithshëm gjatë arritjes së qëllimeve nga ky Kapitull, Këshilli për stabilizim dhe asociim do t'i shqyrtojë mënyrat e krijimit të kushteve të domosdoshme për avancim të kryerjes së lirë të shërbimeve transportuese ajrore dhe tokësore.



LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

0.70
0.60
0.50
0.40
0.30
0.20
0.10
0.00



KAPITULLI 4

LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 58

Në pajtim me dispozitat e nenit VIII të Marrëveshjes për Fondin monetar ndërkombëtar, palët obligohen që të lejojnë, në valutë lirisht konvertibile, çfarëdo qoftë pagesash dhe transferesh në llogarinë rrjedhëse të bilanceve të pagesës mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë.

Në bazat e funksionimit të tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian gjenden pesë liri themelore:

- Lëvizja e lirë e mallrave
- Lëvizja e lirë e njerëzve
- Lëvizja e lirë e shërbimeve dhe e drejta e themelimit të ndërmarrjeve
- Lëvizja e lirë e kapitalit
- Lëvizja e lirë e diturisë

Çka është lëvizja e lirë e kapitalit?

Lëvizja e lirë e kapitalit mundëson qarkullim të mjeteve në suaza të Bashkimit Evropian, e lehtëson tregtinë tejkuftare, e ndihmon lëvizshmërinë e punëtorëve, e lehtëson mbledhjen e kapitalit të nevojshëm për fillim të biznesit dhe mundëson rritje të subjekteve ekonomike dhe funksionim të tregut të integruar, të hapur dhe efikas të brendshëm, që është në interes të të gjithë qytetarëve të BE-së.

Kapitulli 4 përcakton rregulla për lëvizje të lirë të kapitalit mes shteteve-anëtare të BE-së, dhe ato përfshijnë ndalim të të gjitha kufizimeve në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave, si brenda në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian, ashtu edhe mes shteteve-anëtare dhe shteteve të treta. Gjatë kësaj ekzistojnë përjashtime të caktuara të cilat kanë të bëjnë në radhë të parë me tatimet, pengimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, etj.

Ky kapitull i legjislacionit ligjor përmban edhe rregulla për investimet tejkuftare në sektorin e shërbimeve financiare dhe të drejtën e pronësisë së patundshmërive jashtë kufijve nacionalë, por në suaza të Bashkimit Evropian.

Mundësitë për qytetarët, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare në BE

Lëvizja e lirë e kapitalit u mundëson qytetarëve kryerje të një spektri të gjerë të veprimtarive jashtë vendit:

- Hapje të llogarive bankare në banka të huaja
- Blerje të aksioneve në kompani të huaja
- Investim
- Blerje të patundshmërive

Për ndërmarrjet, kjo liri i nënkupton gjërat në vijim:

- Mundësi për investim dhe marrje të së drejtës së pronësisë së shoqërive të huaja tregtare
- Realizim të rolit aktiv në menaxhimin e tyre

Neni 59

Në lidhje me transaksionet e llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Palët duhet të sigurojnë lëvizje të lirë të kapitalit për investime të drejtpërdrejta në ndërmarrje të formuara në pajtim me ligjet e shtetit nikoqir dhe për investime në pajtim me dispozitat e Kapitullit II të Kreut V dhe likuidim ose riatdhesim të këtyre investimeve dhe të profitit që rrjedh prej tyre.

Në lidhje me transaksionet e llogarisë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët duhet të sigurojnë lëvizje të lirë të kapitalit për kreditë në lidhje me transaksionet komerciale ose për kryerje të shërbimeve në të cilat merr pjesë ndonjë banor i njëjës prej Palëve, dhe në lidhje me borxhet dhe kreditë financiare me afat të maturimit më të gjatë se një vit.

Pas fillimit të fazës së dytë, ato gjithashtu duhet të sigurojnë lëvizje të lirë të kapitalit në lidhje me investimet portfolio dhe kreditë me afat të maturimit më të shkurtë se një vit.

Pa kufizim mbi paragrafin 1, Palët nuk duhet të zbatojnë kurrfarë kufizimesh të reja për lëvizjen e kapitalit ose për pagesat rrjedhëse mes banorëve të Bashkësisë dhe të Republikës së Maqedonisë, kurse aranzhmanet ekzistuese nuk duhet t'i bëjnë më restriktive.

Pa kufizim të dispozitave të nenit 58 dhe të këtij neni, atëherë kur, në rrethana të jashtëzakonshme, lëvizja e kapitalit mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë mund të shkaktojë, ose kërcënon të shkaktojë vështirësi serioze në realizimin e politikës së kursit të valutës ose politikës monetare në Bashkësi ose në Republikën e Maqedonisë, Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë, respektivisht, mund të ndërmarrin masa vetëmbrojtëse në lidhje me lëvizjen e kapitalit mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë, për periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj, nëse këto masa janë patjetër të domosdoshme.

Palët duhet të konsultohen mes vete në aspekt të lehtësimit të lëvizjes së kapitalit mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë, me qëllim që të promovohen qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

Lëvizja e lirë e kapitalit u mundëson shoqërive .
 tregtare të cilat merren me shërbime financiare :
 kryerje të suksesshme të aktiviteteve tejkuftare. :
 Efikasiteti i sektorit të shërbimeve financiare do :
 të dëmtohej në rast të kufizimit të përhershëm të :
 lëvizjes së kapitalit mes shteteve-anëtare të BE-së. :

Adaptimi i shtetit në procesin e aderimit ndaj rregullave të lëvizjes së lirë të kapitalit

Sipas Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim, Maqedonia si kandidat për anëtarësim në BE ka obligim të sigurojë lëvizje të lirë të kapitalit për investime të drejtpërdrejta në ndërmarrje të formuara në pajtim me ligjet e shtetit nikoqir, lëvizje të lirë

të kapitalit për kreditë në lidhje me transaksionet komerciale, dhe gjithashtu nuk duhet të zbatohen kurrfarë kufizimesh të reja për lëvizjen e kapitalit ose për pagesat rrjedhëse mes banorëve të BE-së dhe të Republikës së Maqedonisë.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 60

Gjatë fazës së parë, Palët duhet të ndërmarrin masa me të cilat mundësohet krijimi i kushteve të domosdoshme për zbatim të mëtutjeshëm gradual të rregullave të Bashkësisë për lëvizje të lirë të kapitalit.

Deri në fund të fazës së parë, Këshilli për stabilizim dhe asociim duhet t'i shqyrtojë mënyrat të cilat mundësojnë që plotësisht të zbatohen rregullat e Bashkësisë për lëvizje të lirë të kapitalit.



FURNIZIMET PUBLIKE



KAPITULLI 5

FURNIZIMET PUBLIKE

Shkurtimisht për furnizimet publike

Është e njohur që nëpërmjet sistemit të furnizimeve publike shpenzohen mjete shumë të larta, të cilat paraqesin përqindje të konsiderueshme të bruto prodhimit vendor në vit. Përkatësisht, sipas të dhënave zyrtare nga Byroja për furnizime publike, në Republikën e Maqedonisë në vitin 2008 janë lidhur marrëveshje për furnizime publike në lartësi prej 27.553.199.555,67 denarëve, që është 7% e bruto prodhimit vendor për atë vit.

Direktivat në lidhje me furnizimet publike të përfshira në Kapitullin 5 kanë për qëllim t'u sigurojnë kryerësve të shërbimeve dhe shitësve të mallrave mundësi për konkurrencë në konkurset publike në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian. Funkcionimi i sistemit efikas në fushën e furnizimeve publike është i domosdoshëm për realizim të qëllimeve të tregut të lirë dhe për krijim të kushteve për konkurrencë në treg.

Legjislacioni ligjor i BE-së i cili ka të bëjë me furnizimet publike bazohet edhe në principe të përgjithshme të cilat rrjedhin nga Marrëveshjet për Bashkësinë Evropiane siç janë transparencja, trajtimi i barabartë, liria e konkurrencës së tregut dhe mosdiskriminimi.

Si adaptohen shtetet ndaj sistemit të furnizimeve publike të BE-së?

Direktivat të cilat e rregullojnë fushën e furnizimeve publike duhet patjetër të barten në legjislacionin nacional në mënyrë në të cilën kjo u përgjigjet specifikave nacionale, por ato duhet patjetër të zbatohen. Direktivat mundësojnë zbatim nëpërmjet legjislacioneve nacionale, përforsim të zhvillimit ekonomik dhe efikasitetit, edhe atë në frymën e tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian.

Për zbatim të akteve për furnizimet publike shtetet duhet të organizojnë strukturë përkatëse administrative në nivel qendror me qëllim që të sigurohen funksionet kyçe të përcaktimit të politikës, informimit, kontrollit dhe statistikës, si dhe të kontroleve autentike të të gjitha fushave në lidhje me furnizimet publike. Institucionet e krijuara për këtë qëllim mbajnë llogari për zbatimin e të gjitha fazave të procedurave të furnizimeve publike, kohëzgjatjen e tyre, dhe është siguruar edhe mbrojtje juridike (shembull, parashtrimi i ankesave në konkurse, etj.).

Gjatë realizimit të konkursit për furnizim publik mund të kursehet kohë nëse realizohen furnizime elektronike, përkatësisht nëse bëhet shfrytëzimi i pakove programore kompjuterike në sistemin e furnizimeve publike.

Si planifikohet procedura për furnizim publik, si vlerësohen ofertuesit dhe cilat janë kushtet për shpallje të thirrjes për konkurs publik? Pjesa më e madhe e njerëzve janë të painformuar për këtë temë. Menaxhimi efikas i furnizimeve arrihet edhe me informim të opinionit për aktivitetet e furnizimeve - ligjet ekzistuese, thirrjet për tenderë, lajmërimet për ndarje të marrëveshjeve, etj.

Me qëllim të shkurtimeve dhe shpenzimeve më të ulëta të procedurës për furnizime publike, në shumicën e shteteve të zhvilluara ekziston trup qendror për furnizime i cili shfrytëzohet për furnizim me mallra ose shërbime të thjeshta, si për shembull furnizimi me letër për shtyp. Përpos furnizimeve publike, ky kapitull i përfshin edhe çështjet e koncesionit dhe të partneriteteve publike-private.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 72

Marrëveshjet publike

Palët konsiderojnë që qëllimi i dëshiruar është që procedura për ndarje të marrëveshjeve publike të realizohet në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në suaza të OBT-së.

Kompanive nga Republika e Maqedonisë, pa marrë parasysh atë se a janë themeluar në Bashkësi ose jo, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do t'u jepet qasje për konkurrim për lidhje të marrëveshjeve sipas procedurave të Bashkësisë në pajtim me rregullat për furnizime në Bashkësi, me trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai që u është dhënë kompanive nga Bashkësia.

Dispozitat e lartshënuara gjithashtu do të zbatohen për marrëveshje në sektorin komunal menjëherë pasi që Qeveria e Republikës së Maqedonisë do ta adoptojë rregullativën ligjore me të cilën do t'i implementojë rregullat e Bashkësisë në këtë fushë. Bashkësia kohë pas kohe do të shqyrtojë se a e ka implementuar me të vërtetë Republika e Maqedonisë rregullativën e tillë ligjore.

Më së voni pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kompanive të Bashkësisë të cilat nuk janë themeluar në Republikën e Maqedonisë do t'u jepet qasje deri te procedurat për lidhje të marrëveshjes në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për furnizime publike, me trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai i paraparë për kompanitë e Republikës së Maqedonisë.

Kompanitë e Bashkësisë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë, sipas dispozitave të Kapitullit II të Kreut V, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të kenë qasje deri te procedurat për lidhje të marrëveshjes me trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai i paraparë për kompanitë nga Republika e Maqedonisë.

Këshilli për stabilizim dhe asociim kohë pas kohe do t'i shqyrtojë mundësitë që Republika e Maqedonisë të sigurojë qasje në procedurat për konkurrim në Republikën e Maqedonisë për të gjitha kompanitë e Bashkësisë.

Në lidhje me themelimin, punën, dhënien e shërbimeve mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë, si dhe me punësimin dhe lëvizjen e fuqisë punëtore në lidhje me plotësimin e marrëveshjeve publike, do të zbatohen dispozitat e neneve 44 deri në 67.



Me direktivat e këtij Kapitulli janë definuar obligimet të cilat duhet patjetër t'i respektojnë trupat e furnizimeve publike dhe të zgjedhin operatorë ekonomikë të cilëve u ndahen koncesione.

Tenderi publik dhe korrupsioni

Sipas të dhënave nga shtetet e BE-së, më së shumti aktivitete korruptive në sistemin e furnizimeve publike ndodhin në fazën pas përfundimit të tenderit

publik dhe pas lidhjes së marrëveshjes. Kjo do të thotë që në procedurën e tenderit publik shkohet me çmim më të ulët të marrë vesh prej më parë, dhe më vonë merren vesh shuma deri te çmimi real, dhe madje edhe çmime më të larta.

Zgjidhja e këtij problemi qëndron në sjelljen dhe zbatimin e kornizës cilësore ligjore dhe në zbatimin e masave nacionale për luftë kundër korrupsionit në administratë në fushën e furnizimeve publike.

E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE



KAPITULLI 6

E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 47

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) „Kompani e Bashkësisë” ose „kompani e Republikës së Maqedonisë”, respektivisht, do të thotë kompani që është themeluar në pajtim me ligjet e shtetit-anëtar ose të Republikës së Maqedonisë, respektivisht, dhe e cila ka regjistruar zyrë, drejtori qendrore ose seli kryesore të veprimit në Bashkësi ose në Republikën e Maqedonisë, respektivisht.

Megjithatë, nëse kompania e cila është themeluar në pajtim me ligjet e shtetit-anëtar ose të Republikës së Maqedonisë, respektivisht, ka vetëm zyrë të regjistruar në territorin e Bashkësisë ose të Republikës së Maqedonisë, respektivisht, ajo do të konsiderohet si kompani e Bashkësisë ose e Republikës së Maqedonisë, respektivisht, nëse puna e saj përmban lidhje reale dhe të përherëshme me ekonominë e njërit prej shteteve-anëtare ose të Republikës së Maqedonisë, respektivisht;

- b) „Filial” i kompanisë do të thotë kompani që është në mënyrë efektive e kontrolluar nga kompania e parë;
- c) „Përfaqësi” e kompanisë do të thotë vend afarist që nuk ka cilësi të personit juridik, që tregon qëndrueshmëri, siç është zgjerimi i trupit amë, ka menaxhment dhe është i pajisur në mënyrë materiale për të realizuar negociata afariste me Palë të treta, ashtu që pala e tretë, edhe pse duke e ditur që më vonë, nëse është e nevojshme, do të ketë lidhshmëri juridike me trupin amë, centrali i të cilit është jashtë, nuk do të punojë drejtpërdrejt me atë trup amë por mund ta bartë biznesin në vendin ku realizohet ai;

- ç) „Themelim” do të thotë:

I) sa u përket shtetasve, e drejta e ndërmarrjes së aktiviteteve afariste në kompani të caktuara të cilat ata i kontrollojnë në mënyrë efektive. Aktivitetet afariste të shtetasve nuk do të përfshijnë kërkesë për ose punësim në tregun e punës, dhe me këtë nuk u jepet e drejta e qasjes në tregun e punës nga Pala tjetër.

II) sa u përket kompanive nga Bashkësia ose nga Republika e Maqedonisë, e drejta e ndërmarrjes së aktiviteteve ekonomike nëpërmjet themelimit të filialeve ose përfaqësive në Republikën e Maqedonisë ose në Bashkësi, respektivisht;

- d) „Punë” do të thotë realizim i aktiviteteve ekonomike;
- dh) „Aktivitetet ekonomike” në parim i përfshijnë aktivitetet me karakter industrial, tregtar dhe profesional, si dhe aktivitetet zejtare;
- e) „Shtetas i Bashkësisë” dhe „shtetas i Republikës së Maqedonisë”, respektivisht, do të thotë person që është shtetas i njërit prej shteteve-anëtare ose i Republikës së Maqedonisë;

- ë) sa i përket transportit ndërkombëtar detar, duke i përfshirë edhe operacionet ndër-modale të objekteve lundruese, shtetasit e shteteve-anëtare ose të Republikës së Maqedonisë të themeluar jashtë Bashkësisë ose Republikës së Maqedonisë, respektivisht, dhe kompanitë e lundrimit të themeluara jashtë Bashkësisë ose Republikës së Maqedonisë dhe të kontrolluara nga shtetasit e shteteve-anëtare ose të Republikës së Maqedonisë, respektivisht, do të jenë gjithashtu shfrytëzues të dispozitave të këtij Kapitulli dhe të Kapitullit III nëse anijet e tyre janë regjistruar në atë shtet-anëtar ose në Republikën e Maqedonisë, respektivisht, në pajtim me legjislacionet e tyre.
- f) „Shërbime financiare” do të thotë aktivitetet që janë përshkruar në Aneksin VI. Këshilli për stabilizim dhe asociim mund ta zgjerojë ose ta ndryshojë përfshirjen e këtij Aneksi.

Kapitulli 6 ka të bëjë me themelimin dhe punën e shoqërive tregtare në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian. I përfshin tri pjesë: ligjin për shoqëri tregtare në kuptim më të ngushtë, kontabilitetin dhe revizionin.

Ligji për shoqëri tregtare

Ligji për shoqëri tregtare në kuptim më të ngushtë nënkupton rregulla për themelim, regjistrim, bashkim dhe ndarje të brendshme dhe tejkufitare të ndërmarrjeve dhe për statusin juridik të kompanive të huaja.

Ligjet për shoqëritë tregtare në shtetet-anëtare të BE-së i rregullojnë, mes tjerash, edhe veprimtaritë e shoqërive të huaja tregtare dhe tregtarëve të huaj individë (me seli jashtë atij shteti) në territoret nacionale. Shoqëritë e huaja tregtare dhe tregtarët e huaj individë, sipas rregullit, janë të barabartë me personat vendas në realizimin e bizneseve, dhe secili prej tyre është i regjistruar në regjistrin tregtar të gjykatës kompetente sipas selisë së tyre.

Sipas dispozitave të këtij Kapitulli, themeluesve të shoqërive tregtare u është njohur liria e themelimit të shoqërive në cilindo shtet-anëtar, pa marrë

parasysh atë se ku gjendet realisht selia. Shtetet-anëtare e ofrojnë ligjin e tyre për shoqëri tregtare si prodhim në tregun e përbashkët evropian.

Rëndësia e konsolidimit të legjislacionit me atë të BE-së, në kuptim të të drejtave të shoqërive tregtare për shtetet-kandidate për anëtarësim në BE shihet në garën e ligdhënësve në rregullimin juridik të shoqërive tregtare, e cila do të mund të sillte deri në efikasitet më të lartë, dhe ndoshta edhe deri në konvergencë më të madhe të të drejtave të shoqërive se sa ato që krijohen me kompromise të ngushta politike.

Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizioni

Në nivel të Bashkimit Evropian është pranuar sistemi i raportimit financiar i cili përfshin rregulla për raportet vjetore, për standardet ndërkombëtare financiare të raportimit, si dhe rregulla për revizionin e obligueshëm. Në fushën e kontabilitetit, shtetet-kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian do të duhet patjetër t'i pranojnë standardet ndërkombëtare të

Neni 48

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë:

- i, në lidhje me themelimin e kompanive të Bashkësisë, do të ndajë trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai të cilin ua ndan kompanive të veta ose kompanive të cilitdo shtet të tretë, nëse ai është më i volitshëm, dhe;
- ii. në lidhje me punën e filialeve dhe përfaqësive të kompanive të Bashkësisë në Republikën e Maqedonisë, pasi që të themelohen ato, do t'u ndahet trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai të cilin ua ndan kompanive ose përfaqësive të veta ose cilitdo filial dhe përfaqësi të kompanive të cilitdo shtet të tretë, nëse ai është më i volitshëm.

Republika e Maqedonisë nuk do të sjellë rregullativa ose masa të reja të cilat implementojnë diskriminim për themelimin e kompanive të Bashkësisë në territorin e saj ose sa u përket aktiviteve të tyre, nëse janë veç më të themeluara në krahasim me kompanitë e saj.

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia dhe shtetet-anëtare:

- i. në lidhje me themelimin e kompanive nga Republika e Maqedonisë, do t'u ndahet trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai të cilin shtetet-anëtare ua ndajnë kompanive të veta ose kompanive të shteteve të treta, nëse ai është më i volitshëm;
- ii. në lidhje me punën e filialeve dhe përfaqësive të kompanive nga Republika e Maqedonisë, të themeluara në territorin e saj, do t'u ndahet trajtim i cili nuk është më i pavolitshëm se ai të cilin shtetet-anëtare ua ndajnë kompanive dhe përfaqësive të tyre ose cilitdo filial dhe përfaqësi të kompanive të cilitdo shtet të tretë, nëse ai është më i volitshëm.

Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me praktikën relevante të Gjykatës evropiane të drejtësisë dhe gjendjeve në tregun e punës, Këshilli për stabilizim dhe asociim do ta shqyrtojë atë se a t'i zgjerohet dispozitat e lartshënuara për themelim nga ana e shtetasve të të dyja Palëve të Marrëveshjes që t'i ndërmarrin aktivitetet si persona të vetëpunësuar.

Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni:

- a) Filialet dhe përfaqësitë e kompanive të Bashkësisë do të kenë të drejtë të shfrytëzojnë dhe të marrin me qira patundshmëri në Republikën e Maqedonisë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;
- b) Filialet e kompanive të Bashkësisë do të kenë edhe të drejtë t'i fitojnë dhe t'i shfrytëzojnë të drejtat për patundshmëritë si edhe kompanitë e Republikës së Maqedonisë dhe, sa u përket të mirave publike/të mirave në interes të përbashkët, duke i përfshirë edhe resurset natyrore, tokën bujqësore dhe pyjet, të drejtat e njëjta të cilat i gëzojnë edhe kompanitë e Republikës së Maqedonisë aty ku këto të drejta janë të domosdoshme për realizim të aktiviteve ekonomike për të cilat janë themeluar;
- c) Në fund të fazës së parë të periudhës kalimtare, Këshilli për stabilizim dhe asociim do ta shqyrtojë mundësinë për zgjerim të të drejtave nën (b) për përfaqësitë e kompanive të Bashkësisë.

kontabilitetit të cilat kanë rëndësi kyçe për funksionimin e tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian.

Gjatë themelimit dhe punës së shoqërive tregtare, aktiviteteve të kontabilitetit dhe revizionit të brendshëm dhe të jashtëm, të gjitha shtetet anëtare duhet patjetër të zbatojnë rregulla të njëjta, të cilat nuk do t'i diskriminojnë shtetasit tjerë të BE-së në raport me shtetasit e shtetit të vet, përkatësisht të mundësohet lëvizja e lirë e punëtorëve, dhënia e lirë e shërbimeve dhe gara e lirë e tregut. Informata më të detajuara në lidhje me këtë temë (ligje, propozim-ligje, etj.) janë në dispozicion në Internet faqet zyrtare të Bashkimit Evropian. <http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 86

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Palët do ta kenë për qëllim t'i zhvillojnë dhe t'i përforcojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në sektorin privat, themelimin e ndërmarrjeve të reja në fusha të cilat ofrojnë potencial për zhvillim dhe bashkëpunim mes NVM-ve nga Republika e Maqedonisë dhe nga Bashkësia.

6





E DREJTA E PRONËSISË INTELLEKTUALE



KAPITULLI 7

E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

Në botën bashkëkohore ka shumë mënyra dhe masa të mbrojtjes në rast se dikush ju vjedh diçka, ju shkatërron diçka, etj. Pronën tonë e ruajmë me fshehje, mbyllje, vënie nën mbikëqyrje ose ruajtje, kurse mbrojtja (dhe sanksionimi i tjetërsimit ose shkatërrimit të pronësisë së huaj) është definuar edhe me ligj. Mënyrat dhe metodat e përmendura kanë të bëjnë me të mirat materiale, por çka ndodh me ato të mira të cilat është e pamundshme të mbrohen me fshehje, mbyllje ose me masa tjera të mbrojtjes fizike? Të mirat jomateriale, vlera e të cilave përbëhet nga shumimi, përdorimi dhe shfaqja para njerëzve tjerë, janë të mbrojtura me të drejtat e pronësisë intelektuale. Ligji për pronësi intelektuale nënkupton mbrojtje të së drejtës autoriale dhe të drejtave tjera të ngjashme me atë pronësi industriale. Përdorimi ose shumimi i paautorizuar i lëndëve me pronësi intelektuale paraqet shkelje të ligjit dhe kjo sanksionohet, kurse e drejta e pronarit për disponim, përdorim dhe realizim të dobisë mbrohet me mjetet dhe institucionet e sistemit juridik.

E drejta autoriale dhe vepra autoriale

E drejta autoriale ka të bëjë me të drejtën e autorit që të disponojë me veprat e tij letrare, shkencore ose artistike dhe me veprat e fushave tjera kreative. Personit i takon e drejta autoriale me vetë krijimin e veprës, që do të thotë që, për ta fituar këtë të drejtë, nuk duhet patjetër ta paraqesë atë paraprakisht, e

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 71

Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare

Në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe të Aneksit VII, Palët e vërtetojnë rëndësinë të cilën ia japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efektive dhe realizimit të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Republika e Maqedonisë do t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme me qëllim që të garantojë, jo më vonë se pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shkallë të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, të ngjashme me atë që ekziston në Bashkësinë Evropiane, duke i përfshirë edhe mjetet efektive për realizim të këtyre të drejtave.

Republika e Maqedonisë obligohet që, gjatë periudhës së lartshënuar, të aderojë ndaj konventave multilaterale për të drejta të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, të shënuara në Aneksin VII.

Nëse paraqiten probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, të cilat kanë ndikim mbi kushtet tregtare, ato do t'i kumtohen urgjentisht Këshillit për stabilizim dhe asociim, me kërkesë të njëres prej Palëve, me qëllim të arritjes së zgjidhjeve të pranueshme për të gjithë.

as ta regjistrojë atë. Një prej shembujve të veprës autoriale është skenari. Që të mund të shfrytëzohet skenari, është i nevojshëm aprovimi i autorit dhe nënshkrimi i marrëveshjes për shfrytëzim të veprës.

Qëllimi i akteve evropiane në aspekt të mbrojtjes së të drejtave evropiane është adaptimi i akteve nacionale të shteteve-anëtare, me çka në mënyrën më të mirë të mundshme do të ndiqej zhvillimi teknologjik, por edhe zhvillimi i obligimeve ndërkombëtare të pranuar në suaza të Organizatës botërore për pronësi intelektuale. Rregullat i rregullojnë fushat në vijim:

- Mbrojtjen juridike të programeve kompjuterike
- Kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës autoriale dhe të drejtave të ngjashme
- Të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme në shoqërinë informatike, të drejtën e marrjes me qira dhe të dhënies me qira
- Të drejtën e ndjekjes në dobi të autorit origjinal të veprës së artit figurativ
- Të drejtën autoriale dhe të drejtat e ngjashme në lidhje me radio-difuzionin satelitor dhe ritransmisionin kabllorik
- Të drejtën juridike të topografisë së prodhimeve gjysmë-përçuese dhe
- Mbrojtjen juridike të bazave të të dhënave

Pronësia industriale

Pronësia industriale përfshin të drejta me të cilat prodhuesit prej konkurrencës i mbrojnë interesat e tyre afariste, pozitën në treg dhe mjetet e investuara në hulumtim, zhvillim dhe promovim të prodhimeve.

Dizajni industrial e mbron formën e re të jashtme ose pamjen e prodhimeve. Masa tjera të mbrojtjes

së aspekteve dhe veçorive individuale të prodhimeve janë edhe patenta, me të cilën mbrohet zgjidhja e re e ndonjë problemi teknik, dhe marka tregtare, e cila shërben për dallim prej prodhimeve ose shërbimeve të ngjashme të cilat tashmë ekzistojnë në treg. Legjislacioni ligjor i BE-së përcakton pikë të përbashkët fillestare për mbrojtje të dizajnit industrial dhe krijon sistem të përbashkët për dizajn industrial të Bashkësisë (RCD) dhe markë tregtare të Bashkësisë (CTM).

Ky varg i rregullave të harmonizuara ka të bëjë me mbrojtjen e markave tregtare dhe të dizajnit industrial dhe me regjimin pjesërisht të harmonizuar për patenta. Mes tjerash, rregullat e përmendura i definojnë edhe kushtet për dhënie të licencës së dhunshme të patentës për prodhim të prodhimeve farmaceutike të cilat janë të dedikuara për eksport në shtete me probleme në shëndetësinë publike.

A dëshironi t'ia prezantoni opinionit shpikjen tuaj

Para çfarëdo qoftë prezantimi të shpikjes në opinion, patjetër duhet të parashtrohet paraqitje për patentë, për shkak se me zbulimin e shpikjes në opinion para parashtrimin të paraqitjes së përmendur ajo e humb cilësinë e risisë dhe mbrojtja tashmë është e pamundshme. Zbulimi i shpikjes i përfshin të gjitha format e prezantimit të saj në opinion: publikimi gojor ose me shkrim i punimeve profesionale dhe shkencore, lëshimi i shpikjes në qarkullim, reklamimi, ekspozimi, prezantimi, etj. Përpos kësaj, është e rekomandueshme që, para parashtrimin të paraqitjes, për shpikjen të dinë vetëm ata të cilët duhet të dinë patjetër (bashkëpunëtorët në zhvillimin e shpikjes) dhe nëpunësit e të drejtës së patentës, të cilët me detyrë zyrtare janë të obliguar ta ruajnë fshehtësinë.



Për implementim të rregullave të lartshënuara të cilat kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale, Bashkimi Evropian prej shteteve-anëtare kërkon edhe ekzistim të sistemit përkatës efikas për dënim

- të shkeljes së kësaj të drejte nëpërmjet zbatimit
- të dënimeve kundër falsifikimit të mallrave dhe
- piraterisë, që njëkohësisht ndikon pozitivisht mbi
- bartësit e të drejtave të pronësisë intelektuale.

POLITIKA E KONKURRENCËS



KAPITULLI 8

POLITIKA E KONKURENCËS

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 39

Monopolet shtetërore

Republika e Maqedonisë në mënyrë progresive do t'i adaptojë të gjitha monopolet shtetërore me karakter komercial ashtu që të sigurohet që, deri në fund të vitit të pestë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, nuk do të ketë diskriminim mes shtetasve të shteteve-anëtare dhe të Republikës së Maqedonisë në aspekt të kushteve në të cilat prodhimet blihen dhe plasohen në treg. Komiteti për stabilizim dhe asociim do të jetë i informuar për masat të cilat ndërmerren për arritje të këtij qëllimi.

Zbatimi i politikës së konkurrencës

Komisioni Evropian ka konstatuar që, prej vitit 1994 deri në vitin 2002, 14 ndërmarrje në Holandë janë marrë vesh për çmimin e katranit, dhe për këtë arsye ato janë dënuar me 267 milionë euro. Anëtarë të kartelit kanë qenë tetë prodhues dhe gjashtë kompani ndërtimore, të cilat mes vete janë marrë vesh për çmimet. Vetë karteli ka funksionuar tetë vjet, derisa autoritetet holandeze nuk kanë vënë re që katrani në shtet është shumë më i shtrenjtë se katrani në pjesën tjetër të tregut të përbashkët të BE-së. Anëtarët e kartelit e kanë caktuar çmimin në nivel konsiderueshëm më të lartë se ai në tregun evropian, me qëllim që më vonë të fitojnë kthim të mjeteve

dhe zbritje maksimale për dallim nga ndërtimtarët jashtë atij rrethi. Çmimin e kanë paguar obliguesit tatimorë, për shkak se autostradat (me shfrytëzim të katranit) në Holandë ndërtohen prej buxhetit shtetëror. Shkelja e ligjit të tregut të brendshëm është e sanksionuar me dënim të lartë në të holla. Për shkelje të rregullave të konkurrencës, dënimi rekord i është shqiptuar kompanisë Majkrosoft, në shumë prej gjysmë miliardë eurove.

Formimi i karteleve është vetëm një prej shembujve të shkeljes së politikës së konkurrencës të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian e ndjek dhe e sanksionon secilën sjellje të shoqërive tregtare me të cilën dëmtohet konkurrenca në treg. Rregullat në lidhje me këtë temë shqyrtohen në suaza të Kapitullit 8, i cili përmban rregulla për pengim të procedurave të cilat ndikojnë negativisht mbi konkurrencën e tregut në BE. Është e rëndësishme të theksohet se si shtetet-anëtare kanë obligim që plotësisht të bashkëpunojnë me Komisionin Evropian në zbatimin e kësaj politike.

Çka janë marrëveshjet kufizuese?

Forma më e shpeshtë e marrëveshjeve kufizuese mes ndërmarrjeve janë të a.q. kartelev. Zakonisht, kartelet janë marrëveshje të fshehta, gojore dhe joformale, të lidhura mes konkurrentëve në treg me qëllim që të mënjanohet çfarëdo goftë konkurrence e tregut mes tyre dhe që të realizojnë fitim plotësues i cili nuk është rezultat i punës së tyre të suksesshme

në treg. Zakonisht, anëtarët e kartelit merren vesh për çmimet, sasisë e prodhimit, zbritjet në çmime, zgjedhjen e blerësit të cilin do ta shërbejnë me mall dhe për zgjedhjen e rajonit i cili do të shërbehet. Për shkak të pasojave negative, marrëveshjet e këtilla janë të ndaluara.

Marrëveshjet të cilat i lidhin ndërmarrjet të cilat nuk veprojnë në nivel të njëjtë të prodhimit, përkatësisht distribucionit, për shembull mes prodhuesit dhe distributorit të prodhimeve ose mes furnizuesit të lëndës së parë dhe prodhuesit, gjithashtu mund të sjellin deri në kufizim të konkurrencës së tregut, posaçërisht në rast kur marrëveshjet e tilla përmbajnë kufizime të cilat sjellin deri te krijimi i pengesave për hyrje të pjesëmarrësve, përkatësisht konkurrentëve të rinj në treg.

Megjithatë, nëse marrëveshja i plotëson kushtet e përcaktuara, ajo mund të jetë e lejuar, por pasojat pozitive të asaj marrëveshjeje duhet patjetër qartazi t'i tejkalojnë pasojat negative mbi konkurrencën e tregut.

Keqpërdorimi i pozitës dominuese

Ndërmarrjet mund ta keqpërdorin pozitën dominuese dhe të imponojnë çmime të padrejta blerëse dhe shitëse, duke e kufizuar prodhimtarinë ose lëvizjen në dëm të konsumatorëve, duke aplikuar kushte të pabarabarta për gjëra të njëjta te ndërmarrje të ndryshme, me çka dëmtohet konkurrenca lojale. Procedurat e shënuara të paligjshme gjithashtu i nënshtrohen revizionit gjyqësor të Gjykatës evropiane të drejtësisë dhe sanksionohen me të holla.

Koncentrimi (Bashkimet)

Në shikim të parë ndoshta nuk mund të vërehet cilat do të ishin pasojat negative të bashkimit ose marrjes së një ndërmarrjeje nga ana e ndonjë ndërmarrjeje tjetër. Komisioni Evropian e ndalon koncentrimin e ndërmarrjeve nëse ekziston rrezik që kjo do ta dëmtonte konsiderueshëm konkurrencën e tregut. Zvogëlimi i konkurrencës sjell deri në pasojat të mëdënjshme negative, para së gjithash për konsumatorët: paraqitet zvogëlim i konkurrencës në çmime, zvogëlohet zgjedhja e prodhimeve në treg, kurse motivimi për inovacione në prodhimtari bie në nivel më të ulët.

Ndihma shtetërore

Për t'u mbrojtur prodhuesit vendas, autoritetet nacionale ndonjëherë u ndajnë ndihmë shtetërore ndërmarrjeve vendase, me çka do të nxitnin aktivitetet e caktuara ekonomike ose do ta mbronin industrinë nacionale. Ndihma shtetërore mund të paraqitet në formë të kredive të volitshme, subvencioneve, fshirjes së borxheve, qasjes pa pagesë deri te infrastruktura, etj. Komisioni Evropian e ndalon llojin e këtillë të përkrahjes, për shkak se për funksionim të tregut të lirë është jashtëzakonisht e rëndësishme që të gjitha subjektet në treg të garojnë në kushte të barabarta. Shumat e ulëta të ndihmës (deri në 200.000 euro në periudhë prej 3 viteve) nuk ndikojnë mbi tregtinë mes shteteve-anëtare dhe mund të ndahen për të gjitha qëllimet, përveç për nxitje të eksportit, prodhim të çelikut, në funksion të qarkullimit dhe te ndërmarrje me vështirësi në funksionim.

Neni 69

Konkurrenca dhe dispozitat tjera ekonomike

Procedurat në vijim nuk janë në përputhje me funksionimin e rregullt të Marrëveshjes derisa ato mund të kenë ndikim mbi tregtinë mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë:

- i. të gjitha marrëveshjet mes ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktika e ndërsjellë mes ndërmarrjeve, të cilat si qëllim ose pasojë kanë ose paraqesin pengim, kufizim ose dëmtim të konkurrencës;
- ii. keqpërdorimi nga një ose më shumë ndërmarrje i pozitës dominuese në territorin e Republikës së Maqedonisë ose të Bashkësisë në tërësi ose në ndonjë pjesë të saj më të madhe;
- iii. cilado qoftë ndihmë publike që e dëmton ose kërcënohet ta dëmtojë konkurrencën nëpërmjet favorizimit të ndërmarrjeve të caktuara ose prodhimeve të caktuara.

Çfarëdo qoftë praktike që është në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet në bazë të kriterëve të cilat rrjedhin nga zbatimi i rregullave të neneve 81, 82 dhe 87 të Marrëveshjes për themelim të Bashkësisë Evropiane.

Për shkak të zbatimit të dispozitave nga paragrafi 1 (iii), Palët pajtohen që, gjatë 4 viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të vlerësohet tërësi ndihma publike që i është ndarë Republikës së Maqedonisë, duke e marrë parasysh faktin që Republika e Maqedonisë do të trajtohet si rajon identik me ato rajone të Bashkësisë të përshkruara në nenin 87(3)(a) të Marrëveshjes për themelim të Bashkësisë Evropiane.

Secila Palë do të sigurojë transparencë në fushën e ndihmës publike, mes tjerash, nëpërmjet raporteve vjetore Palës tjetër për shumën e përgjithshme dhe shpërndarjen e ndihmës së dhënë dhe nëpërmjet sigurimit, nëse kërkohet, të informatës për skemën e ndihmës. Me kërkesë të njëres prej Palëve, Pala tjetër do të sigurojë informata për raste të caktuara individuale të ndihmës publike.

Secila Palë do të sigurojë që dispozitat e këtij neni të aplikohen gjatë pesë viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Në lidhje me prodhimet e përmendura në Kapitullin II të Kreut IV:

- nuk do të aplikohet paragrafi 1(iii)
- secila praktikë që është në kundërshtim me paragrafin 1(i) do të vlerësohet sipas kriterëve të cilat i ka vendosur Bashkësia në bazë të neneve 36 dhe 37 të Marrëveshjes për themelim të Bashkësisë Evropiane dhe sipas instrumenteve të posaçme të Bashkësisë të adoptuara në këtë bazë.

Nëse Republika e Maqedonisë ose Bashkësia konsiderojnë që një praktikë e caktuar nuk është në përputhje në kuptim të paragrafit 1, dhe:

- nëse praktika e tillë shkakton ose kërcënohet të shkaktojë dëm serioz të interesave të Palës tjetër ose dëm material të ekonomisë së vet vendase, duke i përfshirë edhe shërbimet, ajo mund të ndërmarrë masa përkatëse pas konsultimit në suaza të Këshillit për stabilizim dhe asociim ose pas kalimit të tridhjetë ditëve të punës pas udhëzimit të çështjes për konsultim të tillë.

Në rast të praktikave të cilat nuk janë të harmonizuara me paragrafin 1(iii), nëse aplikohet Marrëveshja e OBT-së gjatë rastit të tillë, masat e tilla përkatëse mund të adoptohen vetëm në pajtim me procedurat dhe sipas kushteve tashmë të dhëna ose sipas rregullativës përkatëse ligjore të Bashkësisë.

Palët do të këmbëjnë informata, duke i pasur parasysh kufizimet të cilat i imponon besueshmëria profesionale dhe afariste.



MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 70

Në lidhje me ndërmarrjet publike ose ndërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të posaçme ose ekskluzive, secila Palë do të sigurojë që, prej vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të aplikohen principet e Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Evropiane, veçanërisht nenit 86.



SHËRBIMET FINANCIARE



KAPITULLI 9

SHËRBIMET FINANCIARE

Në rast se në të ardhmen do të dëshironi të themeloni shoqëri të sigurimeve ose do të dëshironi të bëni tregti me aksione në bursë, informohuni për kornizën ligjore të Bashkimit Evropian për këtë ose për tema të ngjashme. Parakusht për Evropë dinamike, inovative dhe konkurrençe është gjithsesi ekzistimi i tregut efikas financiar - faktor kyç në funksionimin e ekonomive bashkëkohore.

T'u konkurrohet fuqive botërore ekonomike në fushën e shërbimeve financiare do të thotë të vendosen rregulla të qarta dhe unike për veprimtaritë bankare, shërbimet e shoqërive të sigurimeve, të shoqërive për sigurim pensional, për tregtinë me letra me vlerë dhe për mundësitë për investim (shërbimet investuese).

Korniza ligjore për këtë fushë është përfshirë në Kapitullin 9. Shërbimet financiare në Bashkimin Evropian realizohen në bazë të dy principeve:

- Principi i pasaportës evropiane (European Passport), i cili mundëson që disa institucione financiare të punojnë në cilindo shtet-anëtar të Bashkimit Evropian pa poseduar leje të posaçme nga shteti nikoqir, dhe

- Principi i kontrollit nga shteti i huaj në të cilin ka seli institucioni financiar, që realizohet nëpërmjet themelimit të filialeve në shtete tjera ose dhënies së shërbimeve tejkufitare financiare.

Dispozitat në lidhje me veprimtarinë bankare dhe konglomeratet financiare kanë të bëjnë me rregullat për themelimin, punë dhe monitorim të të gjitha llojeve të institucioneve kreditore. Me aktet e përmendura rregullohet edhe fusha e përshtatshmërisë së kapitalit për institucionet kreditore dhe kompanitë investuese, e aktiviteteve afariste në lidhje me paratë elektronike dhe e sigurimit të depozitave. Duke e marrë parasysh atë që një numër i madh i bankave dhe institucioneve tjera financiare punojnë në më shumë shtete të Bashkimit Evropian, korniza ligjore e këtij Kapitulli përmban edhe dispozita për kontabilitetin e tyre, rregullat e riorganizimit dhe likuidimit, etj.

Një pjesë e rregullave kanë të bëjnë edhe me funksionimin e fondeve të sigurimeve dhe pensionale. Te sigurimi ka akte unike për lëshim të lejes për punë, si dhe për kontroll të shoqërive të sigurimeve,

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 83

Veprimtaritë bankare, sigurimet dhe shërbimet tjera financiare

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të vendosin dhe të zhvillojnë kornizë përkatëse për nxitje të sektorit bankar, sektorit të sigurimeve dhe sektorit të shërbimeve financiare në Republikën e Maqedonisë.

Bashkëpunimi do të jetë i orientuar drejt:

- adoptimit të sistemit të përbashkët të kontabilitetit, në përputhje me standardet evropiane;
- përforcimit dhe ristrukturimit të sektorit bankar, sektorit të sigurimeve dhe sektorëve tjerë financiarë;
- përmirësimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimit bankar dhe të shërbimeve tjera financiare;
- këmbimit të informatave, veçanërisht në lidhje me legjislacionin që përgatitet;
- përgatitjes së përkthimeve dhe fjalorëve terminologjikë.

Palët do të bashkëpunojnë për të zhvilluar sistem efikas të revizionit financiar në Republikën e Maqedonisë, i cili do të jetë në pajtim me metodat dhe procedurat e harmonizuara të Bashkësisë.

Bashkëpunimi do të jetë i orientuar drejt:

- ndihmës teknike për Shërbimin e revizorëve të Republikës së Maqedonisë;
- themelimit të seksioneve për kontroll të brendshëm në agjencitë e shtetit;
- këmbimit të informatave në lidhje me sistemin e revizionit;
- standardizimit të dokumentacionit të revizionit;
- trajnimit dhe aktiviteteve këshillëdhënëse.

me rregulla të posaçme të cilat vlejné për sistemin e sigurimit jo-jetësor. Është përcaktuar edhe obligimi për kontroll plotësues të një grupi të siguruesve, mënjanim të të gjitha pengesave për kryerje të aktiviteteve me risigurim dhe kornizë ligjore për ndërmjetësim dhe përfaqësim në sigurim. Si edhe në sektorin e veprimtarive bankare, edhe në fushën e sigurimeve ekzistojné rregulla për kontabilitetin, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive për sigurime të cilat punojné në më shumë shtete-anëtare të Bashkimit Evropian. Pikë e posaçme në këtë Kapitull është pjesa për sigurim të automjeteve motorike, me të cilën, mes tjerash, përcaktohet heqja e kontroleve kufitare për sigurim të automjeteve motorike me qëllim që të sigurohet lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave në suaza të Bashkimit Evropian.

Infrastruktura e tregut financiar është përcaktuar nëpërmjet akteve të cilat kanë të bëjnë me sistemet e pagesave (qarkullimin e pagesave) dhe me garancitë financiare.

Për shkak se letrat me vlerë dhe shërbimet investuese janë segment i rëndësishëm i veprimtarive financiare, edhe për këtë fushë janë përcaktuar akte të caktuara dhe masa të caktuara për implementim. Këto akte dhe masa kanë të bëjnë me punën dhe kontrollin e kompanive investuese, të tregjeve të rregulluara, si dhe me aktivitetet për tregti me letra me vlerë në bursë. Me qëllim që të mbrohen të drejtat e investuesit, në nivel të Bashkimit Evropian është përcaktuar që vetë investuesit t'i jepen informata të qarta dhe gjithëpërfshirëse, të nevojshme për sjellje të vendimit për investim. Rregullat kanë të bëjnë edhe me ndalimin për keqpërdorime dhe manipulime me tregun dhe ndalimin për keqpërdorim të informatave të privileguara në tregtinë me letra me vlerë.



SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT



KAPITULLI 10

SHOQËRIA INFORMATIKE DHE MEDIAT

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 93

Informatat dhe komunikimet

Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë do të ndërmarrin masa të domosdoshme për stimulim të këmbimit të ndërsjellë të informatave. Do t'u jepet prioritet programeve të orientuara drejt sigurimit të informatave themelore për Bashkësinë për opinionin, dhe të informatave më të specializuara për qarqet profesionale në Republikën e Maqedonisë.

Keni pak kohë të lirë dhe keni vendosur ta kaloni atë duke parë një film në televizion, dhe filmi posa ka filluar por tashmë emetojnë reklama. Reklamata vazhdojnë pa të ndalur. Derisa e ndiqni filmin, kuptoni që disa herë keni parë një varg reklamash, kështu që hiqni dorë nga filmi. Ju duket e njohur? Ta shohim si e zgjidh Bashkimi Evropian këtë problem, por edhe problemet e ngjashme me të.

Çka është Televizioni pa kufij?

Një pjesë e legjislacionit të BE-së për politikën audio-vizuale është direktiva për Televizion pa kufij (Television without frontiers Directive - TWF), e cila përcakton kushte për transmetim të emetimit televiziv në suaza të tregut të përbashkët evropian. Direktiva kërkon prej shteteve-anëtare që ta

koordinojnë legjislacionin nacional për të siguruar, për shembull, respektim të sasisë maksimale të reklamimit të cilin kanalet mund ta realizojnë gjatë një periudhe të caktuar (matur në minuta për një orë ose një ditë), mënjanim të pengesave për lëvizjen e lirë të programeve televizive në tregun e përbashkët, dhe mundësim që opinioni më i gjerë të ketë qasje deri te ngjarjet e rëndësishme pa pagesë plotësuese të kanalit televiziv. Dispozita e fundit ka të bëjë kryesisht me emetimin e garave ndërkombëtare sportive siç janë Lojërat olimpike, Kampionati botëror i futbollit, etj. Korniza ligjore e BE-së e cila i definon rregullat e politikës audio-vizuale, por edhe shërbimet e shoqërisë informatike dhe komunikimet elektronike, është përfshirë në Kapitullin 10.

Sipas mendimit tuaj, cili produksion i programeve televizive zë hapësirë më të madhe? Ai amerikan apo evropian? Kuptohet, përgjigja e saktë është produksioni amerikan. Është interesant fakti që në shtetet-anëtare të BE-së incizohen më shumë filma se në SHBA, por madje 75% e të hyrave në kinematë evropiane vijnë prej filmave amerikanë. Me qëllim që ta mbrojtë llojllojshmërinë e vet kulturore dhe ta promovojë produksionin lokal, BE u përcakton obligim shteteve-anëtare që ta rezervojnë së paku gjysmën e kohës së programeve televizive për emetim të filmave dhe programeve evropiane. Në Organizatën botërore tregtare, BE ka kërkuar dhe ka siguruar të a.q. „përfjashtim kulturor”, i cili u mundëson shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian që mos ta hapin



tregun e tyre për prodhimet kulturore siç janë filmat, ngjashëm si edhe te mallrat tjera të importuara prej shteteve të cilat nuk janë anëtare të BE-së.

Përpos kësaj, nëpërmjet programeve të ndryshme, Bashkimi Evropian financiarisht e përkrah produksionin e filmave evropianë dhe programeve televizive evropiane - në aspekt sasior dhe cilësor - dhe e rrit aftësinë konkurruese të industrisë lokale në nivel ndërkombëtar. Programi „Mediat plus” shpenzon 60% të mjeteve të distribucionit ndërkombëtar të filmave dhe programeve evropiane, duke e përfshirë edhe ndihmën e rrjetit „Kinematë evropiane” (Europa Cinemas), i cili ka 570 salla të kinemave në më shumë se 60 shtete.

Promovimi i produksionit evropian realizohet edhe me organizim të festivaleve dhe ekspozitave në të cilat prezantohen veprat evropiane.

Pa telefon dhe Internet? E paimagjinueshme!

A mund ta paramendoni jetën e përditshme pa telefon dhe Internet? Rezultatet tregojnë që mesatarisht 61% e amvisërive në Evropë kanë qasje edhe deri te telefonia fikse, edhe deri te ajo celulare (më së shumti në Suedi, ku kjo përqindje është 93%). Korniza ligjore e Kapitullit 10 e definon fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të shoqërisë informatike dhe i përmban rregullat të cilat mundësojnë funksionim efikas të tregut të përbashkët dhe të shërbimeve të telekomunikimit dhe rrjeteve për promovim, zhvillim dhe shtrirje të tyre të gjerë. Qëllimi i BE-së është që shfrytëzuesve t’u sigurojë shërbime me çmime të volitshme (telefon, telefaks, qasje deri te Interneti, thirrje pa pagesë për ndihmën e shpejtë) nëpërmjet stimulimit të konkurrencës së tregut dhe zvogëlimit të dominimit të monopoleve të cilat ekzistojnë edhe më tutje për shërbime të caktuara (për shembull: qasja në Internet me shpejtësi të larta).

Prioritet i BE-së është edhe pengimi i „hendekut digjital” i cili është krijuar mes rajoneve të pasura dhe të varfra të BE-së. Kjo ka të bëjë pjesërisht edhe me zvogëlimin e dallimeve në zhvillimin e rrjeteve të telekomunikimit mes 15 anëtareve „të vjetra” të BE-së dhe anëtareve „të reja” të cilat kanë aderuar në vitin 2004 dhe 2007.

Kthimi i tatimit dhe i TVSH-së, regjistrimi i automobilit të ri, ndryshimi i pronësisë së automobilit edhe atë në mënyrë elektronike, prej shtëpisë, pa prituri në radhë dhe pa humbur kohë... Edhe pse duket pak e besueshme, kjo po bëhet realitet në Bashkimin Evropian. Me zbatimin e iniciativës izo10 nxitet zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive informatike për avancim të punës së shërbimeve

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 94

Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale

Palët do të bashkëpunojnë në avancimin e industrisë audio-vizuale në Evropë dhe do të nxisin koproduksion në fushën e filmit dhe televizionit.

Palët do ta koordinojnë, dhe aty ku është e arsyeshme do ta harmonizojnë politikën për rregullim të aspekteve përmbajtësore të emetimit tejkufitar, duke u kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve në lidhje me fitimin e të drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe emetimin nëpërmjet rrjetit satelitor ose kabllovik.

publike. Qëllimi përfundimtar është të krijohet hapësirë e përbashkët informatike evropiane dhe të nxitet implementimi i inovacioneve për realizim të një prej detyrave të strategjisë së Lisbonës: krijimi i shoqërisë që do të bazohet në dituri dhe në Evropë me aftësi të lartë konkurruese në suaza globale.



BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL



KAPITULLI 11

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 24

Definicion

Dispozitat e këtij Kapitulli kanë të bëjnë me tregtinë me prodhime bujqësore dhe prodhime të peshkut, të cilat rrjedhin nga Republika e Maqedonisë ose nga Bashkësia.

Shprehja “prodhime bujqësore dhe prodhime të peshkut” ka të bëjë me prodhimet të cilat janë shënuar në Kapitujt 1 deri në 24 të Nomenklaturës së kombinuar dhe me prodhimet të cilat janë shënuar në Aneksin I, paragrafin 1, (ii) të Marrëveshjes për bujqësi (GATT 1994).

Ky definicion i përfshin peshqit dhe prodhimet e peshkut nga kreu 3, shenjat tarifore 1604 dhe 1605 dhe nën-shenjat 0511 91, 2301 20 00 dhe një pjesë të 1902 201*.

Cilat janë asociacionet e para që i keni kur ta dëgjoni fjalën “bujqësi”? Fusha, livadhe, drithëra, sanë, korrje, kope delesh dhe hardhi të rrushit? Ose: agro-bursë, sisteme informatike bujqësore, menaxhment bujqësor dhe strategji për qëndrueshmëri të zhvillimit?

Bujqësia bashkëkohore i përfshin të gjitha ato që u përmendën më lart. Përpos përpunimit të tokës dhe rritjes së bagëtisë, bujqësia përfshin edhe sistem bashkëkohor të menaxhimit, strategji të përpunuar për planifikim të prodhimitarisë, hulumtim

• të tregut, shfrytëzim të teknologjive bashkëkohore dhe mbrojtje të konsumatorëve, etj. Në çfarë mënyre mund të kyçen bujqit në këtë sistem në shikim të parë imagjinar, duke mësuar nga shembujt e krijimit dhe funksionimit të suksesshëm të Politikës së përbashkët bujqësore të Bashkimit Evropian?

• Politika e përbashkët bujqësore zhvillohet nga vetë fillimi i themelimit të Bashkimit Evropian (nga fundi i viteve të 50-ta), në periudhë të rritjes së tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore, me çka, me qasje të përbashkët ndaj çështjeve të rëndësishme, u siguroa aftësi e lartë konkurruese e Bashkimit Evropian në nivel global. Qëllimi tjetër, jo më pak i rëndësishëm, i punës së përbashkët, ka të bëjë me rregullimin e tregut të brendshëm bujqësor mes shteteve-anëtare, si dhe me sigurimin e sasive të mjaftueshme të ushqimit në kontinentin evropian. Në këtë kuptim, janë adoptuar një varg aktesh të cilat mundësojnë funksionim të suksesshëm të bujqësisë në dhe jashtë Bashkimit Evropian. Për dallim prej disa kapitujve për të cilët ekziston një numër më i vogël i ligjeve evropiane dhe për të cilët pjesa më e madhe e ingjerencave u është lënë vetë shteteve-anëtare, bujqësia është në ingjerenca ekskluzive të BE-së dhe përfshin madje 45% të legjislacionit evropian. Kjo përfshin sistem për përkrahje të bujqve, themelim të institucioneve kompetente për zbatim të Politikës së përbashkët bujqësore, vendosje dhe mbajtje të të dhënave kontabiliste të ekonomive, çështje në lidhje me promovimet e prodhimeve bujqësore dhe organizimin e tregjeve

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 25

Protokolli 3 i përcakton aranzhmanet tregtare për prodhimet e përpunuara bujqësore të cilat janë shënuar në të.

për grupe të caktuara të prodhimeve (veçanërisht për drithëra, sheqer, qumësht dhe prodhime të qumështit, pemë dhe perime, mish, vezë dhe shpendë, etj.). Një prej masave të realizuara për zbatim të suksesshëm të Politikës së përbashkët bujqësore ka qenë edhe heqja e doganës për import dhe eksport të prodhimeve bujqësore mes shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian.

Për çka shërbejnë kuotat bujqësore dhe organizatat e përbashkëta të tregut?

Problemet e bujqësisë në vitet e 50-ta dallohen prej problemeve të sotme, dhe ndonjëherë janë madje edhe të kundërta me to. Derisa në të kaluarën detyra kryesore ka qenë të sigurohet sasi e mjaftueshme e ushqimit për banorët e shteteve-anëtare, sot Bashkimi Evropian lufton me tepricat e tregut. Për zgjidhje të problemit të ngopjes së mundshme të tregut të përbashkët me sasi tepër të madhe të një prodhimi të caktuar, janë implementuar kufizime të prodhimeve në formë të kuotave prodhuese, të cilat janë përcaktuar posaçërisht për secilin shtet-anëtar, varësisht nga mesatarja e prodhimitarisë gjatë disa viteve të fundit (e a.q. periudhë referente).

Për sistemin unik të tregtisë me prodhime bujqësore brenda në Bashkimin Evropian janë krijuar të ashtuquajtura radhë të përbashkëta të tregut, me të cilat rregullohet tërë prodhimitaria bujqësore për grupe të caktuara të prodhimeve: drithëra,

mish, qumësht, pemë, perime, vezë, etj. Krijimi i organizatave të tregut përfshin edhe përcaktim të niveleve të çmimeve për prodhime të caktuara, si dhe të çmimit më të ulët të garantuar për një njësi mase, me çka shmangen çrregullime më të mëdha të tregut vendas të prodhimeve të caktuara dhe sigurohen të ardhura stabile dhe standard jetësor i prodhuesve bujqësorë, si dhe i përpunuesve.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Bashkësia do t'i heqë të gjitha kufizimet kuantitative, si dhe masat të cilat kanë ndikim të barabartë, mbi importin e prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut të cilat rrjedhin nga Republika e Maqedonisë.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Republika e Maqedonisë do t'i heqë të gjitha kufizimet kuantitative, si dhe masat të cilat kanë ndikim të barabartë, mbi importin e prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut të cilat rrjedhin nga Bashkësia.

Politika bujqësore sot

Ndryshimet në tregun botëror, ndryshimet e çmimeve, si dhe ndryshimet e shpenzimeve të industrisë dhe transportit reflektohen më shpejt dhe më fuqishëm mbi prodhimet bujqësore, në krahasim me ato industriale. Sipas kësaj, është logjike që, pa marrë parasysh trendin botëror të liberalizimit të tregtisë, politika bujqësore edhe më tutje do të ketë detyrë ta mbrojë prodhimtarinë vendase, por në kombinim me masat e ndryshme për avancim të tërë hapësirës rurale. Politika bujqësore nuk është dukuri statike. Ajo është proces i cili formësohet dhe adaptohet ndaj kërkesave të ambientit ekonomik -

brenda në bashkësinë nacionale, por edhe në ndikimet të cilat vijnë nga tregu botëror. Për këtë arsye, Politika e përbashkët bujqësore e vitit 2000 përjeton reforma ashtu që të adaptohet ndaj kushteve të reja globale, dhe me këtë ta sigurojë aftësinë e vet konkurruese.

Një prej karakteristikave të rëndësishme të reformave të Politikës së përbashkët bujqësore është implementimi i sistemit të ri të stimulimeve të bujqve, përkatësisht i sistemit për pagesë unike sipas ekonomisë. Në këtë sistem, stimulimet nuk varen më nga sasia e prodhimit, por nga respektimi i praktikës së mirë bujqësore dhe i kushteve ekologjike të prodhimit. Me fjalë tjera, prodhuesi bujqësor fiton mjete të caktuara, pa marrë parasysh atë se a i prodhon ato prodhime.

Reforma e politikës bujqësore i kushton vëmendje më të madhe zhvillimit rural në shtetet-anëtare, që i përfshin:

- mbrojtjen e mjedisit jetësor
- ripërtëritjen dhe zhvillimin e fshatrave
- ruajtjen e pasurisë kulturore, zakoneve dhe manifestimeve fshatare
- aktivitetet për realizim të burimeve plotësuese ose alternative të të hyrave
- turizmin fshatar dhe zejjet tradicionale fshatare
- përmirësimin e infrastrukturës rurale të lidhur me zhvillimin e bujqësisë, promovimin e rrugëve të verës dhe rrugëve tjera turistike, si dhe të prodhimeve cilësore ekologjike dhe autoktone.

Zhvillimi rural i përfshin edhe masat e politikës sociale, meqenëse ato synojnë drejt modernizimit të prodhimit bujqësor dhe motivimit të të rinjve që të mbesin në rajonet rurale nëpërmjet popullarizimit të arsimit dhe stimulimit të kësaj sërë në sistemin e bujqësisë bashkëkohore. Për shkak të vetëdijes gjithnjë më të lartë të konsumatorëve për karakteristikat e ushqimit, si dhe të rritjes së fuqisë blerëse të konsumatorëve në Bashkimin Evropian, është rritur edhe kërkesa për prodhime autoktone dhe ekologjike (organike), me çka bujqësia ekologjike u bë një prej pikave të rëndësishme në financimin e Politikës së përbashkët bujqësore evropiane dhe perspektivës për zhvillim të mëtutjeshëm rural.

A ekzistojnë ndalime në prodhimtarinë e prodhimeve vendase bujqësore?

Bashkimi Evropian nuk e ndalon, por përkundrazi, e nxit prodhimtarinë e prodhimeve vendase bujqësore, por nëpërmjet masave në vijim: plotësimi i kushteve për ruajtje të bagëtisë, kushteve për të qenët në rregull nga aspekti shëndetësor i ushqimit të bagëtisë, kushteve teknologjike të prodhimit, kushteve veterinarë, etj., me qëllim të arritjes së shqiptimit më të lartë të sigurisë së ushqimit në Bashkimin Evropian. Prodhimet autoktone mund të përmbajnë edhe shenjë të prejardhjes gjeografike, kurse prodhimeve të caktuara, nëse i plotësojnë normat evropiane, mund t'u ndahen edhe shenja për autenticitet ose shenjë për reputacion tradicional. Nëse ndonjë prodhim bujqësor është dedikuar për konsum personal, dhe jo për treg, mbi atë prodhim nuk aplikohen masat e Politikës së përbashkët bujqësore. Së këndejmi, frika aktuale e opinionit nga ndalimi i prodhimit të rakisë shtëpiake është e paarsyeshme.

Neni 27

Prodhimet bujqësore

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia do t'i heqë taksat doganore dhe taksat tjera të cilat kanë efekt të njëjtë për importin e prodhimeve bujqësore me prejardhje nga Republika e Maqedonisë, me përjashtim të atyre prej 1* Pjesës prej 1902 20 për "brumëra të mbushura, të ziera ose të paziera ose të përgatitura në ndonjë mënyrë tjetër, me përmbajtje prej më shumë se 20% të masës prej peshqve, krustaceve, butakëve ose pakurrizorëve tjerë ujorë" të përfshira në shenjat tarifore 0102, 0201, 0202 dhe 2204 të Nomenklaturës së kombinuar.

Për prodhimet e përfshira në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së kombinuar, për të cilat Tarifa e përbashkët doganore parasheh pagesë të doganës mbi vlerë dhe të taksave të posaçme, heqja e taksave ka të bëjë vetëm me doganën mbi vlerën.

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia do t'i përcaktojë taksat doganore të cilat do të aplikohen gjatë importit në Bashkësi të prodhimeve të mishit të viçit ("baby-beef") të definuara në Aneksin III me prejardhje nga Republika e Maqedonisë, në 20% të taksës së doganës së vlerës dhe 20% të taksës së posaçme të përcaktuar në Tarifën e përbashkët doganore të Bashkësive Evropiane, në suaza të vëllimit të kufizuar të kuotës vjetore tarifore prej 1 650 tonëve të shprehura në peshë të përpunuar (carcass).

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë:

a) do t'i heqë taksat doganore të cilat aplikohen gjatë importit të disa prodhimeve bujqësore me prejardhje nga Bashkësia, të shënuara në Aneksin IV (a);

b) do t'i heqë taksat doganore të cilat aplikohen gjatë importit të disa prodhimeve bujqësore me prejardhje nga Bashkësia, të shënuara në Aneksin IV (b), në pajtim me kuotat tarifore të përcaktuara për secilin prodhim në atë Aneks. Për sasitë të cilat i tejkalojnë kuotat tarifore, Republika e Maqedonisë do t'i zvogëlojë taksat doganore në mënyrë progresive, në pajtim me orarin kohor të përcaktuar për secilin prodhim në atë Aneks.

c) në mënyrë progresive do t'i zvogëlojë taksat doganore të cilat aplikohen gjatë importit të disa prodhimeve bujqësore me prejardhje nga Bashkësia, të shënuara në Aneksin IV (c) në suaza të kufizimeve të kuotave tarifore dhe në pajtim me orarin kohor i cili ka të bëjë me secilin prodhim në këtë Aneks.

Aranzhanet tregtare për verën dhe pijet alkoolike do të definohen në marrëveshje të veçantë për verën dhe pijet alkoolike.

Çka duhet patjetër të bëjnë shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian që të kyçen në Politikën e përbashkët bujqësore?

Kushtet kryesore për përshtatje me politikën bujqësore të BE-së janë: shënimi unik i parcelave bujqësore, zhvillimi i sistemit të identifikimit të kafshëve shtëpiake në pajtim me legjislacionin e BE-së, modernizimi i përpunimit të prodhimeve të qumështit dhe të mishit, me çka do të plotësoheshin standardet e larta teknologjike dhe higjienike, dhe vëmendje e posaçme i kushtohet sistemit unik për mbledhje të të dhënave (statistikës) në pajtim me standardet dhe metodologjinë e BE-së.

Anëtarësimi i shteteve në BE- do të thotë edhe rritje e stimulimeve për bujqit, të cilat paguhen për fermë, në afat prej 60 ditëve. Përvoja e shteteve të reja anëtare tregon që, me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, vlera e stimulimeve në bujqësi është rritur për 30 deri në 40%.

Premton shumë, por kush e financon këtë?

Masat e politikës bujqësore financohen me ndihmë të dy fondeve strukturore: Fondi garantues bujqësor evropian dhe Fondi bujqësor evropian për zhvillim rural, të cilat, nga ana tjetër, mbushen prej parave të cilat i ndajnë shtetet-anëtare. Politika e përbashkët bujqësore ka pjesëmarrje të lartë në buxhetin e BE-së. Në perspektivën financiare të BE-së për periudhën 2007-2013, kjo pjesëmarrje është madje 39%.

Secili shtet anëtar, si shfrytëzues i fondeve të përmendura, është i obliguar të themelojë Agjenci të pagesave, e cila do t'i koordinojë dhe do t'i kontrollojë stimulimet prej fondeve të cilat u jepen bujqve.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 100

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi në këtë fushë do ta ketë për qëllim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial, ekonomizimit të ujërave, zhvillimit rural, harmonizimin gradual të legjislacionit veterinar dhe fito-sanitar me standardet e Bashkësisë dhe zhvillimin e peshkatarisë dhe pylltarisë në Republikën e Maqedonisë.

SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA
VETERINARE DHE FITO-SANITARE



KAPITULLI 12

SIGURIA E USHQIMIT, POLITIKA VETERINARE DHE FITO-SANITARE

Mikro-çipat për shënim të kafshëve, sistemi i alarmimit për ushqimin dhe pasaportat bimore janë tema të cilat ndoshta nuk i keni hasur deri tani, por lopët e çmendura, salmonela, trihinelozja dhe gripi i shpezëve janë me siguri të njohura për ju. Këto, por edhe çështje tjera për tema të lidhura, janë të përfshira në Kapitullin 12.

Si ballafaqohet Bashkimi Evropian me problemin e sigurisë së ushqimit?

Me përcaktimin e cilësisë dhe të qenët në rregull të ushqimit nga aspekti shëndetësor sot merren

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 100

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi në këtë fushë do ta ketë për qëllim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial, ekonomizimit të ujërave, zhvillimit rural, harmonizimin gradual të legjislacionit veterinar dhe fito-sanitar me standardet e Bashkësisë dhe zhvillimin e peshkatarisë dhe pylltarisë në Republikën e Maqedonisë.

autoritetet nacionale dhe prodhuesit, kurse (pa) siguria e ushqimit është lëndë e interesimit gjithnjë më të madh të vetë konsumatorëve.

Strategjia e Bashkimit Evropian për sigurinë e ushqimit e vitit 2004 quhet “prej fermës deri te piruni” („from the farm to the fork”), dhe qëllimi i saj është sigurimi i shkallës së lartë të sigurisë së ushqimit në të gjitha fazat e udhëtimit të tij, i cili mund të jetë shumë i gjatë në aspekt kohor dhe hapësinor: prej prodhimit dhe transportit deri te ruajtja dhe përgatitja e ushqimit. Strategjia e përmendur përmban katër tregues themelorë: rregullimi i sigurisë së ushqimit për njerëzit dhe kafshët, mendimi i pavarur dhe qëndrimi i shëndetësisë publike, aktivitetet konkrete për zbatim të rregullativave dhe kontrolleve të procesit, dhe njohja e të drejtave të konsumatorëve për zgjedhje në bazë të informatës së plotë për prejardhjen dhe përbërjen e ushqimit.

Pranimi dhe zbatimi i dispozitave të cilat i përcakton BE për prodhimin dhe përpunimin e ushqimit kërkojnë angazhime posaçërisht të mëdha. Për shkak të kësaj, shtetet “e reja” anëtare të BE-së (anëtarët prej vitit 2004 dhe 2007) kanë periudhë të caktuar të tranzicionit për adaptim të legjislacionit në këtë Kapitull. Komponenti më i rëndësishëm i legjislacionit është vlerësimi shkencor i rrezikut, pas të cilit vijon analiza e rrezikut si pikë fillestare e

lidhur me sigurinë e ushqimit. Me qëllim të analizës së rrezikut, në vitin 2002 është themeluar Agjencia evropiane për sigurinë e ushqimit (European Food Safety Agency - EFSA) me seli në Parma, Itali. Zbatimi i ligjit dhe kontrolleve bëhet, mes tjerash, nëpërmjet të ashtuquajturit sistem për alarmim të shpejtë për ushqimin (Rapid Alert System for Food and Feed – RASFF). Ky sistem mundëson qasje deri te informatat për rreziqet e reja në afat më të shkurtë, me çka konsumatorët do të merrnin informatë të plotë për ushqimin të cilin e blejnë dhe e konsumojnë, dhe është përcaktuar edhe shënimi i posaçëm i prodhimeve.

Çka nënkuptohet me adaptimin ndaj standardeve të përbashkëta për siguri të ushqimit?

Për ne si konsumatorë është e natyrshme që të gjitha prodhimet ushqimore prej rafteve në dyqane të jenë në rregull nga aspekti shëndetësor dhe të shënuara në mënyrë të duhur, dhe më së shpeshti nuk mendojmë se sa e gjatë dhe gjithëpërfshirëse është përgatitja e cila nevojitet që secili prodhim të gjendet në treg. Pikat fillestare për përfshirje të

shtetit-anëtar në sistemin unik të funksionimit janë sjellja e ligjeve për ushqimin, hartimi i strategjisë nacionale për siguri të ushqimit në pajtim me kërkesat e BE-së, si dhe themelimi i institucionit për koordinim dhe kontroll të zbatimit të tyre - Agjencisë për ushqim. Detyra e tyre është t'i vlerësojnë rreziqet të ushqimi dhe ta informojnë opinionin për rezultatet dhe rreziqet potenciale. Më parë, vlerësimi i rrezikut realizohej kryesisht nëpërmjet analizave laboratorike, por sot ai kërkon një procedurë më të ndërlikuar: analizë të shprehive të të ushqyerit, duke mbajtur llogari për grupet e ndjeshme të konsumatorëve, dhe analizë të të dhënave epidemiologjike dhe njohurive shkencore.

Një pjesë e adaptimit ndaj sistemit të BE-së e përfshin edhe vendosjen e sistemit për menaxhim të sigurisë së ushqimit (Hazard Analysis and Critical Control Point – HACCP), i cili është pranuar në nivel ndërkombëtar (i vërtetuar nga Organizata botërore shëndetësore dhe nga Bashkimi Evropian) me qëllim që të mbrohen konsumatorët. Marrja e certifikatës HACCP është parakusht për plasman të prodhimeve në tregun e BE-së. Sipas sistemit të përmendur, secili subjekt i cili punon me ushqim, përveç prodhuesit primar, është i obliguar të vendosë sistem të

Shembuj për porosi në sistemin e alarmimit të shpejtë:

data	Shkaku për alarmim	Shteti i prejardhjes
04/01/2007.	Afati i kaluar i përdorimit të salmonit atlantik	KILI
05/01/2007.	Mashtrim - afati i ndryshuar i përdorimit të konservave me peshq	POLONIA
09/01/2007.	Copa të qelqit në çokollata	HOLANDA

vetëkontrollit në objektet për prodhim të ushqimit, që kërkon investime plotësuese në arsimimin e ekspertëve dhe në infrastrukturën për zbatim të praktikave efikase prodhuese dhe higjienike.

Deklarimi i prodhimeve ushqimore para lëshimit në treg

Ndoshta lista e të dhënave të obligueshme për secilin prodhim ushqimor para lëshimit të tij në treg do t'ju duket e gjatë dhe e panevojshme, por provoni të paramendonin një prodhim në raft të dyqanit pa:

- emër
- listë me përbërës
- sasi të përbërësve të caktuar
- neto-peshë
- afat të përdorimit
- kushte për ruajtje dhe përdorim, ku është e nevojshme kjo, përkatësisht nëse mund të ndikojë mbi afatin e përdorimit të ushqimit
- emër dhe adresë të prodhuesit



- për prodhimet e importuara, përpos emrit dhe adresës së prodhuesit, nevojitet të shënohet edhe selia e importuesit dhe shteti i prejardhjes
- udhëzim për përdorim, aty ku kjo është e nevojshme për shkak të shfrytëzimit në mënyrë të duhur
- intensitet të vërtetë të alkoolit për vëllim, për pije të cilat përmbajnë më shumë se 1,2 pjesë të vëllimit të alkoolit.

A do të blinit prodhim ushqimor në të cilin nuk është shënuar afati i përdorimit ose lista e përbërësve nëse, për shembull, jeni alergjikë ose keni diabet? Pas këtyre pyetjeve, a ju duket edhe më tutje lista tepër e gjatë?

Çka parasheh sistemi veterinar i BE-së?

Për ta harmonizuar sistemin e vet veterinar me atë të BE-së, secili shtet-anëtar duhet patjetër të krijojë bazë elektronike të të dhënave për evidentim të kafshëve. Për shembull, është përcaktuar shënimi i derrave me pullë në vesh. Një organizatë e autorizuar u lëshon pronarëve vërtetim me të dhëna për vendin e prejardhjes, numrin e kafshës dhe datën e lindjes së kafshës, gjininë, numrin e nënës (nëse është e njohur), numrin e babait (nëse është i njohur), të dhëna për pronarin (emri dhe mbiemri, adresa, shifra e fermës) dhe datën e shënimit, si dhe ISO-shifrën e vendit të prejardhjes. Gjatë therjes së derrit, bashkë me ekzemplarin e përcaktuar për kontroll të mishit për trihenozë, pronari duhet patjetër t'ia dorëzojë organizatës së autorizuar veterinare pullën e veshit të kafshës së therur, ashtu që në rast të zbulimit të infektimit do të dihej se prej cilës fermë vjen kafsha e infektuar. Shënimi i përtypësve bëhet me ndihmë të kapsulave elektronike, të cilat mbesin përgjithmonë në lukthin e përtypësit dhe lexohen me ndihmë të lexuesit elektronik. Për dallim nga pulla e veshit, kapsulat elektronike nuk mund të mënjanohen.

Kërkesat tjera kanë të bëjnë me sistemin e lëshimit të pasaportave të kafshëve, përpunimin dhe realizimin e planit për kontrollin veterinar në kalimet kufitare me shtete të treta (shtete të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian) dhe me investimin e vazhdueshëm në infrastrukturë dhe në rritjen e profesionalizmit të njerëzve.

Kushtet fito-sanitare të BE-së

Politika fito-sanitare e BE-së përfshin kontroll të organizmave të dëmshëm, të mjeteve për mbrojtje të bimëve dhe kontroll të cilësisë së farërave dhe të materialit mbjellës. Shtetet-anëtare janë të obliguara të themelojnë stacione për kontroll për shkak të mbrojtjes prej organizmave të dëmshëm, laboratorë për hulumtim të mbeturinave të pesticideve në ushqim, si dhe pika kontrolluese të importit dhe eksportit të bimëve, dhe gjatë kësaj lëshohen pasaporta bimore për bimët e përfshira në Regjistrin e prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe distributorit të një bime të caktuar, të ndonjë prodhimi bimor dhe të lëndëve tjera të mbikëqyrura të cilat përforcohen në vetë bimën ose në prodhimin bimor, përkatësisht në paketimin e tij ose në mjetin transportues me të cilin transportohet.





HACCP





PESHKATARIA

KAPITULLI

13

KAPITULLI 13

PESHKATARIA

Ruajtja e rezervave të peshqve dhe rregullimi i marrëdhënieve të ndërsjella pas implementimit të brezave industrialë mes tyre, si dhe nevoja për zgjidhje të problemeve të tyre specifike janë disa prej arsyeve për krijim të Politikës së përbashkët për peshkatari (Common Fisheries Policy – CFP).

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 24

Definicion

Dispozitat e këtij Kapitulli kanë të bëjnë me tregtinë me prodhime bujqësore dhe prodhime të peshkut, të cilat rrjedhin nga Republika e Maqedonisë ose nga Bashkësia.

Shprehja “prodhime bujqësore dhe prodhime të peshkut” ka të bëjë me prodhimet të cilat janë shënuar në Kapitujt 1 deri në 24 të Nomenklaturës së kombinuar dhe me prodhimet të cilat janë shënuar në Aneksin I, paragrafin 1, (ii) të Marrëveshjes për bujqësi (GATT 1994).

Ky definicion i përfshin peshqit dhe prodhimet e peshkut nga kreu 3, shenjat tarifore 1604 dhe 1605 dhe nën-shenjat 0511 91, 2301 20 00 dhe një pjesë të 1902 201*.

Pas reformave të fundit të vitit 2003, masat e Politikës së përbashkët për peshkatari i përfshijnë: ruajtjen e resurseve të peshqve, kufizimin e flotave

të peshkimit, menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e fondit të peshqve, çështjet ekonomike dhe sociale, mbrojtjen e mjedisit jetësor, akuakulturën, çështjet ndërkombëtare dhe tregun e përbashkët.

Peshkimi i kufizuar

Plani për ruajtje të resurseve të peshqve është hartuar si rezultat i peshkimit të tepruar, i cili në dekadën e fundit e ka arritur nivelin kritik prej të cilit kërcënohet rreziku për çrregullim serioz të ekosistemit detar. Në drejtim të pengimit të pasojave të mëtutjeshme negative, janë përpiluar një varg rregullash për ripërtëritje dhe zhvillim të qëndrueshëm të fondit të peshqve nëpërmjet realizimit të masave konkrete. Një prej tyre është hartimi i planeve shumëvjeçare për menaxhim dhe ripërtëritje të resurseve të peshqve. Rol qendror në koordinimin e zbatimit të planeve të miratuara ka Drejtoria e përgjithshme për peshkatari e Komisionit Evropian. Kështu, për shembull, Komisioni Evropian për vitin 2005 e ka përcaktuar numrin e daljeve në det në peshkim të peshkut-gjeth në La Mansh në 20 ditë në muaj, e ka ndaluar peshkimin e bakaloros në lindje të Detit Baltik dhe në Detin Keltik dhe e ka zvogëluar kapjen e saragës në Gjirin e Biskajës për 10% (të 33.000 tonelatave të deriatëhershme).

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Bashkësia do t'i heqë të gjitha kufizimet kuantitative, si dhe masat të cilat kanë ndikim të barabartë, mbi importin e prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut të cilat rrjedhin nga Republika e Maqedonisë.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, Republika e Maqedonisë do t'i heqë të gjitha kufizimet kuantitative, si dhe masat të cilat kanë ndikim të barabartë, mbi importin e prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut të cilat rrjedhin nga Bashkësia.



Kontrollin e sasive të kapura dhe të shfrytëzimit të pajisjeve dhe anijeve të peshkimit në shtetet-anëtare e realizojnë inspeksionet e peshkimit dhe sistemet satelitore për kontroll dhe ndjekje të anijeve të peshkimit (Vessel Monitoring System – VMS). Me qëllim të kontrollit dhe vëzhgimit, BE e ka formuar edhe Agjencinë për kontroll të peshkimit.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 28

Prodhimet e peshkut

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia tërësisht do t'i heqë taksat doganore për peshqit dhe prodhimet e peshkut me prejardhje nga Republika e Maqedonisë. Prodhimet e shënuara në Aneksin V(a) do të jenë lëndë e dispozitave që janë shënuar më poshtë.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë do t'i heqë të gjitha taksat të cilat kanë efekt të njëjtë me taksat doganore dhe do t'i zvogëlojë ato për peshqit dhe prodhimet e peshkut me prejardhje nga Bashkësia Evropiane për 50% të doganave të cilat vlejnë për shtetin më të favorizuar. Taksat e mbetura do të zvogëlohen për periudhë prej gjashtë viteve dhe do të hiqen deri në fund të kësaj periudhe.

Rregullat e përfshira në këtë pikë nuk do të aplikohen mbi prodhimet e shënuara në Aneksin V(b), që do të jenë lëndë e zvogëlimeve doganore të shënuara në Aneksin e përmendur.

Përse kontroll i pajisjes së peshkimit? Arsyeja për këtë është e thjeshtë: llojet e pajisjes dhe fuqia lëvizëse e anijeve në masë të madhe e përcaktojnë sasinë e gjahut dhe për shkak të kësaj edhe në këtë fushë realizohen masa inspektuese.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 29

Duke i marrë parasysh vëllimin e tregtisë së prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve të peshkut mes Palëve, ndjeshmërinë e tyre të posaçme, rregullat e Politikës së përbashkët për bujqësi dhe peshkatarë të Bashkësisë, aktet për politikën bujqësore të Republikës së Maqedonisë, rolin e bujqësisë në ekonominë e Republikës së Maqedonisë, potencialin prodhues dhe eksportues të degëve dhe tregjeve të saj tradicionale dhe pasojat e negociatave multilaterale tregtare në suaza të OBT-së, jo më vonë se 1 janari i vitit 2003, në suaza të Këshillit për stabilizim dhe asociim, Republika e Maqedonisë dhe Bashkësia do t'i hulumtojnë, prodhim pas prodhimi, në bazë të përcaktuar dhe reciproke, mundësitë për ndarje të ndërsjellë të koncesioneve të mëtutjeshme në aspekt të zbatimit të liberalizimit më të madh të tregtisë së prodhimeve bujqësore dhe të peshkut.

Dispozitat e këtij kapitulli në asnjë rast nuk do të ndikojnë mbi zbatimin e masave më të volitshme nga njëra ose nga tjetra Palë, në bazë të njëanshme.

Çështja më e rëndësishme: tregu i peshqve dhe prodhimeve të peshkut

Rruga e peshkut dhe prodhimeve të peshkut deri në treg nuk është aspak e thjeshtë si që ndoshta supozohet. Çka krejt i paraprin plasmanit në treg - obligimi për respektim të standardeve të përbashkëta të tregu i peshqve dhe prodhimeve të peshkut, informimi i konsumatorëve, themelimi i shoqatave të prodhuesve, përpunimi i sistemit të ndihmës së çmimeve nëpërmjet intervenimeve dhe respektimi i rregullave të tregtisë me shtete të treta, përkatësisht me shtetet jashtë Bashkimit Evropian.

Dispozitat e numëruara nuk duhet patjetër menjëherë të vlerësohen si negative. Qëllimi i tyre është përmirësimi i pasojave negative të cilat i shkaktojnë mos-harmonizimi i ofertës dhe kërkesës, stabilizimi i çmimeve, me çka peshkatarëve do t'u garantohej niveli minimal i të hyrave, si dhe përforsimi i përgjithshëm i aftësisë konkurruese të flotave të peshkimit të shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian në tregun botëror.

Peshkataria dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Përpos peshkimit, edhe vetë anijet kontribuojnë për ndotje të mjedisit jetësor ujor, si dhe pajisjet të cilat shfrytëzohen në peshkatarë. Me qëllim që në të ardhmen të arrihet peshkatarë funksionale, në pajtim me principet e zhvillimit të qëndrueshëm, Bashkimi Evropian ka formuar Komitete rajonale këshillëdhënëse, të cilat i përfshijnë peshkatarët, shkencëtarët dhe grupet tjera të interesit.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 30

Pavarësisht nga dispozitat tjera nga kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht nga neni 37, duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve bujqësore dhe të peshkut, nëse importi i prodhimeve që rrjedhin prej njëres prej dy Palëve, të cilat janë lëndë e koncesioneve të ndara në pajtim me nenin 25, 27 dhe 28, shkakton çrregullime serioze në tregjet ose në mekanizmat e tyre vendas të rregullativave në Palën tjetër, dy Palët menjëherë do të fillojnë konsultime për të gjetur zgjidhje të përshtatshme. Duke kërkuar zgjidhje, Pala e prekur mund të ndërmarrë masa përkatëse të cilat i konsideron të domosdoshme.

Detyrat e shteteve-anëtare

Respektimi dhe zbatimi i rregullave ligjore të lidhura me peshkatarinë në BE për secilin shtet-anëtar do të thotë: kufizim i aktiviteteve të peshkimit, si dhe krijim i kornizës për mbledhje sistematike të të dhënave, krijim i regjistrit të flotave dhe implementim i sistemit satelitor për kontroll të anijeve. Pastaj duhet të themelohet organizatë e prodhuesve të prodhimeve të peshkut dhe të shfrytëzohen standardet unike të tregut, si dhe të themelohet organizatë për zbatim të politikës strukturore të BE-së. Gjatë financimit të projekteve të lidhura me peshkatarinë, Bashkimi Evropian e thekson rëndësinë e përmirësimit të sigurisë dhe kushteve punuese në anije. Për zbatim të masave të Politikës së përbashkët për peshkatarinë është themeluar Fondi evropian për peshkatarinë (European Fisheries Fund - EFF).



Tri dete - tri grupe të rregullave

Duke e pasur parasysh atë që aktiviteti i peshkatarisë në BE realizohet në Detin Baltik, në Oqeanin Verilindor Atlantik dhe në Detin Mesdhe, gjatë krijimit dhe zbatimit të akteve merren parasysh specifikat e sipërfaqeve të përmendura detare. Është më vështirë të zbatohen qëllimet e politikës së peshkatarisë të BE-së në Detin Mesdhe se sa në rajonet tjera të BE-së për shkak të traditës dhe formës së peshkimit të vendeve të Mesdheut, të cilat janë konsiderueshëm më të ndërlikuara se ato në detet veriore.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 100

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi në këtë fushë do ta ketë për qëllim modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial, ekonomizimit të ujërave, zhvillimit rural, harmonizimin gradual të legjislacionit veterinar dhe fito-sanitar me standardet e Bashkësisë dhe zhvillimin e peshkatarisë dhe pylltarisë në Republikën e Maqedonisë.





POLITIKA E TRANSPORTIT



KAPITULLI

14



KAPITULLI 14

POLITIKA E TRANSPORTIT

Si të kyçeni?

Do të ishte vështirë të imagjinohet jeta e përditshme pa shfrytëzim të llojeve të ndryshme të transportit. Automobilat, hekurudha, aeroplanët, etj., na mundësojnë të arrijmë deri në destinacionet e dëshiruara pa marrë parasysh largësinë e tyre. Por, a është gjithmonë pozitiv vështrimi ynë mbi transportin? Me siguri jeni ndodhur në kolonë të pafund gjatë orëve më të zëna të trafikut. Derisa nuk përjetuat vonesë prej disa orëve të fluturimit në aeroportin e mbushur plot, mendoni që kjo ndodh vetëm në filma?

Sipas statistikave të Komisionit Evropian, tollovia ditore në komunikacion zë 10% ose 7500 kilometra autostradë në Bashkimin Evropian, kurse në 16 aeroportet më të mëdha në BE, 30% e fluturimeve vonohen më shumë se 15 minuta.

Politika e transportit në BE

Funksionimi efikas i tregut të përbashkët të BE-së, përkatësisht qarkullimi i papenguar i njerëzve, mallrave, kapitalit dhe informatave, nënkupton zbatim të akteve të përfshira në Kapitullin 14, i cili përbën rreth 10% të kornizës së përgjithshme ligjore të BE-së. Aktet e miratuara janë krijuar pikërisht me qëllim që të zgjidhen problemet siç janë bllokimi në transport, dominimi i transportit rrugor në krahasim

me llojet tjera të transportit, ndotja e mjedisit jetësor, lidhja e dobët drejt rajoneve të larguara të BE-së, lidhshmëria e dobët e rrjeteve nacionale transportuese, etj.

Zbatimi i politikës së përbashkët të transportit ka shënuar hapje të konkurrencës në tregjet nacionale transportuese (posaçërisht në transportin rrugor dhe ajror, kurse në transportin hekurudhor tregu është i hapur për transportin e ngarkesave), që ka sjellë deri në rënie të çmimeve dhe lidhshmëri më të madhe mes shteteve-anëtare.

Hapi i përmendur ka mundësuar ekzistim të rregullave të përbashkëta të cilat aplikohen në transportin ndërkombëtar në territoret e shteteve-anëtare, përkatësisht në transportin nëpër territorin e një ose më shumë shteteve-anëtare, kurse janë përcaktuar edhe kushte në të cilat transportuesit të cilët nuk kanë seli në territorin e ndonjë shteti-anëtar mund të kryejnë shërbime të transportit në suaza të atij shteti. Ose me shembull konkret: një kamion i cili bart ngarkesë prej Holandës në Austri nuk duhet patjetër të kthehet i zbrazët në Holandë, por mund t'i kryejë shërbimet e transportit për Austrinë, por me rregulla të definuara saktësisht.

BE i definon rregullat dhe standardet teknike, të sigurisë dhe sociale në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, të kombinuar, të transportit në rrugët e brendshme lundruese të transportit detar dhe ajror,

si dhe rregullat për konkurrencën e tregut dhe për ndarje të ndihmës në të gjitha degët e transportit.

Shembull për një prej kushteve sociale është kohëzgjatja e lejuar e vozitjes dhe kohëzgjatja minimale e pushimit për shoferët profesionistë në komunikacionin rrugor; periudha e obligueshme për pushim për kamionët e rëndë është 8 deri në 9 orë, kurse koha e tyre e përgjithshme e vozitjes është e kufizuar në 56 orë në javë (deri në 11 orë në ditë, që mund të zvogëlohet në 9 orë tri herë në javë).

Kushtet teknike përfshijnë, për shembull, rregulla për transport të materieve të rrezikshme, standarde për prodhim të anijeve të peshkimit, etj. Një pjesë të madhe të legjislacionit e përbëjnë edhe standardet e sigurisë dhe standardet për mbrojtje, siç janë mbrojtja e transportit ajror dhe rregullat e sigurisë në transportin hekurudhor, si dhe rregullat për kontroll të akteve të përmendura.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 98

Komunikacioni

Përpos “Marrëveshjes mes Bashkësisë Evropiane dhe Republikës së Maqedonisë në fushën e komunikacionit”, Palët do ta zhvillojnë dhe do ta përforcojnë bashkëpunimin me qëllim që t’i mundësojnë Republikës së Maqedonisë:

- ta ristrukturojë dhe ta modernizojë komunikacionin dhe infrastrukturën e tij;
- ta përmirësojë lëvizjen e udhëtarëve dhe mallrave dhe qasjen deri te tregu i komunikacionit me mënjanim të pengesave administrative, teknike dhe të tjera;
- të arrijë standarde operative në përputhje me ato në Bashkësi;
- ta zhvillojë sistemin e vet të komunikacionit, në përputhje dhe të harmonizuar me sistemin e Bashkësisë;
- ta përmirësojë mbrojtjen e mjedisit jetësor në komunikacion, zvogëlimin e ndikimit të dëmshëm dhe ndotjes.

Bashkëpunimi do t’i përfshijë fushat me prioritet në vijim:

- zhvillimin e infrastrukturës rrugore, hekurudhore, të aeroporteve dhe të limaneve, dhe të drejtimeve tjera të rëndësishme në interes të përbashkët dhe lidhjeve trans-evropiane dhe pan-evropiane;
- menaxhimin e hekurudhave dhe aeroporteve, duke e përfshirë edhe bashkëpunimin përkatës mes autoriteteve përkatëse nacionale;
- komunikacionin rrugor, duke i përfshirë edhe aspektet tatimore, aspektet sociale dhe aspektet në lidhje me mjedisin jetësor;
- komunikacionin e kombinuar hekurudhor dhe rrugor;
- harmonizimin e statistikës ndërkombëtare të komunikacionit;
- modernizimin e pajisjes teknike të komunikacionit në pajtim me standardet e Bashkësisë dhe ndihmën për financim për këtë qëllim, veçanërisht sa i përket komunikacionit rrugor-hekurudhor, transportit multi-modal dhe zhbartjes;
- avancimin e programeve të përbashkëta teknologjike dhe hulumtuese;
- adoptimin e politikës së koordinuar të komunikacionit, e cila është në përputhje me politikën të cilën e zbaton Bashkësi.

Deputetët në Bashkimin Evropian kanë votuar për implementim të patentë-shoferit unik në Bashkimin Evropian, që do t'i zëvendësojë 110 patentat e tashme të ndryshme, të cilat dallohen sipas madhësisë, afatit të përdorimit, si dhe mundësisë për falsifikim.

Patentë-shoferi unik evropian do t'i zëvendësonte dokumentet e ndryshme të vozitjes të cilat në këtë moment i shfrytëzojnë më shumë se 200 milionë vozitës në Bashkimin Evropian. Qëllimet kryesore me implementimin e këtij patentë-shoferi unik janë përmirësimi i sigurisë në komunikacion, lehtësimi i lirisë së lëvizjes së vozitësve në Bashkimin Evropian, por edhe pengimi i mashtrimeve. Direktiva e re do të thotë që qytetari i BE-së, të cilit i është marrë patentë-shoferi, goftë për shkak të vozitjes në gjendje të alkoolizuar, goftë për ndonjë shkak tjetër ose për shkaqe shëndetësore, nuk guxon ta kalojë kufirin dhe të kërkojë patentë të re në ndonjë shtet tjetër anëtar - që deri tani ka qenë rast në Evropë. Direktiva do të fillojë të zbatohet prej vitit 2013, kurse patentat e reja të lëshuara do të duhej të kenë formë të kartelave kreditore. Patentat e reja do të vlejnjë më së shumti 15 vjet, kurse afati për ndërrim të të gjitha patentave është viti 2033.

Transporti dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Në librin e bardhë për transportin nga viti 2001, Komisioni Evropian e thekson zhvillimin e qëndrueshëm si prioritet. Gjithnjë më shumë i kushtohet vëmendje promovimit të mënyrave të transportit të cilat janë të pranueshme për mjedisin jetësor. Edhe në transportin e udhëtarëve, edhe në transportin e ngarkesave vjen deri te shfrytëzimi i papërshtatshëm i formave të caktuara. Kështu, komunikacioni rrugor zë 79% të transportit të

udhëtarëve, transporti hekurudhor zë 6% kurse ai ajror zë 5%. Riorientimi i mallrave dhe udhëtarëve prej rrugëve drejt formave të transportit të cilat janë të pranueshme për mjedisin jetësor (për shembull hekurudha) do të jetë faktor kyç në politikën e transportit të qëndrueshëm.

Edhe një faktor do të jetë aftësia për integrim të mënyrave të ndryshme të transportit me kombinim të elementeve të rrugës-hekurudhës, detit-hekurudhës dhe hekurudhës-aeroplanit. Masat për zhvillim të qëndrueshëm të qarkullimit e nxisin përdorimin e lëndëve alternative djegëse dhe pagesën për ndotjen e shkaktuar, për shkak se mjetet transportuese (kryesisht automjetet e udhëtarëve) emetojnë 28% dyoksid karboni, që është përbërës kryesor i efektit serrë. Në transportin ajror, aktet e reja kanë të bëjnë me zvogëlimin e zhurmës dhe ndotjes prej aeroplanëve dhe përjashtimin e tipave të caktuar të aeroplanëve nga transporti, posaçërisht të atyre që janë të zhurmshëm.



ENERGJIA

KAPITULLI

15



KAPITULLI 15

ENERGJIA

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 99

Energjia

Bashkëpunimi do t'i reflektojë principet e ekonomisë së tregut dhe të Marrëveshjes për kartën energjetike evropiane dhe do të zhvillohet në drejtim të integritit gradual në tregjet evropiane të energjisë.

Bashkëpunimi do t'i përfshijë veçanërisht:

- formulimin dhe planifikimin e politikës energjetike, duke e përfshirë modernizimin e infrastrukturës, përmirësimin dhe diverzifikimin në furnizim dhe qasjen më të mirë deri te tregu i energjisë, duke e përfshirë edhe lehtësimin e transitit;
- menaxhimin dhe trajnimin për sektorin energjetik dhe transferin e teknologjisë dhe diturive;
- nxitjen për kursim të energjisë, efikasitetin e energjisë, energjinë ripërtëritëse dhe studimin e ndikimit të prodhimit dhe konsumit të energjisë mbi mjedisin jetësor;
- formulimin e kushteve kornizë për ristrukturim të kapaciteteve energjetike dhe bashkëpunim mes ndërmarrjeve në këtë sektor.

• Prapëseprapë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm

Mbulesa natyrore e borës, e cila më parë mbetej në terrenet për ski deri në pranverën e vonshme, tani ekziston vetëm në kujtimet e skiatorëve të vjetër. Temperaturat më të larta do të thonë edhe dimra më të ngrohta me më pak reshje të borës. Kjo nuk ndikon vetëm mbi kënaqësinë e skiatorëve, por edhe mbi ekonominë e rajoneve të caktuara, madje edhe mbi shtetet turizmi i të cilave është i lidhur në masë të madhe me turizmin dimëror (për shembull Austria). Politika energjetike dhe dispozitat e reja ligjore të Kapitullit 15 të kornizës ligjore të BE-së ofrojnë strategji të reja për zgjidhje të sfidave të përmendura, por edhe të sfidave të reja energjetike.

• Qëllimet e politikës energjetike të BE-së - ambicioze dhe/ose të realizueshme?

Politika energjetike e BE-së ka të bëjë me përcjelljen dhe rregullimin e kërkesës për energji dhe shfrytëzimin e burimeve më të shpeshta të energjisë - lëndët djegëse të fosileve (nafta, gazi natyror dhe thëngjilli), burimet ripërtëritëse të energjisë, energjia bërthamore dhe energjia elektrike si formë sekondare e energjisë.

Sipas strukturës së shfrytëzimit të burimeve të caktuara të energjisë, BE nuk është përjashtim: si edhe në shumicën e shteteve në botë, më intensiv është

Neni 103

Mjedisi jetësor dhe siguria bërthamore

Palët do ta zhvillojnë dhe do ta përforcojnë bashkëpunimin e tyre në lidhje me qëllimet esenciale të luftës kundër degradimit të mjedisit jetësor me qëllim që të përkrahet qëndrueshmëria e tij.

Bashkëpunimi do të orientohet drejt fushave me prioritet në vijim:

- lufta kundër ndotjes lokale, rajonale dhe tejkufitare (cilësia e ajrit dhe e ujit, duke e përfshirë edhe pastrimin e ujërave të zeza dhe ndotjen e ujit për pije) dhe krijimi i mbikëqyrjes efikase;
- zhvillimi i strategjive në lidhje me çështjet globale dhe klimatike;
- prodhimi dhe konsumi efikas, i qëndrueshëm dhe i pastër i energjisë, siguria e kapaciteteve industriale;
- klasifikimi dhe menaxhimi i sigurt i materieve kimike;
- zvogëlimi i mbeturinave, riciklimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave dhe zbatimi i Konventës së Bazelit për kontroll të bartjes tejkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe deponim të tyre (Bazel, 1989);
- ndikimi i bujqësisë mbi mjedisin jetësor; erozioni i tokës dhe ndotja e saj me materie kimike bujqësore;
- mbrojtja e pyjeve, florës dhe faunës; ruajtja e bio-diversitetit;
- rregullimi i qyteteve dhe fshatrave, duke e përfshirë ndërtimtarinë dhe urbanizmin;
- vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor;
- afrimi i vazhdueshëm i ligjeve dhe rregullativave ndaj standardeve të Bashkësisë;
- konventat ndërkombëtare nga fusha e mjedisit jetësor, në të cilat Bashkësia është anëtare;
- bashkëpunimi në nivel rajonal, si dhe bashkëpunimi në suaza të Agjencisë evropiane për mjedis jetësor;
- arsimi, informatat dhe vetëdija publike për çështjet e mjedisit jetësor.

Në fushën e mbrojtjes prej fatkeqësive natyrore, qëllimi i bashkëpunimit është të sigurohet mbrojtja e njerëzve, kafshëve, pronës dhe mjedisit jetësor prej katastrofave të shkaktuara nga njeriu. Për këtë qëllim, bashkëpunimi do të mund t'i përfshinte fushat në vijim:

- këmbimi i rezultateve prej projekteve shkencore dhe hulumtuese-zhvillimore;
- mbikëqyrja e ndërsjellë, sistemet për paralajmërim dhe raportim të hershëm për katastrofat dhe pasojat e tyre;
- aksionet shpëtimtare dhe aksionet për dhënie të ndihmës dhe sistemet për ndihmë në rast të katastrofave;
- këmbimi i përvojës për rehabilitim dhe rindërtim pas katastrofave;

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë bërthamore do të mund t'i përfshinte temat në vijim:

- përmirësimi i ligjeve dhe rregullativës së Republikës së Maqedonisë për sigurinë bërthamore dhe përforcimi i autoriteteve mbikëqyrëse dhe i resurseve të tyre;
- mbrojtja nga rrezatimi, duke e përfshirë edhe mbikëqyrjen e rrezatimit në mjedisin jetësor;
- menaxhimi i mbeturinave radioaktive. Republika e Maqedonisë obligohet t'i sigurojë informata Këshillit për stabilizim dhe asociim për secilin qëllim që të importojë ose të magazinon mbeturina radioaktive;
- ta nxisë lidhjen e marrëveshjeve mes shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian ose Euroatom-it dhe Republikës së Maqedonisë për lajmërim të hershëm të të dhënave në raste të fatkeqësive bërthamore dhe, nëse ka nevojë, edhe në përgjithësi për çështjet nga fusha e sigurisë bërthamore;
- përforcimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të transportit të materialeve të cilat mund të pësojnë ndotje radioaktive.

shfrytëzimi i burimeve jo-ripërtëritëse të energjisë, përkatësisht i lëndëve djegëse të fosileve, të cilat në masë të madhe importohen prej pjesëve tjera të botës. Përpos problemit me zvogëlimin e rezervave të lëndëve djegëse të fosileve, varësisë së BE-së nga importi i lëndëve të përmendura djegëse prej shteteve tjera dhe ndryshimit të çmimeve, këtu është edhe çështja e ndotjes së mjedisit jetësor me emetime të gazrave në atmosferë të cilat ndikojnë mbi efektin serrë dhe e shpejtojnë ngrohjen globale. Sipas Protokollit të Kjotos, dhe duke i respektuar principet e zhvillimit të qëndrueshëm, BE u obligua ta zvogëlojë emetimin e gazrave të dëmshme prej reparteve industriale dhe prej mjeteve transportuese (posaçërisht në transportin ajror) dhe ta shfrytëzojë energjinë e prodhuar në mënyrë më efikase. Prioritetet për zhvillim të politikës energjetike të BE-së në periudhën e ardhshme janë:

- Zhvillimi i tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe gazit
- Përmirësimi i sigurisë dhe aftësisë konkurruese
- Furnizimi nëpërmjet përmirësimit të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit
- Shfrytëzimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë
- Mbrojtja e mjedisit jetësor.

Mes tjerash, funksionimi efikas i tregut të brendshëm nënkupton edhe obligim për ndërmarrje të përbashkët të masave për siguri gjatë furnizimit me energji elektrike dhe me gaz natyror dhe për investim në infrastrukturë.



Rezervat minimale të naftës - obligim për secilin shtet-anëtar

Në nivel të Bashkimit Evropian ekzistojnë obligime për mbajtje të rezervave minimale të naftës së papërpunuar dhe/ose derivateve të naftës në vlerë prej konsumit mesatar 90-ditor në shtet gjatë vitit paraprak. Vendndodhja e ruajtjes së rezervave nuk është e kufizuar të jetë në territorin e një shteti të caktuar, që do të thotë që magazinimi mund të jetë edhe në shtete tjera të BE-së, me garanci për të qenët në dispozicion në rast nevoje.

Shfrytëzimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë - mision i (pa)mundshëm?

Kohëzgjatja gjithnjë më e shkurtë e mbulesës së borës, e me këtë edhe e sezonit për ski për shkak të ngrohjes globale e detyroi BE-në të ofrojë strategji të re për shfrytëzim të lëndëve djegëse në të ardhmen. Kështu, për shembull, në Evropë tashmë shfrytëzohet energjia elektrike e fituar prej mullinjve të erës për lëvizje të teleferikëve kryesorë në qendrat elite për ski, kolektorët diellorë për ngrohje, lëndët djegëse të prodhuara prej vajit të ricikluar për ushqim (biodizeli), etj., me çka zvogëlohet emetimi vjetor i dyoksid karbonit, e me këtë edhe efekti i serrës. Nëse jeni skiator, dhe keni automobil hibrid (motor me benzinë + elektrik), në qendra të caktuara për ski në Evropë mund të keni vend pa pagesë për parkim gjatë tërë pushimit.

Këta, por edhe disa hapa tjerë, janë një pjesë e politikave të energjisë të BE-së në lidhje me promovimin e shfrytëzimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë (energji prej ujit, erës, biomasave, etj.). Programi për promovim të shfrytëzimit të burimeve ripërtëritëse dhe të hulumtimeve për arritje të


shfrytëzimit të tyre sa më cilësor quhet Evropa me energji inteligjente (Intelligent Energy Europe). Qëllimi është që, deri në vitin 2010, pjesëmarrja e burimeve ripërtëritëse të energjisë në masën e përgjithshme të lëndëve djegëse të jetë 12%.

Energjia bërthamore - po ose jo?

Në aspekt të shfrytëzimit të energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi, në bazë të Marrëveshjes për Bashkësinë Evropiane për energji atomike, BE përcakton rregulla për furnizim me materiale bërthamore, masa për mbrojtje gjatë shfrytëzimit të energjisë bërthamore, mbrojtje të banorëve, kontroll të kontaminimit të prodhimeve ushqimore, magazinim të mbeturinave bërthamore dhe mospërhapje të armëve bërthamore.

Edhe përpos rreziqeve prej fatkeqësive bërthamore dhe prej rrezatimit, vlera e centraleve bërthamore qëndron në faktin që prodhojnë energji pa emetim të dyoksid karbonit dhe gazrave tjera të dëmshme, me çka edhe në të ardhmen do të zë vend të rëndësishëm në strukturën e shfrytëzimit të lëndëve djegëse, posaçërisht nëse merret parasysh mungesa e resurseve energjetike në shtete të caktuara të BE-së, furnizimi i pasigurt dhe çmimi i paparashikueshëm i gazit natyror, kufizimet për ndërtim të termocentraleve me thëngjill për shkak të emetimit të gazrave të dëmshme, etj.

Në frymën e politikës energjetike të BE-së, e cila promovon shfrytëzim efikas të energjisë, mund të kyçeni edhe ju, edhe atë prej sot. Këshillë e dobishme: gjatë blerjes së ndonjë aparati të ri për amvisëri, kërkoni shenjë që prodhimi i plotëson kriteret e efikasitetit energjetik. Prodhimet janë të shënuara me shkronjat A, B, C, D, E, F, G. Aparatet me shenjën A shpenzojnë më së paku energji.





TATIMET

KAPITULLI

16



KAPITULLI 16

TATIMET

Të qenët obligues tatimor në Bashkimin Evropian

“Asgjë nuk është e sigurt në këtë botë përveç tatimeve dhe vdekjes.” - Benxhamin Frenklin

Tatimet, shfrytëzimi i parë i të cilave është shënuar para 6000 viteve, deri më sot kanë mbetur mënyra e vetme e njohur për mbledhje të mjeteve për financim të shpenzimeve publike për mallra dhe shërbime të cilat i shfrytëzojmë të gjithë. Tatimet janë gjithkund rreth nesh: tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet na hiqen nga rroga, tatimi mbi vlerën e shtuar e rrit çmimin e prodhimeve të cilat i blejmë, kur blejmë banesë paguajmë tatim mbi qarkullimin e patundshmërive, kur e mbushim automobilin me benzinë ose kur pimë venë në restorant paguajmë akciza.

Pse? Tatimet janë çmimi i të mirave publike me të cilat shërbehemi çdo ditë, kurse më së shpeshti nuk pyetemi cila është vlera e tyre. Të mira publike janë mbrojtja publike shëndetësore, arsimit publik, siguria publike, muzetë, etj.

Në BE nuk ekziston obligim për harmonizim të të gjitha llojeve të tatimeve, për shkak se politika tatimore është një prej simboleve të sovranitetit të secilit shtet. Korniza ligjore e BE-së në fushën e tatimeve ka të bëjë kryesisht me tatimin e tërthortë (tatimi mbi vlerën e shtuar, akcizat), kurse tatimet e

drejtpërdrejta (tatimi personal mbi të ardhurat dhe tatimi mbi fitim) janë përfshirë në masë më të vogël dhe u janë lënë shteteve-anëtare. Qëllimi i politikës së përbashkët tatimore të Bashkimit Evropian është të sigurohet harmonizim i rregullave tatimore me qëllimet e funksionimit të tregut të përbashkët, përkatësisht lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit, njerëzve, shërbimeve dhe diturisë.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

neni 89

Tatimimi

Palët do të vendosin bashkëpunim në fushën e tatimit, duke i përfshirë edhe masat të cilat janë të orientuara drejt reformës së mëtutjeshme të sistemit tatimor dhe modernizimit të shërbimeve tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e tatimeve dhe në luftën kundër mashtrimeve tatimore.

Tatimet e tërthorta - në qeverisjen e Bashkimit Evropian

Tatimet e tërthorta kanë të bëjnë me tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe akcizat (tatimi mbi lëndët djegëse, prodhimet e duhanit, alkoolin, etj.),

të cilat ndikojnë drejtpërdrejt mbi lëvizjen e lirë të mallrave dhe lirinë e dhënies së shërbimeve dhe prandaj duhet të harmonizohen në nivel të BE-së, për shkak se ndryshimet dhe dallimet në TVSH ose në akcizat për lëndë djegëse, birrë ose cigare mund ta çrregullojnë shumë lehtë konkurrencën e tregut.

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) ka filluar të implementohet në vitin 1970, si tatim i përgjithshëm i konsumit, i aplikueshëm në secilën fazë të prodhimit dhe distribucionit të mallrave dhe shërbimeve. Shkalla minimale e TVSH-së në BE është 15% dhe vlen për shumicën e mallrave dhe shërbimeve.



Te shtetet-anëtare në BE ekzistojnë dallime, dhe ato lëvizin prej 15% në Qipro dhe Maltë, nëpërmjet shkallëve prej 19% në Holandë, deri te shkallët më të larta prej 25% në Danimarkë dhe Hungari. Shkallë më të ulëta se mesatarja janë të lejuara për prodhime dhe shërbime të cilat nuk janë konkurrenca me prodhimet dhe shërbimet e shteteve tjera anëtare, për shembull barërat, etj.

Akcizat dhe korniza ligjore e BE-së në lidhje me to përfshijnë akte me qëllim që të harmonizohen në tri kategori të prodhimeve: prodhimet e duhanit, pijet alkoolike dhe lëndët djegëse. Aktet e përmendura,

mes tjerash, e përcaktojnë shkallën minimale të tatimit për secilin prej grupeve të numëruara të prodhimeve. Shkallët minimale tatimore për lëndë djegëse, gaz natyror, rrymë dhe thëngjill janë në interes të konkurrencës lojale dhe paraqesin vegël për nxitje të kursimit të energjisë dhe për shfrytëzim të lëndëve djegëse të pranueshme nga aspekti ekologjik.

Megjithatë, aktet në nivel të BE-së janë mjaft fleksibile që të mundësojnë kushte të posaçme nacionale. Shtetet-anëtare mund të përcaktojnë tatime të posaçme edhe për kategori tjera të prodhimeve, aplikimi i të cilave nuk guxon të shkaktojë pengesa në lëvizjen e lirë të mallrave jashtë territorit të atij shteti.

Tatimet e drejtpërdrejta - në qeverisjen e shteteve-anëtare

Tatimet e drejtpërdrejta janë ato të cilat i paguajnë personalisht ose nëpërdhënësi e bën këtë për ne, kurse llogariten në përqindje të caktuar prej të ardhurave ose pronës sonë. Shtetet-anëtare e përcaktojnë vetë shumicën e dispozitave për këto lloje të tatimeve, duke i respektuar katër liritë e Marrëveshjes për Bashkësinë Evropiane (lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit), dhe në kohët e fundit edhe lirinë e pestë - lirinë e lëvizjes së diturisë.

Korniza ligjore e BE-së për tatimet e drejtpërdrejta ka të bëjë kryesisht me tatimin mbi fitim (të cilin e paguajnë kompanitë). Qëllimi i BE-së është pengimi i konkurrencës së dëmshme tatimore mes shteteve-anëtare dhe mbështetja e principeve të lëvizjes së lirë të kapitalit. Mosekzistimi i këtyre rregullave në të kaluarën ka sjellë deri te dhënia e stimulimeve të tepërta tatimore në shtete të caktuara anëtare me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja, shpeshherë në dëm të shteteve tjera të BE-së në të cilat investimi ka qenë më i arsyeshëm nga aspekti

ekonomik. Me qëllim që të mënjanohej masat e dëmshme tatimore, shtetet-anëtare obligohen me Kod të etikës (Code of Conduct for Business Taxation).

Me rregullat e përbashkëta, BE siguron harmonizim të shkallëve tatimore për pagesa tejkufitare të kamatave, si dhe të të drejtave autoriale, për shitje tejkufitare të mallrave dhe shërbimeve në ndërmarrje (të a.q. çmime të transferit).

Jetoj në një shtet-anëtar, kursej në shtet tjetër anëtar - ku të paguhet tatimi?

Shtetasit e BE-së mund ta vënë kursimin e tyre aty ku mendojnë që do të marrin kamatë më të mirë, por janë të obliguar që tatimin ta paguajnë në shtetin ku qëndrojnë. Me qëllim të mbrojtjes nga mosparaqitja e kamatave mbi kursimet jashtë vendit, prej 1 korrikut të vitit 2005 shtetet-anëtare të BE-së këmbejnë informata për kursimet e banorëve të shteteve tjera, kurse një pjesë e tyre aplikojnë tatim pas ndaljes, dhe pjesën më të madhe të të ardhurave prej atij tatimi e bartin në shtetin amë të investuesit, ku në të vërtetë ekziston borxhi për të.





UNIONI EKONOMIK DHE MONETAR

KAPITULLI

17

KAPITULLI 17

UNIONI EKONOMIK DHE MONETAR

Udhëtimi prej shtetit në shtet ka përfshirë, dhe edhe sot shpeshherë e përfshin këmbimin e parave: prej markës gjermane në frang francez, prej shilingës austriake në dramë greke. Humbja e kohës duke qëndruar në radhë para këmbimores dhe humbja e një pjese të parave me këmbimin prej një valute në valutë tjetër janë dukuri të njohura për të gjithë ne. Duke iu falënderuar adoptimit të euros, këto probleme nuk ekzistojnë më në një pjesë të shteteve të BE-së. Adoptimi i njësisë së përbashkët monetare evropiane - euros në vitin 1999 si njësi e llogaritjes është përjetim të cilin e mbajmë mend, dhe më së shpeshti e lidhim me nocionin “Unioni ekonomik dhe monetar”. Por, ky nocion do të thotë shumë më shumë: nënkupton harmonizim të politikave ekonomike të shteteve-anëtare dhe planifikim të përbashkët të integriteteve të ekonomive, stimulim të rritjes ekonomike, siguri të vendeve të punës dhe të aftësisë konkurruese të ekonomisë në BE në përgjithësi në nivel global. Me anëtarësimin me të drejta të plota, secili shtet ka obligim që drejtpërdrejt t’i zbatojë rregullat e BE-së të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e politikës nacionale ekonomike me politikën e përbashkët ekonomike evropiane, që do të thotë kyçje në Paktin për stabilitet dhe rritje (Stability and Growth Pact - SGP), qëllim i të cilit është realizimi i buxhetit të balancuar. Të gjitha shtetet-anëtare të BE-së janë pjesë e Unionit ekonomik dhe

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 80

Republika e Maqedonisë dhe Bashkësia do të vendosin bashkëpunim të ngushtë me qëllim që të kontribuojnë për zhvillimin dhe potencialet për rritje të Republikës së Maqedonisë. Bashkëpunimi i tillë do t’i përforcojë lidhjet ekzistuese ekonomike në bazën më të gjerë të mundshme, në dobi të të dyja Palëve.

Politika dhe masat tjera do të kenë për qëllim të vendosin zhvillim ekonomik dhe social të Republikës së Maqedonisë. Me politikën e këtillë duhet të sigurohet që, prej vetë fillimit, kujdesi për mjedisin jetësor të jetë tërësisht i përfshirë dhe i lidhur me kërkesat për zhvillim të barabartë social.

Politika për bashkëpunim do të përfshihet në kornizën rajonale për bashkëpunim. Vëmendje e veçantë do të duhet t’u kushtohet masave me të cilat do të mund të kultivohet bashkëpunimi mes Republikës së Maqedonisë dhe fqinjëve të saj, duke i përfshirë edhe shtetet-anëtare, me çka kontribuohet për stabilitetin rajonal. Këshilli për stabilizim dhe asociim mund t’i definojë prioritetet në suaza të politikës për bashkëpunim, të përshkruar më poshtë.

monetar evropian (Economic and Monetary Union - EMU), i cili nënkupton harmonizim në tri faza:

- Faza e parë ka të bëjë me realizimin e lëvizjes së lirë të kapitalit mes shteteve-anëtare, harmonizimin e politikave ekonomike, bashkëpunimin më të afërt të politikave ekonomike dhe bashkëpunimin mes bankave qendrore.
- Faza e dytë nënkupton konvergencë të politikave ekonomike dhe monetare të shteteve-anëtare (për sigurim të stabilitetit të çmimeve dhe financave publike).
- Faza e tretë shënon fiksimit të pakthyeshëm të kursit dhe adoptim të valutës së përbashkët - euros.

Shtetet të cilat e shfrytëzojnë valutën e përbashkët - euron - e formojnë Eurozonën. Këto shtete janë: Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Gjermania, Portugalia, Sllovenia dhe Spanja. Prej shteteve “të vjetra” anëtare të BE-së, euron nuk e kanë adoptuar Danimarka, Mbretëria e Bashkuar dhe Suedia, kurse prej anëtareve “të reja” (prej vitit 2004 dhe 2007) deri tani euron e kanë adoptuar Sllovenia, Qiproja, Malta dhe Sllovakia. Edhe përpos asaj që nuk i takojnë Eurozonës, të gjitha shtetet-anëtare kanë obligim ta harmonizojnë politikën e tyre monetare dhe të funksionojnë sipas akteve të përbashkëta të cilat i imponon BE.

Si të adaptohen?

Me anëtarësimin në BE, shteti njëkohësisht aderon edhe në Unionin ekonomik monetar, që nuk do të thotë adoptim automatik i euros si valutë në qarkullim.

Shteti-anëtar mund ta adoptojë euron vetëm pasi që të plotësohen të ashtuquajturat kritere të konvergencës:

1. deficitet fiskale (buxhetore) duhet patjetër të jenë më të vogla se 3% e BPV-së
2. borxhi publik më i ulët se 60% e BPV-së
3. duhet patjetër të realizohet inflacioni i ulët dhe shkallë të ulëta afatgjate të kamatave
4. kursi stabil i valutës
5. më së paku dy vjet duhet patjetër të aplikohet mekanizmi i kurseve i quajtur ERM II¹.

Kritere për adoptim të euros është edhe kursi stabil dyvjeçar për këmbim të parave, në drejtim të të cilit është themeluar Mekanizmi i kursit i sistemit monetar evropian (Exchange Rate Mechanism, ERM), i cili ndihmon për lëvizje të fluktuimeve në raport me euron dhe valutat nacionale brenda kufijve të lejuar.

Me mbajtjen e sistemit të ndërlikuar të udhëheqjes së politikës së përbashkët monetare është e ngarkuar Banka qendrore evropiane (European Central Bank, ECB) me seli në Frankfurt, bashkë me bankat qendrore nacionale në shtetet-anëtare. Banka qendrore evropiane dhe bankat qendrore nacionale në shtetet të cilat e kanë adoptuar euron e formojnë Eurosistemin, qëllimi i të cilit është mbajtja e stabilitetit të çmimeve me zbatim të politikës së përbashkët monetare në Eurozonë. Bankat qendrore nacionale kanë rol kyç operativ në adoptimin e euros si valutë të përbashkët.

¹ ERM II – sistem i kurseve të adaptueshme sipas shembullit të Mekanizmit themelor të kursit të sistemit monetar evropian (Exchange Rate Mechanism, ERM) në të cilin kurset e shteteve-anëtare të BE-së kanë lëvizur në suaza të kufijve të definuar. ERM II është krijuar si ndihmë për shtetet të cilat nuk e përdorin euron që të përhatiten për anëtarësim në BE, duke i respektuar kriteret e përbashkëta ekonomike.

Neni 81

Politika ekonomike

Republika e Maqedonisë dhe Bashkësia do ta lehtësojnë procesin e reformës ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për përmirësim të bazave të ekonomive të tyre dhe zbatimit të politikës ekonomike në ekonomitë e tregut.

Për këto qëllime, Republika e Maqedonisë dhe Bashkësia do të bashkëpunojnë për:

këmbim të informatave për rezultatet dhe parashikimet makroekonomike, si dhe për strategjitë zhvillimore;

analiza të përbashkëta të çështjeve ekonomike me interes të ndërsjellë, duke e përfshirë edhe definimin e politikës ekonomike dhe instrumenteve për zbatim të saj;

Me kërkesë të autoriteteve nga Republika e Maqedonisë, Bashkësia mund të sigurojë ndihmë për përkrahje të përpjekjeve të Republikës së Maqedonisë për implementim të konvertibilitetit të plotë të denarit dhe për adaptim gradual të politikës së saj me politikën e Sistemit monetar evropian. Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë këmbim joformal të informatave të cilat kanë të bëjnë me principet dhe funksionimin e Sistemit monetar evropian dhe të Sistemit evropian të bankave qendrore.

Ato janë të ngarkuara me adoptimin e euros në shtetet e tyre dhe zëvendësimin e valutës nacionale me euron, me mbledhjen e valutave nacionale të cilat tërhiqen nga qarkullimi, si dhe me informimin e opinionit.

Çka me shtetet të cilat ende nuk e kanë adoptuar euron?

Bankat qendrore nacionale të të gjitha anëtareve të BE-së, që do të thotë edhe të atyre shteteve të cilat së paku deri tani nuk e kanë realizuar fazën e tretë të adaptimit ndaj Unionit ekonomik monetar (përkatësisht nuk e kanë pranuar euron si valutë të tyre), bashkë me Bankën qendrore evropiane e formojnë Sistemin evropian të bankave qendrore. Shtetet jashtë Eurozonës gjithashtu janë të përfshira në zbatimin e politikës së përbashkët monetare, të cilën e zbatojnë në territoret e tyre, pa marrë parasysh atë që nuk e shfrytëzojnë euron si valutë të tyre.

Për dhe kundër Eurosistemit

Me adoptimin e euros zhduken humbjet gjatë këmbimit të parave prej një valute në valutë tjetër, kurse krahasimi i çmimeve është më i lehtë, që e nxit konkurrencën në tregun e përbashkët. Por, shtetet njëkohësisht duhet patjetër të ballafaqohen edhe me kontrollin e përbashkët të shkallëve të inflacionit, shkallëve të kamatave dhe kurseve të valutës.

Me hyrjen në BE, e me këtë edhe në UEM, automatikisht do të rriten çmimet?

Mekanizmit të adoptimit të euros i paraprin ngrirja disavjeçare e kurseve të valutave nacionale në raport me euron, që do të thotë që, me adoptimin e euros, çmimet thjesht llogariten pa ndryshim të vlerave. Në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve, është e obligueshme që para adoptimit të euros të gjitha çmimet të jenë të shprehura në dy valuta - në valutën nacionale dhe në



euro. Rritja e çmimeve në disa shtete “të reja” anëtare është rezultat i plotësimit edhe të disa kriterëve tjera të konvergjencës, për shembull i realizimit të shkallëve të ulëta të inflacionit, që nuk mund të jetë më i lartë se 1,5% në raport me shkallën e inflacionit në tri shtetet-anëtare të BE-së me çmime më stabile.

Hyrjen në Eurozonë, përkatësisht adoptimin e euros,

- e shfrytëzuan tregtarët dhe prodhuesit privatë, të cilët e
- shfrytëzojnë llogaritjen në euro si arsye për shtrenjtim,
- edhe pse vetë adoptimi i euros nuk shkakton rritje të
- çmimeve, me vërejtje që nuk ekziston mekanizëm ligjor
- i cili mund t'i detyrojë t'i mbajnë çmimet të cilat i kanë
- pasur para euros. Ndikim mbi pengimin e shtrenjtimit
- mund të kenë vetëm konsumatorët.



STATISTIKA



KAPITULLI

KAPITULLI 18

STATISTIKA

Të dhënat statistikore në Bashkimin Evropian

Rritja ekonomike, përkatësisht rritja e Bruto prodhimit vendor (BPV) në BE në vitin 2006 ka qenë 4,8%, me çka në masë të caktuar është tejkaluar rezultati i dy viteve paraprake, kur rritja ka qenë 4,3%. Bruto-rrogat mesatare në vitin 2006 kanë qenë:

- 7.797 € në Hungari
- 41.691 € në Gjermani
- 36.032 € në Austri
- 4.712 € në Portugali
- 36.672 € në Belgjikë.

Në nivel të tërë Bashkimit Evropian (25 shtetet e atëhershme anëtare) bruto-rroga ka qenë 34.400 €.

Shpesh hasim të dhëna, krahasime dhe analiza të ngjashme, por rrallë e pyesim veten se si, kur dhe ku janë mbledhur ato. Statistikat e përmendura janë mbledhur prej enteve nacionale statistikore të shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian, kurse bashkimi dhe përpunimi bëhet në suaza të projektit Sistemi statistikor evropian. Ky është modul statistikor i bërë për përpunim të analizave dhe për krahasim të gjendjeve në ekonomitë e shteteve-anëtare, dhe paraqet vetëm një prej projekteve të përbashkëta të Eurostat-it, shërbim i posaçëm i Komisionit Evropian, skelet i Sistemit statistikor

evropian (SSE). Qëllimet e Sistemit statistikor evropian përcaktohen për periudhë prej 5 viteve, dhe ato i miraton Komiteti programor statistikor. Atë e kryeson Eurostat-i, kurse e përbëjnë udhëheqësit e enteve nacionale statistikore të shteteve anëtare.

Eurostat-i është themeluar në vitin 1953 në shërbim të Bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik. Me kalimin e kohës, detyrat e tij janë zgjeruar. Shtetet-anëtare të BE-së mbledhin të dhëna statistikore, të cilat i analizojnë trupë të autorizuar statistikor në nivel nacional, dhe pas kësaj ato dërgohen në Eurostat. Eurostat-i edhe më tutje i sistematizon dhe i bashkon ato, siguron krahasueshmëri të tyre, dhe krejt kjo e ndihmon harmonizimin e metodologjisë. Përpos shteteve anëtare të BE-së, Sistemi statistikor evropian përfshin edhe shtete prej Hapësirës ekonomike evropiane (Islanda, Norvegjia dhe Lihtenshtajni). Përpos kësaj, ekziston bashkëpunim i afërt me organizatat ndërkombëtare siç janë KB-të, OECD, Fondi monetar ndërkombëtar dhe Banka botërore. Një prej qëllimeve të Eurostat-it është edhe koordinimi për përmirësim të sistemit statistikor në shtete të treta (të cilat nuk janë anëtare), posaçërisht me kandidatët për anëtarësim në BE. Korniza ligjore e BE-së në lidhje me sistemin statistikor dhe funksionimin e tij është lëndë e Kapitullit 18. Ky Kapitull ka rëndësi vendimtare, për shkak se të dhënat cilësore dhe të krahasueshme statistikore

janë të domosdoshme për sjellje të vendimeve në zbatimin e politikave të përbashkëta të BE-së. Mes fushave më të ndërlikuara për përcjellje statistikore janë statistika e bujqësisë, politikës monetare dhe financiare, dhe shumë të tjera.

Cilësia dhe krahasueshmëria e të dhënave statistikore janë principet kryesore të statistikës zyrtare, kurse si çështje e rëndësishme theksohet

- edhe të qenët në kohë në prodhimin dhe dorëzimin
- e të dhënave. Me qëllim që të mund të sigurohet
- krahasueshmëri, të dhënat në shtetet-anëtare
- duhet patjetër të mbledhen dhe të dorëzohen deri te
- Eurostat-i në intervale të përcaktuara të barabarta
- kohore. Për shembull, për të fituar pasqyrë të vërtetë
- për punësimin e femrave në BE, është e rëndësishme
- që kjo statistikë në Gjermani të mbahet në mënyrë

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 82

Bashkëpunimi në fushën e statistikës

Bashkëpunimi në fushën e statistikës do ta ketë për qëllim zhvillimin e sistemit efikas dhe të qëndrueshëm statistikor, të aftë që në një të ardhme të afërt të sigurojë të dhëna të sigurta, objektive dhe të sakta, të nevojshme për planifikim dhe mbikëqyrje të procesit të tranzicionit dhe reformave në Republikën e Maqedonisë. Kjo do t'i mundësojë sistemit nacional statistikor, të koordinuar nga Enti shtetëror statistikor, që më mirë t'i plotësojë nevojat e shfrytëzuesve të vet nga administrata shtetërore dhe nga sektori privat afarist. Sistemi statistikor duhet t'i respektojë principet themelore të statistikës, të lëshuara nga Kombet e Bashkuara, dhe dispozitat nga Legjislacioni evropian për statistikë, dhe të zhvillohet në drejtim të legjislacionit të përbashkët evropian (acquis communautaire) në fushën e statistikës.

Për këtë qëllim, Palët mund të bashkëpunojnë veçanërisht sa i përket:

- avancimit të zhvillimit të shërbimit efikas statistikor në Republikën e Maqedonisë, në bazë të kornizës përkatëse institucionale;
- zhvillimit dhe mbajtjes së kapaciteteve nacionale për mbledhje, përpunim dhe komunikim të të dhënave statistikore me cilësi të lartë, duke i përdorur teknologjitë bashkëkohore në mënyrën më efikase;
- sigurimit të të dhënave përkatëse socio-ekonomike, të domosdoshme për ndjekje të reformave shtetërore për subjektet ekonomike nga sektori publik dhe privat dhe për bashkësinë hulumtuese;
- mundësimin që sistemi nacional statistikor t'i adoptojë principet dhe standardet e Sistemit statistikor evropian;
- sigurimit të besueshmërisë së të dhënave personale;

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë edhe sigurim të informatave për metodat, pjesëmarrje në grupe të zgjedhura punuese të EUROSTAT-it dhe këmbim të të dhënave statistikore, por nuk do të jetë i kufizuar vetëm në këto çështje.

të njëjtë si edhe në Itali, Portugali, ose në cilindo shtet tjetër anëtar. Për shkak të kësaj, bashkë me shtetet-anëtare, Eurostat-i punon në ridefinimin e metodologjisë së përbashkët për mbajtje të statistikës zyrtare dhe/ose kërkon që shtetet-anëtare të përfshijnë pyetje të përshtatshme gjatë mbledhjes së të dhënave nacionale.

Ne hasim të dhëna statistikore në televizion, nëpër gazeta dhe në mjetet tjera për informim publik. Përpos aktiviteteve tjera, në suaza të Zyrës së vet për gazetarë, Eurostat-i u jep shfrytëzuesve informata, përkatësisht të dhëna për BE-në, për shtetet-anëtare dhe për partnerët e tyre, përgatit shënime të shkurta statistikore për vendimet e rëndësishme të BE-së dhe ngjarjet siç janë konferencat e rëndësishme, etj.

Të dhënat statistikore sipas fushave të caktuara dhe politikave të BE-së dhe detajet për këtë temë mund të gjendet në Internet faqen e Komisionit Evropian <http://epp.eurostat.ec.europa.eu>





POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI

KAPITULLI

19

KAPITULLI 19

POLITIKA SOCIALE DHE PUNËSIMI

Kushtet e barabarta për të gjithë

Strategjia e Lisbonës dhe zhvillimi i shoqërisë së bazuar në dituri janë bazë për politikën e punësimit dhe politikën sociale të Bashkimit Evropian, të shprehura nëpërmjet Strategjisë evropiane për punësim (për krijim të vendeve të reja të punës), Strategjisë evropiane për reformë të tregut të punës dhe Agjendës sociale, të formuluar me qëllim që të sigurohet që gjithkush në shoqëri dhe në secilin rajon të ketë dobi nga përfitimet nga rritja e BE-së. Korniza ligjore e këtyre politikave është shprehur në

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 90

Bashkëpunimi social

Në lidhje me punësimin, bashkëpunimi mes Palëve do të orientohet posaçërisht drejt avancimit të shërbimeve për punësim dhe shërbimeve këshillëdhënëse për orientim profesional, sigurimit të masave për përkrahje dhe avancimit të zhvillimit lokal për të ndihmuar gjatë ristrukturimit të tregut të prodhimit dhe punës.

Ai gjithashtu do të përfshijë masa siç janë studimet, ndihma e ekspertëve dhe aktivitetet për informim dhe trajnim.

Sa i përket sigurimit social, me bashkëpunimin mes Palëve do të bëhen përpjekje që të adaptohet sistemi i sigurimit social i Republikës së Maqedonisë ndaj kërkesave të reja ekonomike dhe sociale, përkatësisht duke siguruar shërbime prej ekspertëve dhe duke organizuar aktivitete për informim dhe trajnim.

Bashkëpunimi mes Palëve do të përfshijë adaptim të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë në lidhje me kushtet punuese dhe mundësitë e barabarta për meshkujt dhe femrat.

Palët do të zhvillojnë bashkëpunim të ndërsjellë me qëllim që të përmirësohet niveli i mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, duke e marrë si pikë fillestare nivelin e mbrojtjes që ekziston në Bashkësi.

Kapitullin 19. Ky kapitull i përfshin fushat në vijim:

- Shëndeti dhe mbrojtja në punë
- Mbrojtja sociale
- Përfshirja sociale
- Personat me nevoja të posaçme
- E drejta e punës
- Dialogu social
- Politika e punësimit
- Fondi social evropian (FSE)
- Politika për anti-diskriminim
- Mundësitë e barabarta për femrat dhe për meshkujt.

Specifika e këtij Kapitulli qëndron në atë që, përpos ekzistimit të kornizës ligjore në formë të direktivave dhe dispozitave të cilat kanë të bëjnë me çështjet për shëndetin dhe mbrojtjen në punë, fushën e legjislacionit të punës, politikën kundër diskriminimit dhe mundësitë e barabarta për femrat dhe për meshkujt, një pjesë e madhe e fushave të përfshira në këtë kapitull janë të rregulluara nëpërmjet të ashtuquajturit legjislacioni i butë ligjor, përkatësisht me shfrytëzim të metodës së hapur të koordinimit nëpërmjet rekomandimeve dhe rezolutave (punësimi, përfshirja sociale, mbrojtja sociale), që do të thotë që pjesa për vendimmarrje për zbatim të këtyre politikave u takon shteteve-anëtare.

Strategjia evropiane për punësim

Prioritetet e përbashkëta dhe qëllimet individuale të politikës për punësim të shteteve-anëtare janë shënuar në direktivat shumëvjeçare rreth të cilave janë pajtuar të gjitha shtetet-anëtare të BE-së. Direktivat e tanishme e përfshijnë periudhën prej vitit 2009 deri në vitin 2012, dhe e bëjnë kornizën për shtetet-anëtare, të cilat vetë duhet ta marrin vendimin se në cilën mënyrë do t'i zbatojnë qëllimet e Strategjisë së Lisbonës për promovim të diturisë dhe inovacioneve.

Agjenda sociale 2005 - 2010

Me këtë dokument është përpunuar politika për luftë kundër varfërisë dhe promovim të mundësive të barabarta për të gjithë, me theks të veçantë mbi të rinjtë dhe femrat. Në zbatimin e saj janë përfshirë të gjithë trupat publikë në të gjitha nivelet - prej atyre lokale deri në ato nacionale - përfaqësues të punëdhënësve dhe të punëtorëve, si dhe të organizatave joqeveritare. Për t'u promovuar mundësitë e barabarta për të gjithë dhe për t'u siguruar ndihmë për të gjetur punë, në Bashkimin Evropian ekziston sistem i financimit për investim në kapital njerëzor, edhe atë nëpërmjet Fondit social evropian. Vëmendje e posaçme i kushtohet financimit të rajoneve të BE-së me nivel të lartë të papunësisë ose me të ardhura të ulëta mesatare.

Shëndeti, mbrojtja në punë dhe politika kundër diskriminimit

Në suaza të kësaj politike gjendet edhe sigurimi i ambientit të përshtatshëm punues në mbarë Evropën dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet rregullave të përbashkëta minimale për kushtet e punës dhe për shëndetin dhe sigurinë në punë, për shembull, mbrojtja nga zhurma dhe ekspozimi ndaj materieve kimike për femrat shtatzëna dhe punëtorët në moshë deri në 18 vjet. BE e dënon diskriminimin në bazë të gjinisë, racës ose prejardhjes etnike, invaliditetit, orientimit seksual, moshës, religjionit ose bindjes.

Rroga e barabartë për meshkujt dhe femrat është vlerë themelore e BE-së, për çka flet edhe e dhëna që direktiva për rrogë të barabartë e vitit 1975 është direktiva e parë e pranuar evropiane nga fusha e barazisë së femrave dhe meshkujve. Shkalla e papunësisë së femrave në BE në vitin 2006 ishte

9,6%, kurse e meshkujve ishte 7,6%. Për t'u zgjidhur ky problem, shtetet-anëtare miratojnë dhe zbatojnë strategji e cila i ndalon të gjitha format e diskriminimit gjinor dhe me ligj i obligojnë ndërmarrjet të kenë trajtim të barabartë të meshkujve dhe femrave gjatë punësimit, avancimit profesional dhe pagesës. Në pjesën më të madhe të shteteve të reja anëtare të BE-së, femrat fitojnë mesatarisht 76% të rrogës së meshkujve (Rumani, Lituani), pastaj deri në 80% (Hungari, Letoni), kurse Sllovenia shënon nivel më të lartë prej rreth 85% të rrogës së meshkujve.

Megjithatë, situata po përmirësohet me zbatimin e dispozitave të përbashkëta në lidhje me promovimin e barazisë gjinore: të dhënat statistikore tregojnë tendencë të përgjithshme të rritjes së rrogave të femrave në raport me rrogat e meshkujve. Femrat në Slloveni, Rumani dhe Poloni kanë ndjerë mbyllje më të shpejtë të hendekut të rrogave. Në shërbim të politikës sociale evropiane dhe politikave të punësimit, janë themeluar tri agjenci të cilat zbatojnë hulumtime dhe japin informata teknike:

- Agjencia evropiane për shëndet dhe siguri në punë në Bilbao
- Fondacioni evropian për përmirësim të kushteve punuese dhe jetësore në Dublin
- Qendra evropiane për monitorim të racizmit dhe ksenofobisë në Vjenë.



NDËRMARRJET DHE PRONËSIA INDUSTRIALE

KAPITULLI

20



KAPITULLI 20

NDËRMARRJET DHE PRONËSIA INDUSTRIALE

Evropa: Djepi i industrisë dhe biznesit, por edhe i ndryshimeve

Deri para disa dekadave, aftësia konkurruese e industrisë dhe ndërmarrjeve evropiane në nivel global ndoshta edhe nuk ka qenë ndonjë sfidë e madhe. Por, me paraqitjen e pikave të reja të zhvillimit, nga njëra anë Amerika Veriore dhe nga ana tjetër të ashtuquajturit tigra aziatikë, u bë e qartë që mbijetesa në nivel global në masë të madhe duhet të barazohet me nocionet siç janë përmirësimi i strategjive sipërmarrëse, strategjitë e reja industriale, etj. Së këndejmi, Kapitulli 20 i përmban direktivat për zhvillim të BE-së. Politika industriale dhe sipërmarrësia e BE-së janë nën ndikim të drejtpërdrejtë të Strategjisë së re të Lisbonës. Përkatësisht, Strategjia e Lisbonës paraqet përgjigje me të cilën Evropa përgatitet për sfidat e globalizimit, konkurrencës dhe përparimit. Me zbatimin e reformave kërkohet përgjigje për sfidat e ndryshimeve demografike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, me çka do të arrihej shoqëri konkurrencte e bazuar në dituri ashtu që deri në vitin 2020 Evropa të bëhet ekonomia më konkurrencte. Prioritetet e BE-së në disa vitet e ardhshme në drejtim të realizimit të këtij qëllimi ambicioz, por të arritshëm, kanë të bëjnë me orientimin e politikës së rritjes ekonomike dhe shkallës më të lartë të punësimit, koherencës sociale dhe qëndrueshmërisë ekologjike.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 84

Avancimi dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve do ta ketë për qëllim krijimin e klimës së volitshme për investime vendase dhe të huaja private.

Qëllimet konkrete të bashkëpunimit do të jenë:

- Republika e Maqedonisë ta përmirësojë kornizën juridike, e cila do të jetë e volitshme dhe do t'i mbrojë investimet;
- Lidhja e marrëveshjeve bilaterale me shtetet - anëtare për avancim dhe mbrojtje të investimeve, aty ku kjo është e mundshme;
- Zbatimin e aranzhmaneve përkatëse për transfer të kapitalit;
- Përmirësimin e mbrojtjes së investimeve.

Të bëhesh (dhe të mbetesh) konkurrent në nivel ndërkombëtar - receta e BE-së

Detyrë themelore e shteteve-anëtare të BE-së është krijimi dhe zbatimin e politikës e cila subjekteve afariste të BE-së do t'u sigurojë kushte të barabarta për konkurrim në raport me pjesën tjetër të botës. Konkretisht, kjo do të thotë, për shembull, mbrojtje

e pronësisë intelektuale dhe industriale nga pirateria dhe falsifikimi. Njëkohësisht, bëhen përpjekje që të ulen shpenzimet gjatë plotësimit të standardeve të larta të lidhura me energjetikën, mjedisin jetësor dhe standardet sociale.

Gjatë krijimit të industrisë dhe ndërmarrjeve konkurrencte, theksi vihet në shfrytëzimin e teknologjive të larta dhe inovacioneve, dhe prandaj BE gjithnjë më shumë jep ndihmë financiare për hulumtim dhe për krijim të klimës e cila nxit inovacione.

Për realizim të qëllimeve të përmendura, nevojitet e ashtuquajtura qasje horizontale, përkatësisht zbatimi dhe veprimi i koordinuar i më shumë politikave të BE-së: lëvizja e lirë e mallrave, ligji për pronësi intelektuale,

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 85

Bashkëpunimi industrial

Bashkëpunimi do ta ketë për qëllim avancimin e modernizimit dhe ristrukturimin e industrisë dhe sektorëve të posaçëm në Republikën e Maqedonisë, si dhe bashkëpunimin industrial mes subjekteve ekonomike të të dyja Palëve, kurse veçanërisht do ta ketë për qëllim përforcimin e sektorit privat në kushte me të cilat do të sigurohet mbrojtja e mjedisit jetësor.

Iniciativat për bashkëpunim industrial do t'i reflektojnë prioritetet të cilat i përcaktojnë të dyja Palët. Ato do t'i marrin parasysh aspektet rajonale të zhvillimit industrial dhe, kur kjo është e rëndësishme, avancimin e partneritetit transnacional. Me iniciativat duhet veçanërisht të bëhen përpjekje që të vendoset kornizë përkatëse për ndërmarrjet ashtu që ta përmirësojnë diturinë menaxhuese (know-how) dhe që të avancohen tregjet, transparenca e tregjeve dhe klima afariste.

furnizimet publike, politika e konkurrencës, mbrojtja e mjedisit jetësor, etj., me vërejtje që masat për realizim të politikave të vendosura nuk guxojnë të sjellin deri në çrregullim të konkurrencës së tregut, të ndikojnë mbi tatimet ose mbi të drejtat dhe interesat e punëtorëve.

Pse pikërisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme?

Në krijimin e politikës së përbashkët të ndërmarrjeve janë marrë parasysh saktësisht nevojat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, numri i të cilave në Bashkimin Evropian është 23 milionë dhe në të cilat punojnë 75 milionë njerëz, për shkak se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme konsiderohen si lëvizëse të punësimit, zhvillimi i inovacioneve sipërmarrëse dhe ndikimi mbi integrimin social dhe lokal në Evropë. Këto ndërmarrje përbëjnë 99% të të gjitha ndërmarrjeve të cilave BE mundëson bashkëpunime në projekte konkrete për hulumtim dhe inovacione. Aktet për ndihmën shtetërore dhe format tjera të financimit janë më të volitshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme se sa për kompanitë e mëdha.

Qëllimet e BE-së janë krijimi i ambientit miqësor afarist për zhvillim të ndërmarrjeve, promovimi i sipërmarrësisë dhe shkathtësive, përmirësimi i qasjes deri te tregjet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zvogëlimi i pengesave administrative, promovimi i të menduarit sipërmarrës, themelimi i ndërmarrjeve vetjake, dhënia e ndihmës femrave dhe pakicave, etj., dhe krejt kjo në bashkëpunim me Bankën evropiane për investime (European Investment Bank - EIB), e cila financon programe për nxitje të zhvillimit të sipërmarrësisë, posaçërisht në shtetet e reja anëtare të BE-së - shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Prandaj, nëse jeni sipërmarrës në Bashkimin Evropian dhe kërkonte partnerë për projekt për hulumtim dhe inovacione, për këtë mund

Neni 86

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Palët do ta kenë për qëllim zhvillimin dhe përforcimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në sektorin privat, themelimin e ndërmarrjeve të reja në fusha të cilat ofrojnë potencial për zhvillim dhe bashkëpunim mes NVM-ve nga Republika e Maqedonisë dhe nga Bashkësia.

t'ju ndihmojë Komisioni Evropian nëpërmjet rrjetit të organizuar të cilin e përbëjnë 32 shtete evropiane dhe Kili, duke e financuar pjesërisht projektin tuaj.

Industria e pastër, e qëndrueshme

Për zhvillim të industrisë konkurrentë, BE angazhohet për ndryshime rrënjësore strukturore në sektorin industrial. Edhe përpostheksimittë rëndësisë së shërbimeve, dega më e rëndësishme në botë, por edhe në Evropë, është industria përpunuese (edhe sipas të hyrave, edhe sipas numrit të të punësuarve). Prandaj, parakusht për industrinë bashkëkohore në Evropë është investimi në teknologji dhe inovacione dhe zhvillimi i degëve bashkëkohore industriale, duke i ndjekur me këtë trendet bashkëkohore botërore dhe duke e arritur nivelin e pikave tjera të zhvillimit në botë. Kjo do të thotë zhvillim i industrisë elektronike, automobilistike, kimike, robotikës, bioteknologjisë dhe teknologjisë kozmike. Dispozitat e kësaj politike i mbrojnë resurset natyrore dhe mjedisin jetësor, me çka zhvillimi i industrisë në hapësirë nuk do ta shkatërronte vetë trashëgiminë në të cilën është ndërtuar. Rritja e qëndrueshme nuk është vetëm çështje e krijuesit të politikave të BE-së, por secila ndërmarrje është përgjegjëse për politikën e ndjeshme nga aspekti social dhe ekonomik.





RRJETET TRANS-EVROPIANE

KAPITULLI

21

KAPITULLI 21

RRJETET TRANS-EVROPIANE

Në nëntor të vitit 2006, disa pjesë të Evropës disa orë mbetën pa energji elektrike. Shkaku për këtë ishte një defekt i sistemit elektro-energjetik nga rënia e frekuencës së reparteve në Gjermani, për shkak se më shumë centrale (para së gjithash të bazuara në erë) kanë dalë nga sistemi, që është përhapur edhe te shtetet tjera nëpërmjet rrjeteve të energjisë elektrike. Për t'u siguruar siguri më e lartë në furnizimin dhe shfrytëzimin e energjisë, por edhe në transport dhe telekomunikacione, me ndihmën e Kapitullit 21, Bashkimi Evropian siguron ndihmë financiare në fushën e ndërtimit të rrjeteve trans-evropiane transportuese, energjetike dhe telekomunikative, dhe jep orientime të përgjithshme për zhvillimin, qëllimet dhe prioritetet në financimin e projekteve me interes të përbashkët të rrjeteve trans-evropiane. Projektet për zhvillim të rrjeteve trans-evropiane (Trans European Network - TEN) janë të lidhura me idenë për krijim të tregut të përbashkët, dhe kanë të bëjnë me vendosjen e infrastrukturës së përbashkët transportuese, energjetike dhe telekomunikative në BE

Përkatësisht, pa infrastrukturë bashkëkohore e cila do t'i lidhte rrjetet e ndryshme rajonale dhe nacionale nuk është e mundur të vendoset qarkullim i lirë i mallrave, shërbimeve dhe punëtorëve.

Përpos kësaj, zhvillimi i rrjeteve trans-evropiane është element i rëndësishëm për realizim të rritjes ekonomike dhe punësimit, përkatësisht kohezionit ekonomik dhe social të Bashkimit Evropian.

Rrjetet trans-evropiane transportuese (Trans European Transport Network - TEN-T)

Autostradat evropiane sigurojnë lëvizje të lirë të njerëzve dhe mallrave sipas përbërësve funksionimit të tregut të përbashkët. Plani i Komisionit Evropian për infrastrukturën transportuese është modernizimi i drejtimeve ekzistuese transportuese për të gjitha llojet e transportit dhe ndërtimi i drejtimeve të reja në rajonet me lidhshmëri më të dobët transportuese. Me realizimin e projekteve prioritare deri në vitin 2020, TEN-T do të përfshijë 89.500 km të autostradave, 94.000 km të binarëve hekurudhorë, 11.250 km të rrugëve të brendshme ujore me 210 limane të lumenjve dhe 294 limane detare dhe 366 aeroporte. Përpos përparësisë për transportin e udhëtarëve me shkurtim të kohës së udhëtimit, rrjeti i zhvilluar dhe i degëzuar transportues është i nevojshëm edhe për transportin në rritje të ngarkesave në BE, për të cilin në periudhën deri në vitin 2020 pritet rritje për dy të tretat në krahasim me vitin 2000.

Neni 98

Komunikacioni

Përpos „Marrëveshjes mes Bashkësisë Evropiane dhe Republikës së Maqedonisë në fushën e komunikacionit”, Palët do ta zhvillojnë dhe do ta përforcojnë bashkëpunimin me qëllim që t'i mundësojnë Republikës së Maqedonisë:

- ta rristrukturojë dhe ta modernizojë komunikacionin dhe infrastrukturën e tij;
- ta përmirësojë lëvizjen e udhëtarëve dhe mallrave dhe qasjen deri te tregu i komunikacionit me mënjanim të pengesave administrative, teknike dhe të tjera;
- të arrijë standarde operative në përputhje me ato në Bashkësi;
- ta zhvillojë sistemin e vet të komunikacionit, në përputhje dhe të harmonizuar me sistemin e Bashkësisë;
- ta përmirësojë mbrojtjen e mjedisit jetësor në komunikacion, zvogëlimin e ndikimit të dëmshëm dhe ndotjes.

Bashkëpunimi do t'i përfshijë fushat me prioritet në vijim:

- zhvillimin e infrastrukturës rrugore, hekurudhore, të aeroporteve dhe të limaneve, dhe të drejtimeve tjera të rëndësishme në interes të përbashkët dhe lidhjeve trans-evropiane dhe pan-evropiane;
- menaxhimin e hekurudhave dhe aeroporteve, duke e përfshirë edhe bashkëpunimin përkatës mes autoriteteve përkatëse nacionale;
- komunikacionin rrugor, duke i përfshirë edhe aspektet tatimore, aspektet sociale dhe aspektet në lidhje me mjedisin jetësor;
- komunikacionin e kombinuar hekurudhor dhe rrugor;
- harmonizimin e statistikës ndërkombëtare të komunikacionit;
- modernizimin e pajisjes teknike të komunikacionit në pajtim me standardet e Bashkësisë dhe ndihmën për financim për këtë qëllim, veçanërisht sa i përket komunikacionit rrugor-hekurudhor, transportit multi-modal dhe zhabartjes;
- avancimin e programeve të përbashkëta teknologjike dhe hulumtuese;
- adoptimin e politikës së koordinuar të komunikacionit, e cila është në përputhje me politikën të cilën e zbaton Bashkësia.

Programi i Bashkësive Evropiane eTEN (European Community programme - eTEN)

Programi eTEN jep ndihmë për përhapje të përdorimit të teknologjive të larta, posaçërisht të atyre kompjuterike, në të gjitha segmentet e funksionimit shoqëror dhe ekonomik, me qëllim të nxitjes së rritjes ekonomike, punësimit, kohezionit social dhe zhvillimit të shoqërisë e cila bazohet në dituri. Programi nuk nënkupton nxitje të ndërtimit të infrastrukturës telekomunikative, por përkrahje për implementim të teknologjive të reja, financim të fazës fillestare të zhvillimit dhe përdorimit të saj.

Edhe pse financimi dhe projektet prioritare kanë të bëjnë kryesisht me nxitjen e përdorimit të teknologjive të larta, në suaza të përmirësimit të efikasitetit të rrjeteve telekomunikative, Parlamenti Evropian debaton edhe për çështje tjera të lidhura. Kur shkojmë në pushim vjetor jashtë vendit, kemi frikë nga llogaria telefonike e cila na pret, për shkak se çmimet e shërbimit të roamingut (shfrytëzimi i telefonit celular jashtë shtetit amë) në Evropë janë katër deri në pesë herë më të larta se thirrjet nacionale.

Një gazetar austriak, i cili për një muaj e ka ndjekur garën me biçikleta Tour de France, ka paguar llogari telefonike prej 9.000 eurove. Ky dhe disa shembuj të ngjashëm i kanë motivuar deputetët në Parlamentin Evropian të debatojnë për zvogëlim të çmimeve të roamingut. Vendimi përfundimtar për këtë çështje pritet nga ana e Këshillit për industri, hulumtim dhe energjetikë të Parlamentit Evropian.

Programi eTEN përfundoi në vitin 2006, por vazhdon me programin e ri të dedikuar për përforsim të aftësisë konkurruese dhe inovacioneve (Competitiveness and Innovation Framework Programme - CIP), i cili do të zbatohet në

periudhën 2007-2013. Me promovim të zhvillimit të sipërmarrësisë, nxitje të inovacioneve dhe energjisë, ky program jep përkrahje në zhvillimin e teknologjive informatike-komunikative nëpërmjet iniciativës ICT PSP (Information and Communication Technologies Policy Support Programme).



Rrjetet trans-evropiane energjetike (Trans European Energy Network- TEN-E)

Furnizimi me energji është temë aktuale, duke e marrë parasysh atë që nevoja për energji është në rritje, kurse rezervat e lëndëve më të shfrytëzuara djegëse janë në rënie. Bashkimi Evropian importon 50% të lëndëve djegëse, kurse varësia nga eksporti prej shteteve tjera edhe më tutje rritet me zgjerimin e Bashkimit Evropian. Burim kryesor i lëndëve djegëse nga fosilet për BE-në janë Norvegjia, Federata Ruse dhe Afrika Veriore, kurse në të ardhmen burim kryesor do të jenë edhe shtetet e Lindjes së Afërt dhe Liqenit Kaspik. Me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor, promovohet shfrytëzimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë. Qëllimi është që, deri në vitin 2020, 20% e nevojave për energji të mbulohen pikërisht nëpërmjet burimeve ripërtëritëse të energjisë (era, uji, dielli, biomasat, etj.).



POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE



KAPITULLI 22

POLITIKA RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE

DALLIMET RAJONALE - QËMOTI DHE PËRGJITHMONË?

Kur do ta krahasonit zhvillimin e rajoneve të caktuara në një pjesë, cilët tregues do t'i shfrytëzonit?

Shumica prej jush mbase do ta marrë parasysht bruto prodhimin vendor për kokë banori në shtet, përkatësisht në rajon, shkallën e papunësisë, etj. Në suaza të politikës rajonale të Bashkimit Evropian, treguesit e përmendur dhe disa tregues tjerë të ngjashëm janë orientimi kryesor për investim në zhvillimin ekonomik dhe social të shteteve, rajoneve dhe pjesëve tjera të cilat mbesin prapa mesatares së BE-së, me qëllim që në masë sa më të madhe të barazohen nivelet e zhvillimit të atyre rajoneve dhe të mundësohen kushte të barabarta për jetë për të gjithë qytetarët në Bashkimin Evropian. Legjislacioni në lidhje me këtë temë gjendet në Kapitullin 22.

Arsyet për krijim të politikës së përbashkët rajonale të BE-së

Të ardhurat për kokë banori në krahasim me fuqinë blerëse në rajonin e Hamburgut në Gjermani janë katër herë më të larta se në Alentego në Portugali (dhe gjashtë herë më të mëdha se në rajonet më të varfra të Hungarisë). Një e treta e mjeteve nga buxheti i BE-së janë të dedikuara për zgjidhje të këtij problemi, por edhe të problemeve të ngjashme - zvogëlim të dallimeve zhvillimore në pajtim me disa prej parakushteve themelore të integritimeve evropiane: konceptet e solidaritetit dhe veprimet të përbashkët.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 101

Zhvillimi rajonal dhe lokal

Palët do ta përforcojnë bashkëpunimin për zhvillim rajonal me qëllim që të kontribuojnë për zhvillim ekonomik dhe për zvogëlim të mosbalancimit rajonal.

Do t'i kushtohet vëmendje e posaçme bashkëpunimit tejkufitar, trans-nacional dhe ndër-rajonal. Për këtë qëllim do të vendoset këmbim i informatave dhe ekspertëve.

Dallimet rajonale

Nëse ju jepet mundësia, sa kohë do t'ju nevojitej të vendosni të jetoni dhe të punoni në Bordo, në Francë, ose në Koimbri, në Portugali? Këto dy qytete gjenden në nënqiell të ngjashëm klimatik, ato janë qendra ekonomike, kulturore dhe universitare të shteteve të tyre. Megjithatë, duke i shqyrtuar faktorët tërheqës për jetë dhe punë në ndonjë rajon, më pak do t'i marrim parasysh treguesit kulturorë dhe klimatikë, dhe më shumë treguesit zhvillimorë të këtyre qyteteve, përkatësisht të rajoneve dhe shteteve në të cilat gjenden ato. Duke i marrë parasysh disa prej tyre, shumica prej nesh do të vendoste shpejt për përgjigjen e kësaj pyetjeje, duke vendosur për rajonin më tërheqës, me më shumë prosperitet, i cili është aktivisht i kyçur në funksionimin ekonomik të Evropës.

Gjithmonë kanë ekzistuar dallime në zhvillim mes shteteve dhe rajoneve të BE-së, por me kalimin e kohës ato thellohen me procesin e integritimit ekonomik të tregut të BE-së. Derisa rajone të caktuara adaptohen ndaj ndryshimeve me sukses më të madh, rajone tjera gjithnjë më shumë mbesin prapa mesatares së BE-së, me çka krijohen dallime gjithnjë më të mëdha në të hyrat, në prodhimtari dhe në shkallën e papunësisë.

Financimi i projekteve për zhvillim rajonal

Politika rajonale e Bashkimit Evropian është instrumenti më i rëndësishëm për nxitje të adaptimit ndaj lëvizjeve të reja dhe politikave të përbashkëta, dhe ajo nënkupton përkrahje financiare të projekteve për ristrukturim të fushave problematike (zhvillimi i infrastrukturës, zvogëlimi i papunësisë, stimulimi i industrisë dhe i të gjitha formave të ekonomizimit) pikërisht në drejtim të zvogëlimit të dallimeve mes rajoneve dhe përmirësimit të aftësisë konkurruese të

ekonomive lokale në tregun e brendshëm të BE-së.

Financimi realizohet në suaza të tri fondeve: Fondi evropian për zhvillim rajonal, Fondi social evropian dhe Fondi koheziv.

Mjetet e Fondit evropian për zhvillim rajonal janë të dedikuara për investim në prodhimtari (posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), investim në infrastrukturën lokale dhe rajonale zhvillimore (afariste, hulumtuese, arsimore, të mjedisit jetësor, transportuese, shëndetësore, energjetike) dhe investim në përforcimin e potencialit ekonomik të ndonjë fushe (përforcimi i ofertës turistike, potencialit hulumtues dhe inovativ, potencialit për bashkëpunim mes ndërmarrjeve, aplikimit të teknologjive informatike dhe të komunikimit për t'u zbutur karakteristikat periferike të ndonjë rajoni).

Fondi social evropian siguron ndihmë për shtetet në rajonet e tyre të cilat janë të goditura me shkallë të lartë të papunësisë dhe në përgjithësi kanë gjendje të keqe në tregun e fuqisë punëtore. Prej këtij fondi financohen projekte të cilat e kanë për qëllim rritjen e aftësisë adaptuese të punëtorëve dhe ndërmarrjeve ndaj gjendjes në treg, zhvillimin e masave aktive për punësim dhe kyçje në tregun e fuqisë punëtore, si dhe përforcimin e përfshirjes sociale, posaçërisht të grupeve të kërcënuara shoqërore, dhe luftën kundër diskriminimit në tregun e fuqisë punëtore.

Fondi koheziv i financon projektet me rëndësi nacionale në fushën e infrastrukturës transportuese dhe të mjedisit jetësor. Mjetet u ndahen shteteve (dhe jo rajoneve), bruto prodhimi vendor për kokë banori i të cilave është nën 90% të mesatares së BE-së. Me zgjerimin e fundit të BE-së, shfrytëzues të mjeteve nga ky fond janë të gjitha shtetet “e reja” anëtare, dhe duke e pasur parasysh atë që me zgjerimin dhe hyrjen e vendeve në tranzicion është zvogëluar BPV mesatare e BE-së, për disa prej shteteve “të vjetra” anëtare është zvogëluar shumica e ndihmës, kurse anëtare tjera “të vjetra” më nuk janë shfrytëzues të saj.

Në çfarë mënyre Komisioni Evropian i përcakton dallimet rajonale?

BE përcakton se cilat shtete dhe rajone objektivist kanë nevojë për ndihmë nga buxheti i BE-së dhe cili lloj i ndihmës u nevojitet në bazë të më shumë treguesve: BPV për kokë banori, shkalla e papunësisë, punësimi në bujqësi, peshkatari, industri, dendësia e popullsisë, niveli i arsimimit, etj. Këta tregues përcillen në nivel të shteteve-anëtare dhe në nivele më të ulëta - të të ashtuquajturave rajone statistikore (NUTS), të cilat janë të krahasueshme në tërë Evropën sipas numrit të banorëve. Ekzistojnë tri kategori të rajoneve, varësisht nga niveli i mos-zhvillimit dhe lloji i ndihmës që i nevojitet ndonjë rajoni, dhe secila ka qëllim të posaçëm. Qëllimi numër 1 “Konvergjenca” është i dedikuar për rajonet më së paku të zhvilluara (BPV për kokë banori nën 75% të mesatares së BE-së) dhe për shtetet bruto të ardhurat nacionale për kokë banori të të cilave janë nën 90% të mesatares së BE-së (do të thotë e plotëson kushtin për shfrytëzim të Fondit koheziv). Qëllimin numër 2 “Aftësia rajonale konkurruese dhe punësimi” mund ta shfrytëzojnë të gjitha rajonet e BE-së, kurse shuma të cilën mund ta fitojnë varet nga shkalla e tyre e papunësisë, punësimi në sektorët ekonomikë me më pak perspektivë, niveli i arsimimit, dendësia e popullsisë, etj. Qëllimi numër

3 “Bashkëpunimi territorial evropian” është i dedikuar për bashkëpunim tejkufitar, ndërkombëtar dhe trans-nacional të rajoneve në BE, në lidhje me çështjet e përbashkëta specifike për zhvillim të qëndrueshëm.

Madhësia e rajoneve të cilave u ndahet ndihmë financiare dallon sipas qëllimeve të shënuara, kurse përpos fondeve të Bashkimit Evropian, edhe qeveritë nacionale i përkrahin projektet për zhvillim rajonal. Pjesëmarrja e tyre në financim dallon prej projektit në projekt. Projektin për ringjallje të lagjes së qytetit në Grac, Austri, në kohëzgjatje prej vitit 1996 deri në vitin 1999, me qëllim të zvogëlimit të shkallës së papunësisë dhe rritjes së standardit jetësor, në përqindje më të madhe e ka financuar vetë shteti, kurse pjesëmarrja e Fondit evropian për zhvillim rajonal dhe e Fondit social evropian ka qenë rreth 15%. Në periudhën e njëjtë është realizuar edhe një projekt për ristrukturim të industrisë së tekstilit në Portugali, ku pjesëmarrja e Fondit evropian për zhvillim rajonal në ndihmën financiare ka qenë 75%. Nëpërmjet këtyre shembujve mund të shihet dallimi në madhësinë e rajoneve financiare: shembulli i parë ka të bëjë me ndihmën e zhvillimit të një lagjeje të qytetit me rreth 10.000 banorë, kurse shembulli i dytë përfshin një shtet të tërë me rreth 10 milionë banorë.

Cilat kushte duhet patjetër t'i plotësojnë shtetet-anëtare për zbatim të politikës rajonale të BE-së?

BE i parashtron detyrat në vijim para shteteve-anëtare dhe shteteve-kandidate: vendosja e kornizës legjislative e cila supozon planifikim të buxhetit dhe bashkëfinancim të projekteve për zhvillim rajonal, si dhe harmonizimi me politikën e Bashkësisë. Politika rajonale është fushë specifike e cila, mes tjerash, kërkon edhe nivel të lartë të harmonizimit me politikën tjera të përbashkëta, për shembull me politikën sociale, politikën për mbrojtje të mjedisit jetësor, politikën për mbrojtje të konkurrencës, etj. Përpos kësaj, në bazë të organizimit të vet territorial, shteti duhet t'i përcaktojë rajonet statistikore, dhe pastaj BE e përcakton nivelin dhe formën e përkrahjes për një rajon të caktuar. Detyrë tjetër është funksionimi efikas i institucioneve në shtetet-anëtare të cilat i menaxhojnë mjetet e këtyre fondeve, prej programimit të tyre nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit deri të vlerësimi përfundimtar i rezultateve prej projekteve të zbatuara.

Si përgatitje për pjesëmarrjen e ardhshme në politikën për zhvillim rajonal, deri në fund të vitit 2006, shtetet anëtare kanë shfrytëzuar fonde të ndryshme para-anëtarësimi, SAPARD, ISPA dhe PHARE. Në fillim të vitit 2007 është shënuar periudhë e re, për shkak se të gjitha këto programe janë avancuar dhe janë zëvendësuar me Instrumentin për ndihmë para-anëtarësimi (Instrument for Pre-Accession Assistance - IPA), i cili me anëtarësimin në BE do të zëvendësohet me Fondet strukturore dhe Fondin koheziv.

Efikasiteti në zbatimin e politikës rajonale është i dukshëm në shembujt e shumtë pozitivë. Prej anëtarësimi në BE në vitin 1986 deri sot, në Portugali është zvogëluar shkalla e papunësisë, është rritur aftësia konkurruese e rajoneve tradicionalisht të pazhvilluara në brendësi dhe është rritur pjesëmarrja e sektorit shërbyes. Nëse kthehemi te pyetja për zgjedhjen mes Bordosë dhe Koimbrit, megjithatë, pas leximit të këtij teksti për rezultatet e politikës rajonale të BE-së, a do të mendoheshit dy herë para se ta jepnit përgjigjen përfundimtare?







CJYQËSIA DHE TË DREJTAT THEMELORE

KAPITULLI

23

KAPITULLI 23

GJYQËSIA DHE TË DREJTAT THEMELORE

TË JESH (OSE TË MOS JESH) SHITET I SË DREJTËS

Sipas treguesve statistikorë në pjesën më të madhe të shteteve-anëtare të BE-së, më shumë se një e treta e procedurave gjyqësore zgjasin më shumë se një vit. Përpos kësaj, shumë lëndë mbesin të pazgjidhura, vjetrohen dhe me këtë mënjanohen prej procedurës së mëtutjeshme. Problemet e përmendura nuk janë as të reja, as të panjohura, dhe qytetarët ballafaqohen me to çdo ditë. Me veprimin e përbashkët në këtë drejtim, në BE i kushtohet vëmendje rëndësisë së ekzistimit të gjyqësisë së pavarur dhe efikase, të definuar nëpërmjet rekomandimeve për realizim të paanshmërisë, integritetit dhe standardeve të larta

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 2

Respektimi i principeve demokratike dhe të drejtave të njeriut, të proklamuar në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut dhe si që është definuar në Aktin përfundimtar të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për Evropë të Re, respektimi i rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe sundimi i të drejtës, si dhe principet e ekonomisë së tregut të përfshira në Konferencën e Bonit për bashkëpunim ekonomik të KSBE-së, e formojnë bazën për politikën e brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe paraqesin elemente themelore të kësaj Marrëveshjeje.

të gjyqimit. Ato janë të përfshira në Kapitullin 23, me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve të pazgjidhura, shpejtimit të kohës së procedurës, përforcimit të sigurisë juridike të qytetarëve, sigurimit të qasjes deri te gjyqësia dhe përmirësimit të organizimit funksional në aspekt të kohëzgjatjes së procedurës.

Detyrat para shteteve-anëtare dhe shteteve-kandidate

Si adaptohet Maqedonia si shtet-kandidat ndaj principeve themelore të BE-së në gjyqësi? Reforma e gjyqësisë nënkupton miratim dhe zbatim efikas të ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e gjyqësisë dhe përcaktojnë kritere për punë, për shembull, të gjykatësve, rregulla për arsimimin e tyre të obligueshëm, implementimin e inspeksionit gjyqësor, vlerësimin e punës së tyre, etj. Mes tjerash, nevojitet edhe krijim i forumit për ankesa, me çka palëve do t'u mundësohej komunikim me trupat kompetentë, shërbimet e të cilëve i shfrytëzojnë, kurse gjykatave dhe institucioneve tjera të lidhura me gjyqësinë do t'u jepeshin orientime për veprim të mëtutjeshëm dhe për nevojën eventuale për ndryshime. Një prej parakushteve për efikasitet është edhe krijimi i sistemit kompjuterik statistikor për regjistrim të lëndëve të reja, si dhe sigurimi i aparateve tjera teknike për punë, si për shembull organizimi i sistemit për dërgim efikas të dokumenteve gjyqësore.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 74

Përforcimi i institucioneve dhe sundimi i të drejtës

Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, Palët do t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përforcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushat e administratës në përgjithësi, dhe në zbatimin e së drejtës dhe mekanizmat e drejtësisë në veçanti. Kjo veçanërisht e përfshin përforcimin e sundimit të së drejtës.

Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë do të orientohet veçanërisht drejt pavarësisë së gjyqësisë, përmirësimit të efektivitetit të saj dhe trajnimit të kuadrove prej profesioneve juridike.

Korrupsioni - kush, çka, si, kur, ku?

Korrupsioni është dukuri me të cilën secili prej nesh ballafaqohet çdo ditë. A keni dëgjuar së paku njëherë në fqinjësi tregim për ndonjë person që është përpjekur ta blejë me para vërtetimin për arsim, diplomën ose provimin në shkollë ose fakultet? Ose, në kuptimin e njëjtë, prej atij personi është kërkuar rryshfet? Rasti i përmendur është vetëm një prej shembujve të shumtë, dhe përpos në arsim dhe shkencë, korrupsioni paraqitet edhe në veprimtari tjera në të gjitha nivelet e funksionimit. Sipas të definicioneve zyrtare, korrupsioni është keqpërdorim i detyrës zyrtare për shkak të dobisë personale dhe/ose realizimit të fitimit personal. Sipas mendimit tuaj, cilat veprimtari i nënshtrohen më së shumti kësaj dukurie?

Mbase përgjigjet tuaja në masë të madhe do të përputheshin me përgjigjet e grupeve të anketuara reprezentative të qytetarëve prej shteteve

të ndryshme në Evropë, të cilët i janë përgjigjur pyetjes: Në cilat veprimtari do të ishte më së shumti e domosdoshme të zvogëlohet korrupsioni? Më së shumti të anketuar kanë konsideruar që është më e domosdoshme të zbatohet politikë efektive kundër korrupsionit në gjyqësi (21%), në vend të dytë është politika (19%), pastaj policia (13%), dogana (9%) dhe arsimit (7%).



Zvogëlimi i korrupsionit është parakusht për stabilitet të shoqërisë demokratike dhe sundim të së drejtës, dhe që të mund të realizohet ky qëllim, BE përcakton jo vetëm kornizë të fuqishme legislative, por edhe institucione të afta për zbatim të politikës konsekuente të parandalimit dhe pengimit të korrupsionit. Adaptimi i shteteve-kandidate nënkupton krijim të programeve nacionale për luftë kundër korrupsionit me masa konkrete. Për shembull, në shëndetësi kjo është kompjuterizimi i mbrojtjes primare shëndetësore, zbatimi i rregullt i anketave për korrupsion mes pacientëve të shëruar, realizimi i regjistrimit të arsyeve të cilat shkaktojnë lista të pritjes me program për mënjanim të tyre, mundësimi i qasjes së publikut deri te të dhënat për numrin e krevateve në spitale, etj.

Të drejtat themelore të njeriut

Në disa vitet e fundit, mbrojtja e të drejtave të njeriut zë vend qendror në krijimin e politikës së BE-së. Në vitin 2000, në Nicë solemnisht u shpall Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian, e cila i përfshin të drejtat qytetare, politike, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të BE-së të lidhura me respektimin e lirive themelore, barazisë dhe solidaritetit.





DREJTËSIA, SIGURIA DHE LIRIA

KAPITULLI

24

KAPITULLI 24

DREJTËSIA, SIGURIA DHE LIRIA

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 74

Përforcimi i institucioneve dhe sundimi i të drejtës

Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, Palët do t'i kushtojnë vëmendje të posaçme përforcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushat e administratës në përgjithësi, dhe të zbatimit të së drejtës dhe mekanizmave të drejtësisë në veçanti. Kjo veçanërisht e përfshin përforcimin e sundimit të së drejtës.

Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë do të orientohet veçanërisht drejt pavarësisë së gjyqësisë, përmirësimit të efektivitetit të saj dhe trajnimit të kuadrove të profesioneve juridike.

Ishujt Kanare janë destinacion tërheqës për turistët evropianë, por edhe cak i grupeve tjera të interesit. Bëhet fjalë për pronësi territoriale spanjolle, por me pozitën e tyre gjeografike ato janë më afër Afrikës, dhe për këtë shkak me vite janë cak i imigrantëve prej shteteve të veriperëndimit afrikan. Vërtetim për këtë është edhe e dhëna për zbarkimin e 18.000 imigrantëve ilegalë afrikanë në Ishujt Kanare gjatë vitit 2006. Për ta zgjidhur këtë problem, BE e inicioi patrullën e parë të përbashkët

• kufitare në verën e vitit 2006, por edhe një varg aksionesh tjera në të cilat bashkëpunojnë të gjitha shtetet-anëtare, me çka do të zvogëlohej ardhja e imigrantëve ilegalë.

• Imigracioni është një prej çështjeve më kontroverse, më emocionale dhe më të ndërlikuara me të cilat sot ballafaqohen shtetet e BE-së. Pikërisht për këtë arsye, Kapitulli 24 është një prej kapitujve më dinamikë, për shkak se vazhdimisht ndryshon dhe adaptohet ndaj problemeve dhe kushteve të reja në Bashkësi. Titulli i këtij kapitulli është Drejtësia, liria dhe siguria. Drejtësia nënkupton bashkëpunim gjyqësor në zgjidhjen e çështjeve civile dhe penale, liria ka të bëjë me lëvizjen e njerëzve, migrimin dhe vizat, kurse siguria në radhë të parë e përfshin bashkëpunimin policor dhe doganor në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Politika për azil dhe migrim

• Për t'u shmangur rastet e kërkimit dhe marrjes së azilit në shtetet me kritere më të buta, me shpërngulje të mëvonshme në shtete tjera të BE-së, në vitet e 1990-ta shtetet-anëtare të BE-së ndërtuan politikë unike të dhënies së azilit. Shkak për këtë ishte edhe numri i madh i njerëzve të cilët filluan të kërkojnë mbrojtje në BE. Qëllimi i politikës është implementimi i procedurës unike për dhënie të azilit në tërë BE-në, me ç'rast shmanget parashtrimi i njëkohshëm i

Neni 75

Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi

Palët do të bashkëpunojnë në fushat e vizave, kontrollit kufitar, azilit dhe migrimit, dhe do të vendosin kornizë për bashkëpunim në këto fusha, duke e përfshirë edhe nivelin rajonal.

Bashkëpunimi në lidhje me çështjet e shënuara në pikën 1 do të bazohet në konsultime të ndërsjella dhe koordinim të ngushtë mes Palëve dhe duhet të përfshijë ndihmë teknike dhe administrative për:

- këmbim të informatave për legjislacionin dhe praktikën;
- përgatitje të teksteve të ligjeve;
- përforsim të efikasitetit të institucioneve;
- trajnim të personelit;
- siguri të dokumenteve të udhëtimit dhe zbulim të dokumenteve të rrejshme;

Bashkëpunimi do të jetë veçanërisht i orientuar:

- në fushën e azilit, drejt zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit nacional për t'i arritur standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951, dhe me këtë të sigurojë që respektohet principi i moskthimit (non-refoulement).
- në fushën e migrimit legal, drejt rregullave për riatdhesim dhe të drejtave dhe statusit të personave të pranuar. Në lidhje me migrimin, Palët pajtohen t'u ndajnë trajtim të drejtë shtetasve të shteteve tjera të cilët qëndrojnë në territoret e tyre në mënyrë legale dhe ta avancojnë politikën e integritimit me qëllim që atyre t'u japin te drejta dhe obligime të ngjashme me ato të shtetasve të tyre.

Në suaza të këtij neni, Këshilli për stabilizim dhe asociim mund të rekomandojë fusha plotësuese për zgjerim të bashkëpunimit.

kërkesave në më shumë shtete dhe eliminohet edhe rreziku nga bartja e përgjegjësisë për shqyrtim të kërkesës prej një shteti në shtet tjetër.

Sistemi unik për dhënie të azilit rrjedh nga politika e qartë për migrim, e cila nga njëra anë i definon të drejtat e migrantëve legalë, që në BE vijnë kryesisht për shkaqe ekonomike, kurse nga ana tjetër kontribuon për pengim të shpërnguljeve ilegale nëpërmjet rregullave të qarta për mënyrën dhe kushtet për hyrje dhe pushim në BE.

Kufijtë në BE

Marrëveshja e Shengenit konsiderohet si një prej ngjarjeve më të rëndësishme për lëvizjen dhe udhëtimin e thjeshtë në BE. Ajo është nënshkruar në vitin 1985 në Luksemburg, dhe ka rezultuar me heqje të kontrolleve për njerëzit në kufijtë e përbashkët të BE-së, barazim të rregullave për kontroll të kufijve të jashtëm dhe marrëveshje për implementim të politikës së përbashkët të vizave.

Me krijimin e territorit pa kufij të brendshëm - të njohur si zona e Shengenit - është paraqitur problemi i sigurisë në shtetet-anëtare, dhe për këtë arsye BE u kushton vëmendje të posaçme masave për siguri të kufijve të jashtëm. Kjo paraqet përgjegjësi të

Neni 76

Pengimi dhe kontrolli i imigrimit ilegal; riatdhesimi

Palët pajtohen të bashkëpunojnë me qëllim që ta pengojnë dhe ta kontrollojnë migrimin ilegal. Për këtë qëllim:

- Republika e Maqedonisë pajtohet ta pranojë mbrapa secilin shtetas të vet i cili qëndron në mënyrë ilegale në territorin e ndonjë shteti-anëtar, me kërkesë të atij shteti dhe pa formalitete të mëtutjeshme, posa personi i tillë të jetë identifikuar si i tillë;
- dhe secili shtet-anëtar i Bashkimit Evropian pajtohet ta pranojë mbrapa secilin shtetas të vet i cili qëndron në mënyrë ilegale në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të saj dhe pa formalitete të mëtutjeshme, posa personi i tillë të jetë identifikuar si i tillë.

Shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republika e Maqedonisë do t'u sigurojnë shtetasve të vet dokumente përkatëse për identifikim dhe do t'ua japin shërbimet administrative të domosdoshme për qëllime të tilla.

Palët obligohen që, me kërkesë, të lidhin marrëveshje mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Evropiane për rregullim të obligimeve të posaçme për Republikën e Maqedonisë dhe për shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian për riatdhesim, duke e përfshirë edhe obligimin për riatdhesim të shtetasve të shteteve tjera dhe të personave pa shtetësi.

Derisa të lidhet marrëveshja me Bashkësinë, e paraparë në pikën 2, Republika e Maqedonisë pajtohet që, me kërkesë të cilitdo shtet-anëtar, të lidhë marrëveshje bilaterale me shtete individuale anëtare të Bashkimit Evropian për rregullim të obligimeve konkrete për riatdhesim mes Republikës së Maqedonisë dhe shtetit të interesuar anëtar, duke e përfshirë edhe riatdhesimin e shtetasve të shteteve tjera dhe të personave pa shtetësi.

Këshilli për stabilizim dhe asociim do të hulumtojë se çfarë përpjekjesh plotësuese të përbashkëta mund të bëhen për t'u penguar dhe për t'u kontrolluar imigrimi ilegal, duke e përfshirë edhe trafikimin e njerëzve.

rëndësishme për shtetet e reja anëtare të BE-së, të cilat për shkak të pozitës së tyre gjeografike tani e marrin menaxhimin e një pjese të madhe të këtyre kufijve. Ato marrin ndihmë financiare nga BE për rritje të bashkëpunimit mes kufitarëve, nëpunësve policorë dhe doganorë, por edhe për pranim të teknike bashkëkohore siç janë shenjat e kompjuterizuara të gishtave dhe të dhënat personale për identifikim.

Zonës së Shengenit sot i takojnë shtetet „e vjetra” anëtare të BE-së: Austria, Belgjika, Danimarka,

- Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Luksemburgu,
- Holanda, Gjermania, Portugalia, Spanja dhe Suedia,
- kurse prej shteteve që nuk janë anëtare asaj i takojnë
- Norvegjia dhe Islanda. Më 1 janar të vitit 2008 atyre
- iu bashkëngjitën 10 shtetet „e reja” anëtare të BE-
- së në vitin 2004. Edhe pse janë jashtë zonës së
- Shengenit, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda i kanë
- pranuar dhe i zbatojnë politikat e përbashkëta për
- luftë kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimin
- në çështjet gjyqësore.

Neni 77

Lufta kundër pastrimit të parave

Palët pajtohen për domosdoshmërinë e bërjes së të gjitha përpjekjeve dhe bashkëpunimit me qëllim që të pengohet përdorimi i sistemeve të tyre financiare për pastrim të parave prej aktiviteteve kriminale në përgjithësi, dhe veçanërisht prej kundërvajtjeve të lidhura me drogën.

Bashkëpunimi në këtë fushë mund të përfshijë ndihmë administrative dhe teknike me qëllim që të zhvillohet zbatimi i rregullativës dhe funksionimi efikas i standardeve dhe mekanizmave përkatës për luftë kundër pastrimit të parave, ekuivalentë me ata të adoptuar nga Bashkësia dhe forumet ndërkombëtare në këtë fushë.

Stop për krimin e organizuar, pastrimin e parave dhe terrorizmin

Pjesë kyçe e luftës kundër krimit është bashkëpunimi efikas mes trupave policorë, gjyqësorë dhe doganorë të shteteve-anëtare. Përparimi më i madh në disa vitet e fundit është arritur me themelimin e Drejtorisë policore evropiane (Europol). Këtë trup e përbëjnë nëpunës policorë dhe doganorë, kurse detyra e tyre është koordinimi i bashkëpunimit policor të shteteve-anëtare në fushën e pengimit dhe luftës kundër të gjitha formave të krimit të organizuar ndërkombëtar. Në BE më së shpeshti kontrabandohet mall i cili u nënshtrohet tatimeve të larta, siç janë cigaret dhe alkooli, me qëllim që të realizohen profite të larta të paligjshme nëpërmjet shitjes në tregje të zeza të organizuara mirë. Për këtë arsye, grupet e organizuara kriminale e orientojnë shitjen e mallrave të kontrabanduara drejt tregjeve ilegale të shteteve të pjesës veriore të BE-së, të cilat kanë shkallë më të larta të tatimit. Bëhen përpjekje që kjo, por edhe format tjera të krimit të organizuar në BE të pengohen nëpërmjet bashkëpunimit të shteteve-anëtare, me ndihmë të bazave kompjuterike

Neni 78

Pengimi dhe lufta kundër krimit dhe aktiviteteve tjera të paligjshme

Palët u morën vesh të vendosin kornizë për bashkëpunim me qëllim të luftës kundër krimit dhe aktiviteteve të paligjshme dhe të pengimit të tyre, dhe veçanërisht kundër krimit të organizuar, siç është:

- trafikimi i njerëzve;
- aktivitetet e paligjshme ekonomike, dhe veçanërisht korrupsioni dhe transaksionet e paligjshme të cilat përfshijnë mallra siç janë mbeturinat industriale, materiali radioaktiv dhe prodhimet e falsifikuara dhe piraterike;
- tregtia e paligjshme e drogave dhe substancave psiko-tropike;
- kontrabanda;
- tregtia e paligjshme e armëve;
- terrorizmi.

Bashkëpunimi në lidhje me çështjet e lartpërmendura do t'i nënshtrohet konsultimeve dhe koordinimit të ngushtë mes Palëve.

Ndihma teknike dhe administrative në këtë fushë mund të përfshijë:

- përgatitje të teksteve të ligjeve në fushën e të drejtës penale;
- përforsim të efikasitetit të institucioneve të ngarkuara me luftën kundër krimit dhe me pengimin e tij;
- trajnim të personelit dhe zhvillim të kapaciteteve hetimore;
- formulim të masave për pengim të krimit.

të të dhënave dhe qendrës koordinuese të vendosur në Hagë, e cila mbledh, analizon dhe jep informata për aktivitetet kriminale.

BE gjithashtu punon edhe me shtete partnere, veçanërisht me SHBA-të, Rusinë dhe shtetet mesdhetare, si dhe me organizatat ndërkombëtare siç është Zyra e komisarit të lartë për refugjatët të KB-ve, në formulimin dhe zbatimin e masave të politikës së përbashkët të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

EU, isto taka, raboti i so partnerski zemji, osoben o SAD, Rusija i mediteranskite zemji, kako i so mejunarodni organizacii kako što e Kancelarijata na visokiot komesar za begalci na ON, na osmisluvawe i sproveduvawe na merkite na zaedni-kata politika na sloboda, bezbednost i pravda.

Politika e bashkëpunimit gjyqësor

Nëse dikush kryen një vepër penale në një shtet-anëtar të BE-së, a mund t'i shmangët sistemit gjyqësor duke ikur në ndonjë shtet tjetër anëtar? Ose, çka nëse procesi i shkurorëzimit zhvillohet mes njerëzve të cilët jetojnë në shtete të ndryshme? BE përbëhet nga 27 shtete të ndryshme anëtare, të cilat dallohen në aspekt të sistemeve të tyre legjislative dhe administrative. Qëllimi është që nëpërmjet bashkëpunimit gjyqësor në lëndë civile qytetarëve të BE-së t'u mundësohet qasje deri te gjykatat në cilindo shtet-anëtar dhe zbatim i vendimeve gjyqësore në tërë territorin e BE-së, pa marrë parasysh dallimet në legjislacionet nacionale.

Me qëllim të luftës sa më efikase kundër krimit të organizuar, është zhvilluar edhe politika e bashkëpunimit gjyqësor në lëndët penale. Me bashkëpunimin në lëndët penale është zvogëluar kohëzgjatja dhe ndërlikueshmëria e procedurës së ekstradimit mes shteteve-anëtare, përkatësisht procedurës së kapjes dhe dorëzimit të personit me qëllim që të zbatohet procedura penale ose të ekzekutohet dënimi me burg ose paraburgimi.



MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 79

Bashkëpunimi për drogat e palejuara

Në fushën e autorizimeve dhe kompetencave të tyre, Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të sigurojnë qasje të barazuar dhe të integruar ndaj luftës kundër drogave. Politika dhe aktivitetet e luftës kundër drogës do të jenë të orientuara drejt zvogëlimit të ofertës, qarkullimit dhe kërkesës së drogave të palejuara, si dhe drejt kontrollit më efikas të prekurzorëve.

Palët do të merren vesh për metodat e nevojshme për bashkëpunim që të arrihen këto qëllime. Veprimet e tyre do të bazohen në principe të harmonizuara bashkërisht, në pajtim me Strategjinë e Bashkimit Evropian për drogat.

Bashkëpunimi mes Palëve do të përfshijë ndihmë teknike dhe administrative, veçanërisht në fushat në vijim: përgatitja e teksteve të ligjeve dhe e politikës; themelimi i institucioneve dhe qendrave informative; trajnimi i personelit dhe hulumtimi në lidhje me drogën; pengimi i riorientimit të prekurzorëve me qëllim të prodhimit të palejuar të drogave. Palët mund të pajtohen të përfshijnë edhe fusha tjera.



SHKENCA DHE HULUMTIMI

KAPITULLI

25

KAPITULLI 25

SHKENCA DHE HULUMTIMI

INVESTIMI NË ARDHMËRINË

Qëllimi i BE-së: ekonomia më konkurrense në botë deri në vitin 2020?

E kaluara hulumtuese e kontinentit evropian veçohet me pasuri dhe llojllojshmëri në të gjitha fushat: prej zbulimeve të mëdha gjeografike, revolucionit industrial, deri te telefonat celularë dhe aeroplani Erbas.

Në fushën e shkencës dhe hulumtimit, BE ballafaqohet me konkurrencë të fuqishme në ekonominë globale. Me qëllim që ta ruajë aftësinë konkurruese, BE sot e nxit bashkëpunimin e shteteve-anëtare, për shkak se është treguar që ndërmarrjet individuale dhe institutet nacionale hulumtuese nuk mund ta realizojnë qëllimin vetë. Dispozitat për zhvillimin e aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese janë definuar me Kapitullin 25, duke i respektuar specifikat e shteteve individuale anëtare.

Hartimin dhe zbatimin e dispozitave që gjenden në kapitullin e përmendur i koordinon Komisioni Evropian në bashkëpunim me Qendrën e përbashkët hulumtuese (Joint Research Center - JRC), e cila përbëhet prej një rrjeti të instituteve që i zbatojnë

hulumtimet për gjetje të zgjidhjeve shkencore-teknike për përmirësim të politikave të BE-së dhe për rritje të aftësisë konkurruese të industrive në BE.

Me krijimin e tregut të përbashkët evropian, BE ka programe kornizë për nxitje të aktiviteteve dhe bashkëpunimit shkencor-hulumtues, prioritetet e të cilave ndryshojnë në pajtim me nevojat zhvillimore. Me Strategjinë e Lisbonës është theksuar qëllimi themelor i BE-së: deri në fund të vitit 2020, ekonomia e BE-së të bëhet ekonomia më konkurrense dhe më dinamike në botë. Një prej mënyrave për realizim të këtij qëllimi është nëpërmjet Hapësirës hulumtuese evropiane (European Research Area - ERA) si hapësirë e lirë për



MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 102

Bashkëpunimi në fushat e hulumtimit dhe zhvillimit teknologjik

Palët do ta avancojnë bashkëpunimin bilateral në hulumtimin publik shkencor dhe zhvillimin teknologjik (HZHT) në bazë të dobisë së ndërsjellë dhe, duke e marrë parasysh të qenët në dispozicion të resurseve, do të nxisin qasje të përshtatshme ndaj programeve të tyre, me kusht që të ekzistojë nivel përkatës i mbrojtjes efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik do t'i përfshijë:

- këmbimin e informatave shkencore dhe teknike;
- organizimin e takimeve të përbashkëta shkencore;
- aktivitetet e përbashkëta për HZHT;
- aktivitetet për trajnim dhe programet për lëvizshmëri të shkencëtarëve, hulumtuesve dhe personave teknikë të angazhuar në HZHT në të dyja anët.

Bashkëpunimi i tillë do të realizohet sipas aranzhmaneve konkrete, për të cilat do të negociohet dhe të cilat do të lidhen në pajtim me procedurat e adoptuara nga secila Palë dhe të cilat, mes tjerash, do të parashohin dispozita përkatëse për të drejtat e pronësisë.

lëvizje të diturisë, hulumtuesve dhe teknologjisë me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit, në të cilën do të krijohet dhe do të zbatohet politika e përbashkët e hulumtimeve. Ashtu si që tregu i përbashkët i ka mënjeluar pengesat për lëvizje të lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit, ERA u mundëson

shkencëtarëve të veprojnë dhe të bashkëpunojnë në projekte në tërë Bashkimin Evropian. Lëvizja e lirë e ideve dhe resurseve do t'u mundësojë hulumtuesve evropianë më shumë mundësi, si ato që tashmë i kanë kolegët e tyre në SHBA. Së këndejmi rrjedh edhe liria e re e pestë e tregut të brendshëm - liria e lëvizjes së diturisë.

Për t'u zvogëluar dallimet në fushën e investimeve në sektorin e diturisë, hulumtimit dhe teknologjive mes Evropës, SHBA-ve dhe Japonisë, në BE është rritur niveli i investimit në hulumtim me qëllim që pjesëmarrja e tij në BPV deri në vitin 2010 të jetë 3%.²

Për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2013, Komisioni Evropian pranoi propozim të ri për Programin e shtatë kornizë (Seventh Framework Programme - FP 7), përkatësisht ndërtim të territorit evropian të shkencës për rritjen. Programi mbështetet te shkenca si resurs më i madh evropian dhe e thekson rëndësinë e hulumtimit më shumë se cilido program i deritanishëm kornizë, duke e shënuar pikërisht hulumtimin si bazë me të cilën industria evropiane në të ardhmen do të mund ta sigurojë vendin e parë në botë.

Zgjidhja për "largimin e trurit"

Edhe pse BE ka më shumë të diplomuar se SHBA-të nga fusha e shkencës dhe inxhinierisë, numri i tyre është ende i pamjaftueshëm për krijim të ekonomisë më konkurrenente në botë. Momentalisht 85.000 hulumtues të lindur në BE punojnë në SHBA.³

Për pengim të «largimit të trurit» janë paraparë programe të ndryshme për nxitje të shkencëtarëve që të mbesin në qendrat hulumtuese, duke e përfshirë edhe këmbimin shkencor në institutet dhe laboratorët


² Burimi: <http://www.europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l23022.htm>

³ Burimi: Shikimi kah ardhmëria, Hulumtimet shkencore në BE, Komisioni Evropian, Zyra e përgjithshme për media dhe informim, Bruksel, 2004.

në shtetet tjera. Programi «Marie Curie» u mundëson 9.000 shkencëtarëve në vit të shkojnë në shtete tjera me ndihmë të Rrjetit evropian të qendrave për lëvizshmëri me 200 qendra në 32 shtete evropiane, i cili shkencëtarëve dhe familjeve të tyre u ndihmon në shpërnguljen në ndonjë shtet tjetër.

Projektet të cilat presin disa hulumtues të ardhshëm dhe të cilat do të duhej ta lëviznin BE-në drejt kulmit botëror e kanë zotëruar fuzionin bërthamor, proces i cili i lëviz Diellin dhe yjet, kurse me të do të sigurohej energji e qëndrueshme me ndikim minimal mbi mjedisin jetësor. Centrali i parë i tillë do të duhej të vendoset në Francë, por do të duhet të presim edhe disa dekada deri në realizimin e tij.

Projekt tjetër i rëndësishëm është gjetja e mënyrës së shfrytëzimit të hidrogjenit si burim i energjisë, me çka do të zvogëlohej varësia prej lëndëve djegëse të fosileve. Tashmë ekzistojnë prototipa të automobilave me motor me hidrogjen, kurse nëse projekti tregohet i suksesshëm parashihet zbatimi i tij në aeroplanë, ndërtesa, spitale, kompjuterë dhe telefona celularë.





ARSIMI DHE KULTURA



KAPITULLI

26

KAPITULLI 26

ARSIMI DHE KULTURA

Arsimi në Bashkimin Evropian

Ndoshta deri tani nuk keni dëgjuar për nocionin Hapësira evropiane për arsim të lartë (European Higher Education Area), por me siguri e keni të njohur procesin e Bolonjës. Pikërisht procesi i Bolonjës është mjet me të cilin Bashkimi Evropian punon në krijimin e Hapësirës evropiane për arsim të lartë deri në vitin 2010. Prosesi i përmendur është vetëm një shembull i masave të cilat i ndërmerret BE për përfundim të bashkëpunimit mes shteteve-anëtare në fushën e arsimit.

Arsimi në BE sot merr një domethënie të re dhe bëhet pjesë e strategjisë evropiane për punësim. Kapitulli 26 paraqet kornizë për politikatat nacionale, duke u bazuar në programin punues të BE-së të quajtur «Arsimi dhe trajnimet 2010» (Education & Training 2010). Bashkimi Evropian disponon me mekanizma dhe mjete të shumta për stimulim të bashkëpunimit në këtë fushë, dhe si më të rëndësishme veçohen programet shumëvjeçare aksionare. Çdo vit më shumë se një milion qytetarë të BE-së të të gjitha moshave kanë dobi prej programeve për arsim, prej trajnimeve profesionale dhe prej ndërtimit të shoqërisë civile. Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2013 do të shfrytëzohet programi i ri i quajtur «Mësimi gjatë tërë jetës» (Lifelong Learning), i cili i përfshin katër programet e deritanishme: „Comenius” - për arsim parashkollor dhe shkollor, „Erasmus” - për arsim të lartë dhe avancim të përparuar, „Leonardo da Vinci” - për arsim profesional dhe „Grundtvig” - për arsim për të rritur.

Programi i ri përfshin mësim të gjuhëve të huaja, të teknologjive informatike dhe të komunikimit dhe të programit „Jean Monnet”⁴ për integrimet evropiane. Informata më të detajuara për programin dhe mundësitë për bashkëpunim janë në dispozicion në Internet faqen e Komisionit Evropian http://ec.europa.eu/education/policies/2010/et_2010_en.html

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 91

Arsimi dhe trajnimi

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që ta rrisin nivelin e arsimit të përgjithshëm dhe të kualifikimeve profesionale në Republikën e Maqedonisë, duke i marrë parasysh prioritetet e Republikës së Maqedonisë.

Programi Tempus do të kontribuojë për përfundim të bashkëpunimit mes dy Palëve në fushën e arsimit dhe trajnimit, për avancim të demokracisë, sundimit të së drejtës dhe reformës ekonomike.

Fondacioni evropian për trajnim gjithashtu do të kontribuojë për avancim të strukturave dhe aktiviteteve për trajnim në Republikën e Maqedonisë.

⁴ Programi „Jean Monnet” përmban tri aktivitete kyçe: Zhan Mone - aktivitete, Institucionet evropiane dhe Shoqatat evropiane.

Të rinjtë në Bashkimin Evropian

Edhe pse edhe politika për të rinjtë është në ingjencë të shteteve-anëtare, BE zbaton masa për nxitje të aktiviteteve të përbashkëta në këtë fushë. Programi i ri për të rinjtë, i cili ka të bëjë me periudhën 2007-2013, quhet Të rinjtë në aksion (Youth in Action), dhe nxit përfshirje aktive të të rinjve në Bashkësi, i përkrah të rinjtë të cilët dëshirojnë të kyçen në punë vullnetare tejkufitare dhe i aftëson ata për menaxhim të projekteve të cilat u ndihmojnë bashkësive lokale, etj. Ai bazohet në arsimin joformal dhe mësimin nëpërmjet përvojës, dhe e përkrah konceptin e mësimi gjatë tërë jetës dhe zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive me qëllim të nxitjes së vetëdijes aktive qytetare në drejtim të zhvillimit të bashkësisë. Informata për projektet dhe programet për të rinjtë në BE mund të gjenden në Internet faqen: http://www.europa.eu/youth/new.cfm?nid=4989&sid=o&L_id=e

Hapësira kulturore evropiane

A ju duket e mundshme që të bashkohen kulturat e 27 shteteve-anëtare të BE-së? Qëllimi i Bashkimit Evropian në aspekt të kulturës është i dyanshëm: nga njëra anë ka të bëjë me ruajtjen e llojlojshmërive nacionale dhe rajonale, kurse nga ana tjetër me theksimin e trashëgimisë së përbashkët kulturore. Për realizim të qëllimit të përmendur ekziston një program kornizë i BE-së për periudhën 2007-2013 i quajtur Kultura 2007 - 2013 (Culture Programme 2007-2013). Zbatimi i këtij programi fillon në janar të vitit 2007, duke e zëvendësuar programin Kultura

2000 (2000 - 2006). Programi Kultura bazohet në tri qëllime programore - përkrahja e lëvizshmërisë së punëtorëve të kulturës, përkrahja e lëvizshmërisë së veprave kulturore dhe nxitja e dialogut ndërkulturore.

Mes tjerash, Bashkimi Evropian i nxit qeveritë e shteteve-anëtare që të promovojnë zhvillim kulturor në rajonet e varfra, me çka do t'u ndihmohej të ruhet identiteti, të tërheqin turistë dhe të krijojnë vende të reja pune në fusha siç janë internet shërbimet dhe mediat.



Neni 92

Bashkëpunimi kulturor

Palët obligohen që ta avancojnë bashkëpunimin kulturor. Bashkëpunimi i këtillë, mes tjerash, shërben për rritje të kuptimit dhe respektimit të ndërsjellë mes individëve, bashkësive dhe popujve.

Llojllojshmëria gjuhësore si pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane

Sot në BE ka 23 gjuhë zyrtare, në suaza të të cilave ekzistojnë edhe gjuhë të pakicave dhe gjuhë rajonale (baske, bretone, katalonase, frizike, uellsiane, etj). Vlerësohet që më shumë se 40 milionë njerëz në BE flasin në gjuhë amtare që nuk është gjuhë zyrtare në shtetin e prejardhjes së tyre. Hulumtimi i Eurobarometrit tregon që pjesa më e madhe e amvisërive të cilat, përpos gjuhës amtare, shfrytëzojnë aktivisht edhe ndonjë gjuhë tjetër, gjenden në Luksemburg (99%) dhe në Letoni dhe në Maltë (93%)⁵. Projekti Kultura e nxit ruajtjen e tyre, kurse qëllimi afatgjatë është nxitja e popujve në BE që të mësojnë dy gjuhë, përpos gjuhës së tyre amtare. Përpos kësaj, BE kërkon që legjislati i vet të jetë në dispozicion në të gjitha gjuhët, dhe sipas kësaj edhe në dispozicion të të gjithë qytetarëve.

Të gjithë qytetarëve u garantohet mundësia që t'i shkruajnë ndonjë institucioni ose trupi të BE-së dhe të marrin përgjigje në gjuhën e tyre. Në mënyrë të njëjtë, deputeti në Parlamentin Evropian ka të drejtë t'i përfaqësojë votuesit e vet në gjuhën e vet.

Me hyrjen e Bullgarisë dhe Rumanisë në BE prej 1 janarit të vitit 2007, përpos gjuhëve të reja zyrtare, BE fitoi edhe shkrim të ri zyrtar - përpos shkrimit latin dhe alfabetit grek, shkrim zyrtar është edhe shkrimi cirilik bullgar.



⁵ Burimi: Eurobarometer Survey, <http://europa.eu/languages/en/chapter/14>



MJEDISI JETËSOR

KAPITULLI

27

KAPITULLI 27

MJEDISI JETËSOR

SI BALLAFAQOHET BE ME NDOTJEN E MJEDISIT JETËSOR

Përveprat e ndëshkueshme si ndotja e paligjishme e mjedisit jetësor që rezulton me erë të keqe, ose transporti i mbeturinave të rrezikshme që u bën dëm mjediseve të mbrojtura, Komisioni Evropian ka propozuar masa për të cilat momentalisht po debatohet në Parlamentin Evropian, dhe kanë të bëjnë me dënime në të holla në shumë prej 300.000 deri në 1,5 milionë euro dhe dënime me burg prej një deri në dhjetë vjet, varësisht nga shkalla e moskujdesit të individit dhe/ose kompanisë për mjedisin jetësor.

Masat e shënuara janë vetëm një pjesë e përpjekjeve të BE-së për mbrojtje të mjedisit jetësor në suaza të politikës së përbashkët të BE-së të përfshirë në Kapitullin 27. Legjislacioni për mbrojtje të mjedisit jetësor përfshin një varg dispozitash të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, mbrojtjen e bio-diversitetit në natyrë, ruajtjen e shëndetit dhe cilësisë së jetës dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe mbeturinave natyrore. Politika e BE-së për mbrojtje të mjedisit jetësor bazohet në besimin që standardet e larta ekologjike stimulojnë inovacione dhe mundësi për punë, dhe me këtë para shteteve-anëtarë është vënë një sfidë: në çfarë mënyre të kombinohet rritja e vazhdueshme ekonomike dhe BE të bëhet ekonomia më konkurrenente në botë, por njëkohësisht të ruhet mjedisi jetësor?

Me cilat çështje merret Politika e përbashkët për mjedisin jetësor?

Cilësia e ajrit është një prej çështjeve kryesore të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Janë përcaktuar metoda për ndjekje të cilësisë së ajrit, kontroll të vlerave kufitare për ndotje të materieve dhe të emetimeve të tyre prej burimeve mobile dhe stacionare, në drejtim të zvogëlimit të ndotjes prej ndotësve të ajrit. BE e nxit përmirësimin e cilësisë së lëndëve djegëse dhe informimin e konsumatorëve për rentabilitetin e tyre dhe emetimet e dyoksid karbonit (shkaktar kryesor i efektit të serrës) gjatë shitjes së automjeteve të reja për udhëtarë.

Me zbatimin e Protokollit të Kjotos, BE përpiket ta zgjidhë problemin me ndryshimet klimatike, dhe për këtë shkak janë përcaktuar edhe dispozita për materiet të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit dhe për tregtinë me kuotat për gazra të dëmshme. Për repartet industriale dhe energjetike janë përcaktuar kufij të lejuar për emetim të dyoksid karbonit. Repartet të cilat nuk do ta shfrytëzojnë kuotën e lejuar të emetimit të këtij gazi mund t'ia shesin “tepricën” e tyre kompanive të cilat e tejkalojnë kufirin e tyre të emetimit, me çka shmangen dënime të larta në të holla. Gjithsesi, një prej çështjeve të pazgjidhura është emetimi i gazrave të dëmshme prej aeroplanëve, të cilët marrin pjesë me rreth 3% në emetimin e përgjithshëm, me vërejtje që komunikacioni ajror rritet shumë shpejt.

Neni 103

Mjedisi jetësor dhe siguria bërthamore

Palët do ta zhvillojnë dhe do ta përforcojnë bashkëpunimin e tyre në lidhje me qëllimet esenciale të luftës kundër degradimit të mjedisit jetësor me qëllim që të përkrahet qëndrueshmëria e tij.

Bashkëpunimi do të orientohet drejt fushave me prioritet në vijim:

- lufta kundër ndotjes lokale, rajonale dhe tejkufitare (cilësia e ajrit dhe e ujit, duke e përfshirë edhe pastrimin e ujërave të zeza dhe ndotjen e ujit për pije) dhe krijimi i mbikëqyrjes efikase;
- zhvillimi i strategjive në lidhje me çështjet globale dhe klimatike;
- prodhimi dhe konsumi efikas, i qëndrueshëm dhe i pastër i energjisë, siguria e kapaciteteve industriale;
- klasifikimi dhe menaxhimi i sigurt i materieve kimike;
- zvogëlimi i mbeturinave, riciklimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave dhe zbatimi i Konventës së Bazelit për kontroll të bartjes tejkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe deponim të tyre (Bazel, 1989);
- ndikimi i bujqësisë mbi mjedisin jetësor; erozioni i tokës dhe ndotja e saj me materie kimike bujqësore;
- mbrojtja e pyjeve, florës dhe faunës; ruajtja e bio-diversitetit;
- rregullimi i qyteteve dhe fshatrave, duke e përfshirë ndërtimtarinë dhe urbanizmin;
- vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor;
- afrimi i vazhdueshëm i ligjeve dhe rregullativave ndaj standardeve të Bashkësisë;
- konventat ndërkombëtare nga fusha e mjedisit jetësor, në të cilat Bashkësia është anëtare;
- bashkëpunimi në nivel rajonal, si dhe bashkëpunimi në suaza të Agjencisë evropiane për mjedis jetësor;
- arsimi, informatat dhe vetëdija publike për çështjet e mjedisit jetësor.

Në fushën e mbrojtjes prej fatkeqësive natyrore, qëllimi i bashkëpunimit është të sigurohet mbrojtja e njerëzve, kafshëve, pronës dhe mjedisit jetësor prej katastrofave të shkaktuara nga njeriu. Për këtë qëllim, bashkëpunimi do të mund t'i përfshinte fushat në vijim:

- këmbimi i rezultateve prej projekteve shkencore dhe hulumtuese-zhvillimore;
- mbikëqyrja e ndërsjellë, sistemet për paralajmërim dhe raportim të hershëm për katastrofat dhe pasojat e tyre;
- aksionet shpëtimtare dhe aksionet për dhënie të ndihmës dhe sistemet për ndihmë në rast të katastrofave;
- këmbimi i përvojës për rehabilitim dhe rindërtim pas katastrofave;

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë bërthamore do të mund t'i përfshinte temat në vijim:

- përmirësimi i ligjeve dhe rregullativës së Republikës së Maqedonisë për sigurinë bërthamore dhe përforcimi i autoriteteve mbikëqyrëse dhe i resurseve të tyre;
- mbrojtja nga rrezatimi, duke e përfshirë edhe mbikëqyrjen e rrezatimit në mjedisin jetësor;
- menaxhimi i mbeturinave radioaktive. Republika e Maqedonisë obligohet t'i sigurojë informata Këshillit për stabilizim dhe asociim për secilin qëllim që të importojë ose të magazinon mbeturina radioaktive;
- ta nxisë lidhjen e marrëveshjeve mes shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian ose Euroatom-it dhe Republikës së Maqedonisë për lajmërim të hershëm të të dhënave në raste të fatkeqësive bërthamore dhe, nëse ka nevojë, edhe në përgjithësi për çështjet nga fusha e sigurisë bërthamore;
- përforcimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të transportit të materialeve të cilat mund të pësojnë ndotje radioaktive.

Bashkimi Evropian e ka definuar edhe masën për menaxhim të mbeturinave. Qëllim primar i politikës së BE-së është zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që prodhohet nëpërmjet pengimit, shfrytëzimit më të mirë të resurseve, nxitjes së prodhimeve “më të pastra” dhe shfrytëzimit të prodhimeve “më të pastra”. Menaxhimi i këtillë i qëndrueshëm i mbeturinave nënkupton edhe dispozita për mbeturinat e rrezikshme, veprimin me deponitë, posaçërisht sipas llojit të mbeturinave, përkatësisht a bëhet fjalë për mbeturina të automobilave, mbeturina të ambalazhit, mbeturina prej pajisjes elektrike, baterive dhe akumulatorëve, etj.

Dhe çka në lidhje me ndotjen e lumenjve, liqeneve dhe brigjeve, pjesë të rëndësishme të mjedisit jetësor të Evropës? Mbrojtja e ujërave është gjithashtu një prej temave të Kapitullit 27. Shteteve-anëtare të BE-së u përcaktohet obligim për kontroll të emetimit të materieve të dëmshme në ujë, pastrim të ujërave të zeza dhe mbrojtje të ujërave prej ndotjes së shkaktuar prej nitrateve me prejardhje bujqësore. Kohëve të fundit, gjithnjë më shumë aktivitete janë orientuar edhe drejt masave për mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit jetësor detar.

Në drejtim të mbrojtjes së llojeve bimore dhe të kafshëve, si dhe të vendeve të rëndësishme për ruajtje të popullsisë së tyre, është krijuar rrjeti NATURA 2000. Për shembull, një prej dispozitave të BE-së në lidhje me mbrojtjen e kafshëve ka të bëjë me gjuetinë me kurthe. Çka nëse jeni gjuetar i kafshëve të gëzofta, madje edhe jashtë BE-së, dhe praktikoni metoda të gjuetisë të cilat nuk i plotësojnë normat ndërkombëtare ose shfrytëzoni kurthe? BE e ndalon blerjen e gëzofit dhe prodhimeve të gëzofit.

Ndotësi paguan!

Të gjitha segmentet e politikës për mbrojtje të mjedisit jetësor të BE-së bazohen në principin “ndotësi paguan”. Paguesa mund të jetë në formë të:

- Investimeve financiare të nevojshme për plotësim të standardeve të nevojshme për mbrojtje të mjedisit jetësor.
- Marrjes prapa, riciklimit ose gjuajtjes së prodhimit pas përdorimit të tij
- Taksave për punë ose për konsumatorët të cilët shfrytëzojnë prodhime të papranueshme nga aspekti ekologjik, siç janë disa lloje të paketimit.

Përpos Komisionit Evropian, rol të rëndësishëm në zbatimin e politikës për mbrojtje të mjedisit jetësor ka edhe Agjencia evropiane për mjedis jetësor me seli në Kopenhagë.



MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE E SHËNDETIT

KAPITULLI

28

KAPITULLI 28

MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE E SHËNDETIT

CAVEAT EMPTOR OSE BLERËSI TË JETË I KUJDESSHËM GJATË BLERJES

Shprehja Caveat emptor (blerësi të jetë i kujdesshëm gjatë blerjes) ka ekzistuar që në të drejtën romake, dhe ka qenë e lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve. Rregullativa ligjore në lidhje me këtë çështje, si dhe krijimi i politikës së përbashkët për mbrojtje të konsumatorëve në BE, fillon në vitet e 70-ta. Qëllimi i Kapitullit 28 është mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve, mbrojtja e interesit ekonomik të konsumatorëve, informimi dhe edukimi i konsumatorëve dhe organizimi efikas i konsumatorëve për mbrojtje të interesave të tyre. Ky kapitull ka të bëjë edhe me harmonizimin e qasjes së politikës së shëndetit publik mes shteteve-anëtare të BE-së. Tregu i përbashkët dhe valuta e përbashkët i hapin kufijtë tregtarë, kurse me rritjen e Internetit, tregtisë elektronike dhe me zgjerimin e sektorit të shërbimeve, është e rëndësishme që 27 shtetet-anëtare të kenë dobi nga niveli i lartë i mbrojtjes së konsumatorëve.

Komisioni Evropian çdo vit pranon rreth 150 paraqitje për prodhime të rrezikshme. Shtetet-anëtare i dërgojnë paraqitjet deri te sistemi për alarmim të shpejtë (Rapid Alert System - RAPEX).



Çka përmban secila paraqitje dhe për çka shërben?

Numri i prodhimit	Shteti në të cilin paraqitet që prodhimi nuk është në rregull	Prodhimi	Rreziku	Masat e ndërmarra
10064/07	Gjermania	Zinxhir Prodhues: Ziman Numri i modelit: 828300 Kodi EAN: 200091279802 Shteti i prejardhjes: Holanda	Helmimi	Tërheqja e prodhimit nga tregu, njoftimi i blerësve për kthim të parave për prodhimin e blerë nga ana e shitësit

Burimi: *European Commission, DG Health and Consumer Protection, RAPEX*
http://ec.europa.eu/consumers/dyna/rapex/create_rapex.cfm?rx_id=115

Pas paraqitjes, prodhimi tërhiqet nga tregu, prodhuesi e informon opinionin për rreziqet, mblidhen dhe testohen prodhimet e shënuara dhe prodhuesi e garanton të drejtën e blerësve për dëmshpërblim.

Legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve është vetëm një prej masave të politikave të përbashkëta të BE-së. Metodat tjera e përfshijnë rregullimin e përbashkët mes konsumatorëve dhe organizatave afariste dhe orientimet për praktika të mira. Organizatat e fuqishme të konsumatorëve gjithashtu kanë rol të rëndësishëm, veçanërisht në tregjet e reja të shteteve-anëtare të BE-së.

Mbrojtja e konsumatorëve është domosdoshmërisht e lidhur me politikën e tregut të brendshëm dhe kjo e drejtë e mbrojtjes së konsumatorëve është zhvilluar si dukuri shoqëruese gjatë formimit të tregut të brendshëm. Nëse tregu i brendshëm funksionon mirë, ai do ta stimulojë besimin e konsumatorëve në transaksionet tejkufitare dhe do të ketë ndikim pozitiv mbi konkurrencën dhe çmimet, në dobi të të gjithë qytetarëve të BE-së.

Harmonizimi i legjislacionit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve është specifik për më shumë arsye. Politika e mbrojtjes së konsumatorëve është para së gjithash politikë horizontale, përkatësisht politikë qëllimet e së cilës duhet patjetër të merren parasysh edhe gjatë miratimit të akteve për çështje tjera. Kështu, aktet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e ushqimit, lojërat ose lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve duhet patjetër të përmbajnë norma të caktuara të cilat janë relevante për mbrojtjen e konsumatorëve. Në të kaluarën, kornizën për zhvillim të kësaj politike e kanë përbërë planet trevjeçare të Komisionit Evropian, kurse kohëve të fundit këtë e bën Strategjia për mbrojtje të konsumatorëve 2007-2013, me të cilën janë

definuar standardet themelore shëndetësore dhe të sigurisë për prodhime të caktuara, mbrojtja nga tregtia ilegale, plani për informim të konsumatorëve për të drejtat e tyre dhe kyçja e tyre aktive në definimin e mëtutjeshëm të dispozitave në politikat tjera të BE-së: të transportit, financiare, bujqësore, si dhe në politikën për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Njerëzit duhet patjetër të jenë të sigurt dhe të kenë informata të mjaftueshme të sakta para se të blejnë diçka dhe të gëzojnë të drejta të qarta ligjore kur transaksionet të marrin drejtim të gabuar. Për këtë arsye, nevojiten rregulla të harmonizuara qartas, me çka do të garantohej nivel përkatës i mbrojtjes.

Në drejtim të intensifikimit të komunikimeve me konsumatorët, Komisioni Evropian e ka themeluar Rrjetin e qendrave evropiane të konsumatorëve (European Consumers Centres Network, ECC- Net), me të cilin janë lidhur qendrat në të gjitha shtetet-anëtare.

Detyrat e shteteve-anëtare

Pjesa më e madhe e direktivave të pranuar në nivel të BE-së janë direktiva për harmonizim minimal, që do të thotë që Bashkësia pranon vetëm standarde minimale, të cilat janë të domosdoshme që të sigurohet mbrojtja e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, kurse shtetet-anëtare mund t'i mbajnë ato ose të implementojnë rregulla më të rrepta për mbrojtje të konsumatorëve, me kusht që me këtë mos ta pamundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve në tregun e brendshëm.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 97

Mbrojtja e konsumatorëve

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që t'i harmonizojnë standardet për mbrojtje të konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë me ato në Bashkësi. Mbrojtja efi-kase e konsumatorëve është e domosdoshme me qëllim që të sigurohet që ekonomia e tregut funksionon në mënyrë të përshtatshme, kurse kjo mbrojtje do të varet nga zhvillimi i infrastrukturës administrative me qëllim që të sigurohet mbikëqyrje e tregut dhe zbatim i ligjit në këtë fushë.

Për këtë qëllim, dhe duke i marrë parasysh interesat e tyre të përbashkëta, Palët do të nxisin dhe do të sigurojnë:

- harmonizim të legjis-lacionit dhe harmonizim të mbrojtjes së konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë me legjis-lacionin dhe mbrojtjen të cilat janë në fuqi në Bashkësi;
- politikë të mbrojtjes aktive të konsumatorëve, duke e përfshirë edhe informimin e shtuar dhe zhvillimin e organizatave të pavarura;
- mbrojtje efektive juridike të konsumatorëve me qëllim që të përmirësohet cilësia e mallrave për konsum të gjerë dhe të mbahen standardet përkatëse të sigurisë.

Shëndetësia në BE

Edhe pse përgjegjësinë primare për kujdesin shëndetësor e kanë shtetet-anëtare, shumë çështje të shëndetësisë publike zgjidhen më së miri nëpërmjet përgjigjes së përbashkët të BE-së. Politika e përbashkët realizohet nëpërmjet promovimit të shëndetit dhe kontrollit të realizimit të qëllimeve të politikës shëndetësore, luftës kundër sëmundjeve ngjitëse, sëmundjeve të rralla dhe kancerit, pengimit të varësive, fatkeqësive dhe sëmundjeve të lidhura me ndotjen e mjedisit jetësor, si dhe përforcimit të aftësisë për veprim të shpejtë dhe të përshtatshëm në raste të cilat janë të rrezikshme për shëndetin. Qëllimet e politikës së BE-së për mbrojtje të shëndetit janë:

- Harmonizimi i legjislacionit për mbrojtje shëndetësore në BE
- Mbrojtja e qytetarëve nga rreziku për shëndetin
- Promovimi i politikave të cilat shpjen deri në stil më të shëndoshë jetësor
- Kontributi në zvogëlimin e paraqitjes së sëmundjeve më serioze në BE
- Kontributi për zhvillim të sistemit efikas shëndetësor
- Qasja deri te informatat për shëndetin
- Qasja deri te drejta e qytetarëve që ta shprehin mendimin e tyre për çështjet shëndetësore

Zgjerimi i BE-së paraqet sfidë të posaçme në zgjidhjen e pabarazisë, për shkak se kohëzgjatja e jetës në shtetet “e reja” anëtare është më e ulët, kurse shkalla e vdekshmërisë është më e lartë.



Epidemia - çka atëherë?

Në rast të rrezikut nga epidemia, BE harton plan koordinues me përgjigje. Me themelimin e Qendrës evropiane për pengim dhe kontroll të sëmundjeve, me seli në Stokholm, dhe formimin e rrjetit të qendrave informative, është mundësuar veprimi i shpejtë, i rëndësishëm për pengim të përhapjes së epidemive. Qendra jep informata, këshilla dhe trajnim për kërcënimet prioritare. Ato i përfshijnë ndezjen e mushkërive, AIDS-in, mikrobet rezistuese ndaj barërave dhe tuberkulozin. Komisioni gjithashtu i vlerëson rreziqet shëndetësore të cilat paraqiten pas përdorimit të substancave siç janë për shembull ngjyra e flokëve ose disa teknologji të reja.



UNIONI DOGANOR

KAPITULLI

29

KAPITULLI 29

UNIONI DOGANOR

DOGANAT

Hapësira pa kontrolle kufitare në Bashkimin Evropian mundëson shitje të automobilitave francezë në Danimarkë pa pagesë të çfarëdo qoftë dogane. Dogana mbi automobilat e importuar prej SHBA-ve paguhet në momentin kur automobili hyn në BE për herë të parë, dhe pas kësaj nuk kalon nëpër kontrolle ose pagesa plotësuese. Unioni doganor është krijuar në vitin 1968, kurse kalimet kufitare mes shteteve-anëtare janë mënjtuar në vitin 1993. Rregullat për funksionimin e tij gjenden në Kapitullin 29.

Evropa pa kufij - kush, si, pse?

Unioni doganor është një prej bazave të Bashkimit Evropian, i domosdoshëm për ekzistim të tregut të brendshëm. Tregu i brendshëm mund të funksionojë në mënyrë të duhur vetëm nëse ekziston zbatim i barabartë i akteve të përbashkëta në të gjithë kufijtë e tij të jashtëm.

Unioni doganor e përfshin tërë tregtinë e mallrave dhe përfshin ndalim për aplikim të taksave doganore mbi importin dhe eksportin dhe të akcizave me efekt të njëjtë mes shteteve-anëtare, si dhe miratim të tarifës së përbashkët doganore në raportet e shteteve-anëtare të BE-së me shtete të treta. Bashkimi Evropian i përcakton doganat e veta importuese dhe rregullat tjera doganore në

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 16

Dispozitat e këtij Kapitulli do të aplikohen mbi prodhimet të cilat rrjedhin prej Bashkësisë ose prej Republikës së Maqedonisë, të shënuara në Kapitujt 25 deri në 97 të Nomenklaturës së kombinuar, me përjashtim të atyre prodhimeve të cilat janë shënuar në Aneksin I, paragrafin I (ii) të Marrëveshjes për bujqësi (GATT 1994).

Dispozitat e neneve 17 dhe 18 nuk do të aplikohen mbi prodhimet e tekstitit, e as mbi prodhimet e çelikut, si që është shënuar në nenet 22 dhe 23.

Tregtia mes Palëve me prodhimet të cilat janë përfshirë me Marrëveshjen për themelimin të Bashkësisë evropiane për energji atomike do të realizohet në pajtim me dispozitat e asaj Marrëveshjeje.

bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare (pjesa më e madhe e tyre janë përcaktuar në suaza të Komitetit për bashkëpunim doganor dhe Organizatës botërore tregtare). Këto rregulla aplikohen për të gjitha importet, por BE ka marrëveshje tregtare të cilat ofrojnë hyrje me çmim më të ulët dhe shpeshherë qasje pa doganë për mallrat prej shteteve fqinje,

ekonomive në zhvillim dhe shteteve në zhvillim. Kjo i përfshin edhe shtetet tjera të Hapësirës ekonomike evropiane (Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia), Zvicrën, kolonitë e mëparshme britanike, franceze dhe portugeze në Afrikë, Karaibet dhe rajonin e Pacifikut, shtetet e Evropës Juglindore dhe shtetet-kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kontrolli i kufijve të jashtëm të BE-së

Nëpunësit doganorë në kufijtë e Bashkimit Evropian ndaj shteteve të treta e sigurojnë respektimin e rregullave të BE-së dhe rregullave ndërkombëtare për mbrojtje të mjedisit jetësor, shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve. Gjatë krizës ekologjike, ata janë përgjegjës për ndjekje të lëvizjes së ushqimit të ndotur ose të rrezatuar, me çka njëkohësisht sigurojnë kthim të ushqimit në shtetin e prejardhjes. Mes tjerash, doganierët kontrollojnë se a i plotësojnë prodhimet (veçanërisht aparatet elektrike) standardet e përcaktuara për plasman dhe shitje në tregun e brendshëm të BE-së.

Nëpunësit doganorë sigurojnë mbrojtje të llojeve të kërcënuara nëpërmjet kontrollit të tregtisë me fildish, kafshë, zogj dhe bimë të mbrojtura. Mbrojtja

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 17

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të hiqen taksat doganore për import të prodhimeve me prejardhje nga Republika e Maqedonisë në Bashkësinë Evropiane.

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të hiqen kufizimet kuantitative të importit dhe masat të cilat kanë ndikim të njëjtë mbi importin e prodhimeve me prejardhje nga Republika e Maqedonisë në Bashkësinë Evropiane.

e trashëgimisë kulturore realizohet me ndjekje të kontrabandës së veprave artistike dhe kontroll të legjitimitetit të eksportit të teknologjisë së ndjeshme, e cila do të mund të shfrytëzohej për prodhim të armatimit bërthamor ose kimik. Megjithatë, më shpesh se teknologjia e ndjeshme, nëpër kufijtë e shteteve kontrabandohet mall si telefona celularë dhe barëra, si dhe prodhime piraterike (disqe, tesha, etj.).

A ju duket e thjeshtë njohja e dallimeve mes xhinseve ose orës të cilat me të vërtetë i kanë prodhuar emrat e mëdhenj të shtëpive të modës dhe prodhimeve të cilat janë kopje?

Nëpunësit doganorë kontribuojnë drejt funksionimit të tregut të përbashkët me mbledhje të të dhënave për strukturën e mallrave të cilat importohen dhe eksportohen, që u ndihmon krijuesve të politikës ekonomike në zbulimin e trendeve bashkëkohore ekonomike dhe në adaptimin e ofertës ndaj kërkesës në treg.

Shërbimet doganore të shteteve-anëtare

Shërbimet nacionale doganore të shteteve-anëtare janë të ngarkuara me operacionalizimin e përditshëm të politikës doganore. Ato arkëtojnë taksa doganore, akciza dhe tatim mbi vlerën e shtuar prej prodhimeve të importuara prej shteteve të treta dhe kujdesen për respektim të kuotave importuese dhe kufizimeve tjera. Taksat doganore paraqesin një prej burimeve të të hyrave të buxhetit të BE-së. Prej shumës së taksave të tërësishme të arkëtuara doganore, shtetet-anëtare mbajnë 25%, kurse pjesën tjetër prej 75% e paguajnë në buxhetin e BE-së.

Neni 18

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të hiqen taksat doganore për import të mallrave me prejardhje nga Bashkësia në Republikën e Maqedonisë, përveç të atyre të shënuara në Aneksin I dhe II.

Taksat doganore për import të prodhimeve me prejardhje nga Bashkësia në Republikën e Maqedonisë, të shënuara në Aneksin I, do të zvogëlohen në mënyrë progresive, në pajtim me orarin kohor në vijim:

- më 1 janar të vitit të parë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 90% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të dytë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 80% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të tretë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 70% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të katërt nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 60% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të pestë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 50% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të gjashtë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 40% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të shtatë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 30% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të tetë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 20% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të nëntë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, secila taksë doganore do të zvogëlohet në 10% të taksës themelore;
- më 1 janar të vitit të dhjetë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, do të hiqen taksat e mbetura doganore.

Taksat doganore për import të prodhimeve me prejardhje nga Bashkësia në Republikën e Maqedonisë, të shënuara në Aneksin II, do të zvogëlohen në mënyrë progresive dhe do të hiqen në pajtim me orarin kohor të shënuar në Aneks.

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të hiqen kufizimet kuantitative të importit dhe masat të cilat kanë ndikim të njëjtë mbi importin e prodhimeve me prejardhje nga Bashkësia në Republikën e Maqedonisë.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 19

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë mes vete do t'i heqin të gjitha taksat në tregti të cilat kanë efekte të njëjta si taksat doganore mbi importin.

Doganat dhe teknologjia informatike

Për azhurnim më të mirë dhe më të saktë, për automatizim të procedurës së tregtisë në suaza të kufijve të brendshëm dhe të jashtëm të BE-së, si dhe për siguri më të madhe të të dhënave dhe shpejtim të transitit, prej vitit 2003 deri në vitin 2005 ka filluar të implementohet edhe Sistemi i ri kompjuterik për transit (New Computerised Transit System - NCTS). NCTS shfrytëzohet për të gjitha transitet nëpër kufinj të BE-së, Lihtenshtajnit, Norvegjisë, Zvicrës dhe Turqisë.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë do t'i heqin të gjitha taksat doganore dhe taksat tjera të cilat kanë efekt të njëjtë mbi eksportin.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Bashkësia dhe Republika e Maqedonisë mes vete do t'i heqin të gjitha kufizimet kuantitative dhe masat të cilat kanë efekt të njëjtë mbi eksportin.

Planifikohet që operacionet doganore në letër të përfundojnë deri në vitin 2010, që do të thotë që të gjitha shtetet e zonës së Shengenit në dogana do të kenë përpunim tërësisht elektronik të të dhënave.



Neni 88

Dogana

Qëllimi i bashkëpunimit do të jetë të garantohet respektimi i të gjitha dispozitave të parapara për miratim në fushën e tregtisë dhe të arrihet afrimi i sistemit doganor të Republikës së Maqedonisë ndaj sistemit të Bashkësisë, me çka ndihmohet të shtrohet rruga për masat për liberalizim të planifikuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Bashkëpunimi do t'i përfshijë veçanërisht:

- këmbimin e informatave, duke i përfshirë edhe metodat hetimore;
- zhvillimin e infrastrukturës tejkuftare mes Palëve;
- mundësinë për lidhje të ndërsjellë të sistemeve transitorë të Republikës së Maqedonisë dhe të Bashkësisë, si dhe adoptim dhe përdorim të Dokumentit unik administrativ (DUA);
- thjeshtimin e inspektimeve dhe formaliteteve në lidhje me bartjen e mallrave;
- përkrahjen për implementim të sistemeve bashkëkohore informative doganore.

Pa u kufizuar bashkëpunimi i mëtutjeshëm i paraparë në këtë Marrëveshje, dhe veçanërisht në nenet 76, 77 dhe 78, ndihma e ndërsjellë mes autoriteteve administrative të Palëve për çështjet doganore do të zhvillohet në pajtim me dispozitat e Protokollit 5





MARRËDHËNIET E JASHTME



KAPITULLI

30

KAPITULLI 30

MARRËDHËNIET E JASHTME

MARRËDHËNIET ME SHTETET NË BOTË

BE gjithnjë më shumë bashkëpunon me shtetet tjera dhe me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim të promovimit të demokracisë, stabilitetit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit ekonomik. Marrëdhëniet e jashtme janë mjet për përfaqësim të BE-së në shtetet të cilat nuk janë anëtare.

Masat ligjore në këtë aspekt janë definuar në Kapitullin 30, karakteristika të të cilit janë politikat e përbashkëta tregtare dhe zhvillimore në suaza globale.

Për t'i thelluar marrëdhëniet me shtetet dhe rajonet tjera, BE mban takime të rregullta me partnerët e vet kryesorë: SHBA-të, Japonia, Kanadaja, Rusia, India dhe

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 3

Paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar dhe rajonal, si dhe zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore janë qenësorë për Procesin e stabilizimit dhe asociimit. Lidhja dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje janë në suaza të qasjes rajonale të Bashkësisë, të definuar me përfundimet e Këshillit të 29 prillit të vitit 1997, në bazë të të arriturave individuale të shteteve të Rajonit.

• Kina, si dhe dialogë rajonalë me shtetet e Mesdheut, Lindjes së Afërt, Azisë dhe Amerikës Latine.

• Një prej qëllimeve të BE-së është që deri në vitin 2010 të krijojë territor të tregtisë së lirë, i cili, përpos shteteve evropiane, do t'i përfshinte edhe shtetet rreth Mesdheut Jugor dhe Lindor nëpërmjet bashkëpunimit intensiv me organizatat ndërkombëtare (KB-të, NATO, Këshilli i Evropës) dhe me grupet rajonale në mbarë

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 4

Republika e Maqedonisë obligohet të vendosë bashkëpunim dhe marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet tjera të rajonit, duke përfshirë edhe nivel përkatës të lëshimeve të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe me zhvillimin e projekteve në interes të përbashkët. Ky përcaktim paraqet faktor kyç për zhvillim të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes Bashkësisë dhe Republikës së Maqedonisë, dhe në këtë mënyrë kontribuon për stabilitetin në Rajon.

• botën (për shembull me NAFTA-n). Në këtë mënyrë rritet përfshirja e tregtisë dhe investimeve mes BE-së dhe rajoneve të caktuara. Kështu, për shembull, përpos marrëveshjeve tregtare, me shtete të caktuara aziatike BE sot mban edhe të ashtuquajtur partneritet

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 11

Në pajtim me angazhimet e saj për paqe, stabilitet dhe zhvillim të marrëdhënieve të mira fqinjësore, Republika e Maqedonisë do ta nxisë aktivisht bashkëpunimin rajonal. Nëpërmjet programeve për ndihmë teknike, Bashkësia gjithashtu do t'i përkrahë projektet të cilat kanë dimension rajonal ose tejkufitar.

Gjithmonë kur Republika e Maqedonisë do të parashohë që ta përforcojë bashkëpunimin e saj me ndonjë prej shteteve të përmendura në nenet 12 deri në 14 më poshtë, ajo do ta informojë dhe do të konsultohet me Bashkësinë dhe me shtetet e saj anëtare, në pajtim me dispozitat e Kapitullit X.

të përmirësuar, i cili përfshin bashkëpunim ekonomik, politik, social dhe kulturor.

Politika tregtare e BE-së

Politika tregtare e BE-së në masë të madhe rrjedh nga marrëveshjet e lidhura në suaza të Organizatës botërore tregtare. Baza themelore e politikës së përbashkët tregtare është tarifa e përbashkët doganore ndaj shteteve të treta. Bashkimi Evropian ka lidhur shumë marrëveshje tregtare me shtete të treta, dhe disa prej tyre kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e marrëdhënieve tregtare, kurse marrëveshje tjera kanë të bëjnë vetëm me prodhime të caktuara ose me grupe të prodhimeve.

Marrëveshjet gjithashtu dallohen sipas përfshirjes së lehtësimeve të cilat miratohen. Kjo ka të bëjë posaçërisht me shtetet-kandidate, por përveç tyre theksohen edhe marrëveshjet e lidhura me Rusinë, Ukrainën, shtetet e Kaukazit dhe të Azisë

së Mesme, të cilat i përfshijnë fushat e tregtisë, energjetikës, transportit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, bashkëpunimit në fushën e shkencës, luftës kundër krimit dhe dialogut politik.

BE insiston që të gjitha marrëveshjet tregtare dhe marrëveshjet për bashkëpunim me partnerët të përmbajnë klauzolë për të drejtat e njeriut, e cila i siguron BE-së ndërprerje të marrëveshjes nëse konstatohet që shteti-partner i ka keqpërdorur të drejtat e njeriut.



Politika zhvillimore e BE-së

Politika zhvillimore e BE-së është e orientuar drejt zvogëlimit të varfërisë dhe reformës së strukturave sociale dhe ekonomike në shtete të treta nëpërmjet bashkëpunimit. BE dhe shtetet e saj anëtare e financojnë thuajse gjysmën e ndihmës së përgjithshme zyrtare zhvillimore ndërkombëtare. Ndihma u shpërndahet shfrytëzuesve në të gjitha kontinentet dhe, përpos për projekte për zhvillim ekonomik, i dedikohet edhe ndërtimit të institucioneve demokratike, infrastrukturës, zhvillimit të programeve makroekonomike dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Kjo ka të bëjë

Neni 12

Bashkëpunimi me shtetet tjera të cilat do ta nënshkruajnë

Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim

Jo më vonë se momenti kur së paku një Marrëveshje për stabilizim dhe asociim do të nënshkruhet prej ndonjërit prej shteteve me të cilat ka të bëjë Procesi i stabilizimit dhe asociimit, Republika e Maqedonisë do të fillojë negociata me shtetin ose shtetet e caktuara, me qëllim të nënshkrimit të konventës për bashkëpunim rajonal, qëllimi i së cilës është të rritet vëllimi i bashkëpunimit mes shteteve me të cilat ka të bëjë ajo.

Elementet kryesore të kësaj konvente do të jenë:

- dialogu politik;
- themelimi i zonës së lirë tregtare mes Palëve, të harmonizuar me dispozitat relevante të OBT-së;
- koncesionet e ndërsjella në lidhje me lëvizjen e punëtorëve, themelimin e shoqërive, dhënien e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, në nivel ekuivalent me atë të kësaj Marrëveshjeje;
- dispozitat për bashkëpunim në fusha tjera, qoftë nëse janë apo nuk janë të rregulluara me këtë Marrëveshje, veçanërisht në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme.

Kjo konventë do të përmbajë dispozita për krijim të mekanizmave të domosdoshëm institucionalë, aty ku kjo është e domosdoshme.

Kjo konventë për bashkëpunim rajonal duhet të lidhet në afat prej dy viteve pas hyrjes në fuqi së paku të Marrëveshjes së dytë për stabilizim dhe asociim. Gatishmëria e Republikës së Maqedonisë për lidhje të konventës së këtillë do të jetë kusht për zhvillim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë dhe BE-së.

posaçërisht me shtetet afrikane në jug të Saharës, por edhe me shtetet më pak të zhvilluara nga Azia dhe Amerika Latine.

Bashkimi Evropian ndan mjete të shumta financiare për ndihmë humanitare, përkatësisht për përkrahje dhe mbrojtje të njerëzve në rajonet e luftës dhe në rajonet e goditura prej katastrofave natyrore sipas principit të mosdiskriminimit (pa marrë

parasysh përkatësinë racore dhe fetare, gjininë, moshën, përkatësinë nacionale dhe përcaktimin politik). Për shembull, BE ndan 100 milionë euro në vit për ndihmë në ndërtimin e infrastrukturës dhe për kujdes për refugjatët në Palestinë.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 13

Bashkëpunimi me shtetet tjera me të cilat ka të bëjë Procesi i stabilizimit dhe asociimit

Republika e Maqedonisë do të kyçet në bashkëpunimin rajonal me shtetet tjera me të cilat ka të bëjë Procesi i stabilizimit dhe asociimit, në disa ose në të gjitha fushat e bashkëpunimit të cilat janë përfshirë me këtë Marrëveshje, veçanërisht ato në interes të përbashkët. Ky bashkëpunim duhet të jetë në pajtim me principet dhe qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 14

Bashkëpunimi me shtetet-kandidate për anëtarësim në BE

Republika e Maqedonisë mund ta përforcojë bashkëpunimin e saj rajonal dhe të lidhë konventë për bashkëpunim rajonal me cilindo shtet-kandidat për anëtarësim në BE, në të gjitha fushat e bashkëpunimit të përfshira me këtë Marrëveshje. Kjo konventë do të ketë për qëllim që gradualisht t'i përforcojë marrëdhëniet bilaterale mes Republikës së Maqedonisë dhe shtetit të caktuar në nivelin e përcaktuar të marrëdhënieve mes Bashkësisë Evropiane dhe shteteve-anëtare me këtë shtet.





A close-up, slightly blurred photograph of a hand holding a small globe of the Earth. The hand is positioned in the upper right quadrant, with fingers gently gripping the globe. The background is a soft, out-of-focus light blue and white. The overall mood is one of care and global responsibility.

POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

KAPITULLI

31

KAPITULLI 31

POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

PAQJA DHE SIGURIA NË BASHKIMIN EVROPIAN

Krijimi i jetës së përbashkët dhe adoptimi i valutës së përbashkët në BE janë shembuj për procese afatgjate, por të suksesshme të zbatimit të politikave të përbashkëta. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për BE në vitin 1993 është përcaktuar edhe një qëllim: zbatimi i Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Konfliktet rajonale pas rënies së Murit të Berlinit në vitin 1989, konfliktet në ish-Jugosllavi dhe terrorizmi ndërkombëtar e kanë vërtetuar nevojën për krijim të strategjisë dhe të instrumenteve për intervenim të përbashkët të BE-së në lidhje me çështjet e përmendura. Qëllimet themelore të Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së janë: ruajtja e vlerave të përbashkëta, vlerave themelore dhe pavarësisë së BE-së; përforcimi i sigurisë së BE-së dhe të shteteve-anëtare në të gjitha format; ruajtja e paqes dhe përforcimi i sigurisë ndërkombëtare, promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar; zhvillimi dhe përforcimi i demokracisë dhe sundimit të së drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirie themelore dhe përforcimi i identitetit të BE-së në skenën ndërkombëtare.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 7

Dialogu politik mes Palëve edhe më tutje do të zhvillohet dhe do të intensifikohet. Ai duhet ta shoqërojë dhe ta përforcojë afrimin e Bashkimit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë dhe të kontribuojë drejt krijimit të lidhjeve të afërta të solidaritetit dhe gjetjes së formave të reja të bashkëpunimit mes Palëve.

Dialogu politik është i dedikuar që të promovojë veçanërisht:

- konvergjencë më të madhe të qëndrimeve të Palëve për çështjet ndërkombëtare, veçanërisht për ato çështje për të cilat është shumë e besueshme që do të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi Palët;
- bashkëpunim rajonal dhe avancim të marrëdhënieve të mira fqinjësore;
- pikëpamje të përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin në Evropë, duke i përfshirë edhe fushat e mbuluara me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian.

Si zbatohet Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë?

Për dallim nga politikat tjera të përbashkëta të BE-së, këtu nuk aplikohen instrumente juridike, por aksione të përbashkëta, deklarata të përbashkëta dhe pozita të përbashkëta, kurse procesi i vendimmarrjes zhvillohet në nivel ndërqeveritar.

Zbatimi i kësaj politike përfshin edhe aplikim të sanksioneve ose masave restriktive të cilat BE i implementon për shtete të treta, por edhe për individë. Shembuj për masa të tilla janë: ndalimi për import të armëve, kufizimet tregtare, kufizimi për hyrje në ndonjë shtet të caktuar (vendosja e vizës), etj.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 8

Dialogu politik mund të zhvillohet në kornizë multilaterale ose si dialog rajonal, në të cilin do të kyçen shtetet tjera të Rajonit.

Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

Në periudhën para krijimit të Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, shtetet-anëtare të BE-së kanë mundur të intervenojnë vetëm si pjesë e forcave të KB-ve dhe të NATO-s, si që ka qenë rasti me veprimin në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë. Në drejtim të veprimit sa më të fuqishëm të jashtëm të BE-së dhe të krijimit të kapaciteteve autonome civile dhe ushtarake për pengim ndërkombëtar të konflikteve dhe për menaxhim të situatave të krizës, është krijuar Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes, si pjesë e Politikës së

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 9

Dialogu politik në nivel ministror do të realizohet në suaza të Këshillit për stabilizim dhe asociim, i cili do ta ketë ingjercën e përgjithshme për çfarëdo qoftë çështjeje të cilën Palët do të dëshironin t'ia parashtronë.

Me kërkesë të Palëve, dialogu politik mund të realizohet edhe në format në vijim:

- takimet, aty ku kjo është e nevojshme, e përfaqësuesve të lartë zyrtare të Republikës së Maqedonisë, nga njëra anë, dhe Kryesuesit të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe të Komisionit, nga ana tjetër;
- duke i shfrytëzuar të gjitha kanalet diplomatike mes Palëve, duke i përfshirë edhe kontaktet përkatëse në shtete të treta, si dhe në suaza të Kombeve të Bashkuara, OSBE-së dhe forumeve tjera ndërkombëtare;
- të gjitha mjetet tjera të cilat mund të japin kontribut të dobishëm për përforcimin, zhvillimin dhe shpejtimin e këtij dialogu.

përbashkët të jashtme dhe të sigurisë. Ajo definojnë aktivitetet të cilat mund t'i ndërmarrin forcat ushtarake në rast nevojë, që i nënkupton misionet humanitare dhe shpëtimtare, ruajtjen e paqes, menaxhimin e situatave të krizës dhe vendosjen e paqes. BE ka krijuar forca për reaksion të shpejtë, fuqia ushtarake e të cilave ndërtohet gradualisht gjatë disa viteve. Aksionet zbatohen në bashkëpunim me organizata të ndryshme ndërkombëtare, prej të cilave gjithsesi më të rëndësishme janë NATO, KB-të dhe OSBE (Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë).

Aksionet e para të Politikës evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes janë të lidhura me hapësirën e ish-Jugosllavisë. Njëri prej tyre, i cili ka filluar në vitin 2003 dhe zgjat edhe sot, është misioni policor i BE-së me 500 pjesëtarë në Bosnjë dhe Hercegovinë, i

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 10

Dialogu politik në nivel parlamentar do të realizohet në suaza të Komitetit parlamentar për stabilizim dhe asociim, të themeluar me Nenin 114.

cili është marrë prej forcave ndërkombëtare policore të KB-ve. Mision tjetër i tillë është zëvendësimi i forcave të NATO-s në Maqedoni (viti 2003).

Udhëheqësit e BE-së merren vesh për fushat prioritare për aksione dhe misione për veprim duke e ndjekur situatën në kontinentin evropian dhe në botë. Disa prej misioneve aktuale janë gjithsesi lufta kundër terrorizmit, strategjia për Lindjen e

Mesme, politika gjithëpërfshirëse për Bosnjën dhe Hercegovinën, si dhe zgjidhja e krizës në Kosovë. Për zgjidhje në kohë të situatave të krizës, në suaza të Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, BE ka emëruar edhe Përfaqësues të lartë për politikë të jashtme dhe të sigurisë, i cili vepron në bashkëpunim me njësitë policore për vlerësim të gjendjeve të krizës, si dhe me komitetin politik dhe të sigurisë dhe komitetin ushtarak.

Në rajonet e luftërave dhe të krizave në botë sot janë vendosur përfaqësues të posaçëm nga ana e BE-së, edhe atë në vendet në vijim: në Liqenet e Mëdha (Afrikë), në Lindjen e Afërt, në Ballkan dhe në Afganistan.





KONTROLLI FINANCIAR

KAPITULLI

32

KAPITULLI 32

KONTROLLI FINANCIAR

Mjetet financiare nga buxheti i përbashkët i BE-së mblidhen dhe shpërndahen sipas rregullave të caktuara. Sistemi për mbledhje të mjeteve në buxhetin e përbashkët nënkupton burime të financimit, për shembull, ndarje të shteteve-anëtare prej taksave të veta doganore të cilat i arkëtojnë, një pjesë të të hyrave prej TVSH-së dhe një përqindje të caktuar nga BPN i shtetit. Paratë nga buxheti i BE-së janë të dedikuara për nevoja të ndryshme: zhvillim bujqësor dhe rural, investim në projekte infrastrukturore, zhvillim të rajoneve më pak të zhvilluara të BE-së, etj.

Përpos buxhetit të përbashkët të BE-së, këtu janë edhe buxhetet nacionale të shteteve-anëtare. Me qëllim që mbledhja dhe shpërndarja e mjeteve financiare në të gjitha nivelet të funksionojë në mënyrë efikase, është organizuar sistem për kontroll në tri fusha:

- kontrolli i brendshëm financiar në sektorin publik (Public internal financial control – PIFC)
- revizioni i jashtëm
- mbrojtja e interesave financiare të BE-së.

Kapitulli 32 ka të bëjë me standardet, metodat dhe principet e pranuar në nivel ndërkombëtar të kontrollit të brendshëm financiar në tërë sektorin publik dhe kontrollit të shpenzimit të mjeteve nga fondet e Bashkimit Evropian. Ky Kapitull e përcakton edhe obligimin për themelimin dhe veprim të sistemit për menaxhim financiar, strukturës organizative në nivel nacional, por edhe mbinacional, si dhe sistemit të pavarur të revizionit të jashtëm.

Kontrolli financiar në sektorin publik

Ky lloj i kontrollit është i lidhur me kontrollin e menaxhimit financiar të mjeteve shtetërore (pa marrë parasysh se a kanë ardhur ato prej burimeve nacionale ose ndërkombëtare), me kontroll të posaçëm të shpërndarjes së mjeteve prej fondeve të BE-së.

Cilat janë qëllimet e revizionit financiar? Si pjesë e kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik, revizioni financiar e përcakton efikasitetin dhe realizimin e detyrave në proceset afariste të shfrytëzuesit buxhetor, paralajmëron për parregullsi

Neni 83

Veprimtaritë bankare, sigurimet dhe shërbimet tjera financiare

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim që të vendosin dhe të zhvillojnë kornizë përkatëse për nxitje të sektorit bankar, sektorit të sigurimeve dhe sektorit të shërbimeve financiare në Republikën e Maqedonisë.

Bashkëpunimi do të jetë i orientuar drejt:

- adoptimit të sistemit të përbashkët të kontabilitetit, në përputhje me standardet evropiane;
- përforcimit dhe ristrukturimit të sektorit bankar, sektorit të sigurimeve dhe sektorëve tjerë financiarë;
- përmirësimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimit bankar dhe të shërbimeve tjera financiare;
- këmbimit të informatave, veçanërisht në lidhje me legjislacionin që përgatitet;
- përgatitjes së përkthimeve dhe fjalorëve terminologjikë.

Palët do të bashkëpunojnë për të zhvilluar sistem efikas të revizionit financiar në Republikën e Maqedonisë, i cili do të jetë në pajtim me metodat dhe procedurat e harmonizuara të Bashkësisë.

Bashkëpunimi do të jetë i orientuar drejt:

- ndihmës teknike për Shërbimin e revizorëve të Republikës së Maqedonisë;
- themelimit të seksioneve për kontroll të brendshëm në agjencitë e shtetit;
- këmbimit të informatave në lidhje me sistemin e revizionit;
- standardizimit të dokumentacionit të revizionit;
- trajnimit dhe aktiviteteve këshillëdhënëse.

dhe mungesë të harmonizimit me aktet ligjore dhe të tjera me të cilat rregullohet puna, dhe propozon masa për mënjanim të parregullsive dhe avancim të punës. Dedikimi themelor i revizionit financiar është që të japë informatë dhe këshillë për mbajtje të rregullt të kontabilitetit dhe shfrytëzim të rregullt të mjeteve.

Revizioni i jashtëm

- Për dallim nga revizioni i brendshëm, i cili është pjesë e një institucioni të caktuar dhe i cili i informon strukturat udhëheqëse të ndërmarrjes për dobësitë dhe problemet, revizioni i jashtëm është plotësisht i pavarur nga vetë organizata, aktivitetet financiare të së cilës i analizon. Për shembull, në sektorin privat, revizioni i jashtëm i lajmëron aksionarët, kurse në sektorin publik, revizori i jashtëm i lajmëron përfaqësuesit e zgjedhur - këshilltarin lokal në nivel të pushtetit lokal - Parlamentin në nivel nacional.

Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian

Për mbrojtje të interesave financiare të Bashkimit Evropian është themeluar Zyra evropiane për luftë kundër mashtrimeve (OLAF). Ky shërbim lufton kundër korrupsionit dhe aktiviteteve tjera të paligjshme me pasoja financiare. Dënimet për keqpërdorim të mjeteve financiare nga buxheti i BE-së nënkuptojnë ndjekje nga ana e autoriteteve nacionale, procedura disiplinore, sanksione administrative dhe financiare.



DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE



KAPITULLI 33

DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 104

Me qëllim që të realizohen qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe në pajtim me nenet 3, 108 dhe 109, Republika e Maqedonisë mund të shfrytëzojë ndihmë financiare prej Bashkësisë në formë të mjeteve të pakthyeshme dhe të kredive, duke i përfshirë edhe kreditë nga Banka evropiane për investime.

Si edhe në nivel të shteteve individuale, ashtu edhe në nivel të BE-së ekziston një buxhet i vetëm i dedikuar për nevoja të ndryshme. Atë e mbushin të gjitha shtetet-anëtare, varësisht nga mundësitë.

Për çka shfrytëzohen paratë e buxhetit të BE-së?

Pjesa më e madhe e buxhetit është e dedikuar për menaxhim të resurseve natyrore, posaçërisht të bujqësisë dhe zhvillimit rural të shteteve-anëtare. Një pjesë e madhe e mjeteve financiare ndahet për zhvillim rajonal, përkatësisht për zvogëlim të dallimeve mes rajoneve të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara të BE-së (në kuptim ekonomik, shoqëror, ekologjik) dhe për projekte infrastrukturore - ndërtim të rrugëve, aeroporteve dhe limaneve detare, urave, avancim të infrastrukturës së telekomunikimeve, etj.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 105

Ndihma financiare, në formë të mjeteve të pakthyeshme, do të realizohet me masat operative të përcaktuara në rregullativën përkatëse të Këshillit në formë të kornizës shumëvjeçare të vendosur nga ana e Bashkësisë pas konsultimeve të kryera me Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi i tërësishëm i ndihmës, në formë të ndërtimit të institucioneve dhe investimeve, duhet të kontribuojë për reforma demokratike, ekonomike dhe institucionale në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me procesin e stabilizimit dhe asociimit. Ndihma financiare mund të shfrytëzohet për të gjitha fushat e harmonizimit të legjislacionit dhe politikës së bashkëpunimit nga kjo Marrëveshje, duke i përfshirë edhe drejtësinë dhe punët e brendshme. Do të shqyrtohet zbatimi i plotë i projekteve infrastrukturore në interes të ndërsjellë, të identifikuar në Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e komunikacionit.

Përpos kësaj, BE merr pjesë në financimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të shteteve në mbarë botën të cilat nuk janë anëtare (shtetet e varfra afrikane, shtetet e Karaibeve dhe të Paqësorit), ndan mjete për shtetet-kandidate, kurse e ndihmon edhe zhvillimin e shteteve mesdhetare - partnere ekonomike.

Kapitulli 33 i negociatave i përfshin rregullat për mjetet vetjake të cilat paraqesin të hyra financiare për buxhetin e BE-së.

Burimet e mjeteve për buxhetin e Bashkimit Evropian

Ky Kapitull përmban rregulla për ndarje të mjeteve për buxhetin e BE-së. Ekzistojnë katër lloje të mjeteve:

- Taksa bujqësore dhe taksa të sheqerit, të cilat përfshijnë taksa doganore të cilat arkëtohen gjatë importit të prodhimeve bujqësore, izoglukoze dhe shurupit të insulinës, të cilat aplikohen për prodhuesit e sheqerit prej shteteve të cilat nuk janë anëtare të BE-së.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 106

Me kërkesë të Republikës së Maqedonisë dhe në rast të nevojave të posaçme, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare, Bashkësia mund ta shqyrtojë mundësinë për ndarje të ndihmës makro-financiare në baza të jashtëzakonshme, që do t'i nënshtrohet kushteve të caktuara, duke e marrë parasysh, aty ku kjo është e mundshme, të qenët në dispozicion të të gjitha resurseve financiare.

- Taksat doganore, të cilat arkëtohen në kufijtë e jashtëm të BE-së gjatë importit të mallrave prej shteteve të cilat nuk janë anëtare.

Llojet e përmendura të taksave quhen mjete tradicionale vetjake dhe mbulojnë 15% të të hyrave në buxhetin e BE-së. Prej mjeteve të arkëtuara financiare, shtetet-anëtare mbajnë 25% në buxhetet e tyre nacionale, kurse 75% ndahen në buxhetin e BE-së.

Prej burimeve tjera të shteteve-anëtare, në buxhetin e BE-së ndahet pjesë më e vogël. Ato janë:

- Pagesat në bazë të të hyrave nga TVSH. Bëhet fjalë për kontribute financiare të shteteve-anëtare në lartësi prej 0,5% të të hyrave nga TVSH sipas bazës së harmonizuar tatimore.
- Pagesat në bazë të lartësisë së bruto prodhimit nacional (BPN) të shtetit-anëtar, dhe meqenëse BPN është masë për pasurinë nacionale, secili shtet-anëtar kontribuon në buxhet në pajtim me mundësitë e veta.

Mjetet vetjake prej të hyrave në bazë të TVSH-së përfshijnë rreth 35% të të hyrave në buxhetin e BE-së, kurse të hyrat në bazë të lartësisë së bruto prodhimit nacional e formojnë thujse gjysmën e të hyrave buxhetore të BE-së.

Për mjetet të cilat në buxhet i ndajnë shtetet-anëtare mund të thuhet që janë forma të ndryshme të tatimeve të shteteve-anëtare. Për shembull, mjetet financiare të mbledhura prej akcizave për import të prodhimeve bujqësore në Mbretërinë e Bashkuar mund të shpenzohen për përkrahje të ringjalljes dhe ndërtimit të rrjeteve rrugore në rajonet rurale në Bullgari, etj.

Ndarja e një pjese të BPN-së është burimi më i ri i mjeteve për buxhetin e BE-së, i adoptuar në vitin 1988, për dy arsye: për shkak të zgjerimit të përgjegjësisë së BE-së dhe mundësitit të tregtisë më të lirë ndërkombëtare (zvogëlimi i të hyrave prej doganave dhe akcizave). Obligim i shteteve-anëtare, në kuptim të respektimit të rregullave në lidhje me dispozitat financiare dhe buxhetore të Bashkimit Evropian, është që të krijojnë infrastrukturë përkatëse administrative, të nevojshme për koordinim dhe sigurim të llogaritjes së rregullt dhe të saktë, mbledhjes, pagesës dhe kontrollit të mjeteve vetjake.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 106

Me kërkesë të Republikës së Maqedonisë dhe në rast të nevojave të posaçme, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare, Bashkësia mund ta shqyrtojë mundësinë për ndarje të ndihmës makro-financiare në baza të jashtëzakonshme, që do t'i nënshtrohet kushteve të caktuara, duke e marrë parasysh, aty ku kjo është e mundshme, të qenët në dispozicion të të gjitha resurseve financiare.





INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN



KAPITULLI 34

INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 108

Me këtë themelohet Këshill për stabilizim dhe asociim i cili do të ushtrojë mbikëqyrje të aplikimit dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Ai do të mbajë takime në nivel përkatës në intervale të rregullta dhe kur këtë e kërkojnë rrethanat. Ai do të shqyrtojë çfarëdo qoftë çështjesh më të rëndësishme të përfshira në këtë Marrëveshje, si dhe çfarëdo qoftë çështjesh tjera bilaterale ose ndërkombëtare në interes të ndërsjellë.

Sipas studimit të cilin e ka realizuar Komisioni Evropian në disa muajt e kaluar, kanë arritur padi të disa mijëra udhëtarëve të cilët pohojnë që nuk respektohen të drejtat e tyre. Ndonjëherë kompanitë ajrore kanë refuzuar të paguajnë dëmshpërblim, kurse në raste tjera zyra nacionale për kontroll ka vërejtur shkelje, por prapëseprapë nuk janë respektuar kërkesat e udhëtarëve. Prej gjithsej 18.000 padive të cilat kanë arritur në Komisionin Evropian, më së shumti kanë qenë prej Mbretërisë së Bashkuar (6.090), pastaj prej Francës (2.700) dhe Italisë (2.557), kurse më së paku prej Letonisë (24), Luksemburgut (15) dhe Maltës (13). Me qëllim që udhëtarët në komunikacionin ajror të munden përfundimisht, shpejt dhe me procedurë të shkurtë ta marrin të drejtën e garantuar me ligj për shembull për shkak të vonesës së fluturimeve, Komisioni Evropian u ka dhënë ultimatum kompanive ajrore evropiane. Parlamenti Evropian ka miratuar

një ligj me të cilin prej vitit 2009 ndalohet shumica e testimeve të kozmetikës te kafshët, si dhe shitja në BE e kozmetikës e cila është testuar te kafshët në ndonjë vend tjetër. Gjykata evropiane e drejtësisë u ka dhënë të drejtë shteteve të imponojnë ndalim për shitje të barërave me recetë nëpërmjet internet-barnatoreve, duke përfunduar që në këtë mënyrë shitja do ta vështirësonte përdorimin e drejtë të barërave.

Në shtypin ditor çdo ditë hasim artikuj të këtyllë dhe të ngjashëm. Por cili është në të vërtetë roli i Parlamentit Evropian, Komisionit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian dhe institucioneve tjera?

Kapitulli 34 ka të bëjë me strukturën dhe veprimin e institucioneve dhe trupave të BE-së. Në procesin e stabilizimit dhe asociimit, shtetet-kandidate duhet të adaptohen ndaj rregullave të BE-së për të siguruar përfaqësim të barabartë të atyre shteteve në institucionet e BE-së (Parlamenti Evropian, Komisioni Evropian, Gjykata evropiane e drejtësisë) dhe në trupat tjerë, me çka do të sigurohej funksionim efikas i sistemit të sjelljes së vendimeve, zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, etj.

Edhe pse rregullat e BE-së nga ky kapitull nuk ndikojnë mbi organizimin e brendshëm të shteteve, shtetet-kandidate duhet patjetër të jenë të përgatitura që në tërësi të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në BE me themelim të trupave dhe mekanizmave të nevojshëm në nivel nacional dhe zgjedhje të përfaqësuesve për institucionet në BE.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIMA

Neni 109

Këshilli për stabilizim dhe asociim do të përbëhet prej anëtarëve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të Komisionit të Bashkësive Evropiane, nga njëra anë, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga ana tjetër.

Këshilli për stabilizim dhe asociim do të miratojë rregulloren për punë.

Është e mundshme që anëtarët e Këshillit për stabilizim dhe asociim të jenë të përfaqësuar me të tjerë, në pajtim me kushtet të cilat do të parashihen në rregulloren e tij për punë.

Këshillin për stabilizim dhe asociim do ta kryesojë, në mënyrë të njëpasnjëshme, përfaqësues nga Bashkësia Evropiane dhe përfaqësues nga Republika e Maqedonisë, në pajtim me dispozitat të cilat do të përcaktohen në rregulloren e tij për punë.

Sa u përket çështjeve të cilat kanë të bëjnë me të, në punën e Këshillit për stabilizim dhe asociim do të marrë pjesë edhe Banka evropiane për investime, si vëzhguese.

Ajo sipas së cilës ky kapitull dallohet prej kapitujve tjerë është që prej shteteve-kandidate nuk kërkohet harmonizim juridik në periudhën para anëtarësimit. Pas përfundimit të negociatave për anëtarësim, në periudhën deri në vetë anëtarësimin, sigurohet integrim i shtetit-kandidat në strukturat e BE-së nëpërmjet procedurave të informimit dhe konsultimeve.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 110

Për t'u arritur qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli për stabilizim dhe asociim do të ketë autorizim të marrë vendime në suaza të Marrëveshjes në rastet e parapara në të. Vendimet e miratuara do të jenë të obligueshme për palët, të cilat do t'i ndërmarrin masat e domosdoshme për zbatim të vendimeve të miratuara në këtë mënyrë. Kur do të vendoset për kalimin në fazën e dytë, si që është paraparë në nenin 5, Këshilli për stabilizim dhe asociim gjithashtu mund të vendosë për çfarëdo qoftë ndryshimesh të mundshme në lidhje me përmbajtjen e dispozitave të cilat e rregullojnë fazën e dytë.

Në rregulloren e tij për punë, Këshilli për stabilizim dhe asociim do t'i përcaktojë obligimet e Komitetit për stabilizim dhe asociim, të cilat do ta përfshijnë përgatitjen e takimeve të Këshillit për stabilizim dhe asociim, dhe do të vendosë edhe si do të funksionojë Komiteti.

Këshilli për stabilizim dhe asociim mund t'ia bartë cilindo autorizim të vet Komitetit për stabilizim dhe asociim. Në rast të tillë, Komiteti për stabilizim dhe asociim do t'i marrë vendimet e veta në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

Këshilli për stabilizim dhe asociim gjithashtu mund të miratojë rekomandime përkatëse. Ai do t'i miratojë vendimet dhe rekomandimet e veta me marrëveshje mes Palëve.

Këshilli i Bashkimit Evropian (Council of the EU)

Këshilli i Bashkimit Evropian ose Këshilli i ministrave është institucioni më i lartë ligjdhënës i BE-së dhe përbëhet prej ministrave të qeverive nacionale të shteteve-anëtare. Këtu, në nivel evropian janë të përfaqësuar interesat nacionale, kurse rolin e vet ligjdhënës e ndan me Parlamentin Evropian.

Përbërja e Këshillit të BE-së ndryshon varësisht nga fusha për të cilën vendoset. Nëse vendoset për çështje për mbrojtjen e mjedisit jetësor, në Këshill marrin pjesë ministrat për mbrojtje të mjedisit jetësor të shteteve-anëtare, kurse nëse bëhet fjalë për zhvillimin rural, do të takohen ministrat për bujqësi ose resorë tjerë përkatës të qeverive nacionale.

Duke e pasur parasysh atë që ministrat në Këshillin e BE-së janë njëkohësisht edhe ministra në qeveritë e tyre nacionale, Këshilli i BE-së mban takime vetëm kohë pas kohe. Me qëllim që të ekzistojë punë e vazhdueshme, është themeluar Komiteti i përfaqësuesve të përhershëm – KOREPER (COREPER - Comité des Représentants Permanents). Para vendimmarrjes për ndonjë çështje në Këshillin e BE-së, për atë çështje diskutohet dhe votohet në KOREPER. Në rast se nuk ka vështirësi gjatë votimit në KOREPER, ministrat në Këshillin e BE-së nuk diskutojnë për atë çështje.

Komisioni Evropian (European Commission) - kush, çka, si?

Për Komisionin shpeshherë thuhet që është institucioni “më evropian” në BE për shkak të veçorive të tij mbishtetërore. Anëtarët e tij, të zgjedhur prej shteteve-anëtare, nuk i promovojnë interesat nacionale, por interesat e BE-së. Secili anëtar merr nga një resor të Komisionit, dhe ai quhet Drejtori e

përgjithshme (Directorate General – DG). Kështu, për shembull, Marien Fisher Boel është komisar i Komisionit Evropian për bujqësi dhe zhvillim rural, kurse Jan Figel është komisar për arsim, trajnim, kulturë dhe të rinj.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 111

Secila Palë mund të parashtrorë çfarëdo qoftë kundërshtimi para Këshillit për stabilizim dhe asociim në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli për stabilizim dhe asociim mund ta zgjidhë kontestin nëpërmjet vendimit të obligueshëm.

Funksionet më të rëndësishme të Komisionit janë formulimi i politikës së BE-së dhe inicimi i procedurave ligjdhënëse. Edhe pse ai është trup ekzekutiv i BE-së, ekzekutimi i politikave të BE-së kryesisht u lihet trupave të shteteve-anëtare, me vërejtje që Komisioni mbikëqyr se a i realizojnë shtetet-anëtare obligimet të cilat rrjedhin prej normave të miratuara në nivel evropian.

Si funksionon Parlamenti Evropian (European Parliament) dhe kush është deputet në të?

Me marrëveshjen për themelimin të BE-së, shteteve-anëtare u janë ndarë vende të deputetëve në Parlamentin Evropian, të cilat në masë të caktuar janë proporcionale me numrin e banorëve të shtetit-anëtar. Kështu, Gjermania ka 99 deputetë, Italia, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar nga 78 deputetë, Rumania ka 35, kurse pesë deputetë vijnë nga Malta.

Neni 112

Në kryerjen e obligimeve, Këshillit për stabilizim dhe asociim do t'i ndihmojë Komiteti për stabilizim dhe asociim, komiteti i përbashkët i përbërë prej përfaqësuesve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesve të Komisionit të Bashkësive Evropiane, nga njëra anë, dhe prej përfaqësuesve të Republikës së Maqedonisë, nga ana tjetër.

Zgjedhjet mbahen çdo pesë vjet, kurse selia e Parlamentit Evropian është në Strasburg.

Edhe pse deputetët zgjidhen sipas kuotave nacionale, në nivel evropian ata nuk janë të organizuar në bazë nacionale, por sipas përcaktimeve politike, për shkak se partitë e ngjashme nacionale politike janë të organizuara në parti evropiane. Kështu, për shembull, partitë nacionale me orientim demokratik-kristian e formojnë Partinë popullore evropiane, etj.

Parlamenti Evropian ka tri funksione:

- Ligjdhënës
- Kontrollues (mbi Komisionin Evropian)
Adoptimi i buxhetit të BE-së

Parlamenti sot ka rol të vërtetë ligjdhënës, përveç në çështje të caktuara siç janë Politika

e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë dhe bashkëpunimi policor dhe gjyqësor. Kontrolli mbi Komisionin Evropian e përfshin vërtetimin e përbërjes së Komisionit Evropian, si dhe të kryetarit të saj, kurse Komisioni gjithashtu është i obliguar ta informojë Parlamentin për punën e vet. Buxhetin e BE-së e propozon Komisioni Evropian, kurse bashkërisht e adoptojnë Parlamenti dhe Këshilli i BE-së.

Cilat janë funksionet e Gjykatës evropiane të drejtësisë? (European Court of Justice)

Gjykata evropiane e drejtësisë është institucion i përbërë prej dy gjykatave: Gjykata e Bashkësive Evropiane dhe Gjykata e shkallës së parë. Roli i gjykatës është formimi i rendit juridik të BE-së dhe respektimi i të drejtave. Me çka merret Gjykata e Bashkësive Evropiane? Për shembull, është e autorizuar për përcaktim të asaj se a e shkel ndonjë shtet-anëtar obligimin e bazuar në të drejtën e Bashkësisë Evropiane, për mbajtje të procedurave për shkak të lëshimit të ndonjë institucioni të BE-së, për miratim të aktit të cilin si institucion ka obligim ta miratojë, etj.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIIM

Neni 113

Komiteti për stabilizim dhe asociim mund të themelojë nën-komitete.

Komiteti për komunikacion, i themeluar sipas Marrëveshjes në fushën e komunikacionit, do t'i ndihmojë Komitetit për stabilizim dhe asociim.



PËR ÇËSHJET TJERA

KAPITULLI 35

PËR ÇËSHTJET TJERA

Kapitulli i fundit quhet “Çështjet tjera” dhe zgjidhet në fund të procesit të negociatave. Ai përfshin çështje të cilat nuk kanë mundur të paraqiten gjatë negociatave, dhe nuk janë përfshirë në suaza të ndonjë prej kapitujve tjerë.

Në rastin e Kroacisë, një çështje e tillë e inicuar nga BE në lidhje me shkencën dhe hulumtimin është pritja që Kroacia të marrë pjesë në Fondin hulumtues për thëngjill dhe çelik (Research Fund for Coal and Steel – RFCS). Për këtë çështje dhe për llogaritjen precize për pjesëmarrjen e Kroacisë në fondin e përmendur do të diskutohet pikërisht në kapitullin “Çështjet tjera”.

Për çka shërben Fondi hulumtues për thëngjill dhe çelik?

Është themeluar në vitin 2002 për nxitje të hulumtimit dhe krijim të teknologjive të reja të prodhimit dhe shfrytëzimit të tyre. Thëngjilli si burim i energjisë është në dispozicion në sasi të mëdha dhe është burim i rreth 40% të energjisë elektrike në botë. Sipas kësaj, qëllimi i këtij Fondi është hulumtimi (dhe gjetja) e teknologjive të reja, të pastra për përpunim të tij me zvogëlim të emetimit të dyoksid karbonit në

atmosferë. Edhe pse Evropa është në vendin e parë në botë sipas prodhimit të çelikut, ky Fond ka për synim të avancohet metalurgjia e zezë evropiane, dhe me këtë ajo të bëhet më konkurrenente në raport me ekonominë në rritje nga Azia Lindore.

Informata më të detajuara për programin janë në dispozicion në Internet faqen zyrtare të Bashkimit Evropian <ftp://ftp.cor-dis.europa.eu/pub/coal-steel-rtd/docs/rfcs-brief.pdf>

Implementimi i klauzolave mbrojtëse në Kapitullin “Çështjet tjera”

Në këtë Kapitull, në rastin e zgjerimit të BE-së në vitin 2004, janë implementuar tri klauzola mbrojtëse:

- Klauzola të përgjithshme ekonomike
- Klauzola të posaçme mbrojtëse të cilat kanë të bëjnë me tregun e brendshëm
- Klauzola të posaçme mbrojtëse të gjyqësisë dhe të punëve të brendshme.

Klauzola e përgjithshme mbrojtëse ekonomike i përfshin të gjithë sektorët e ekonomisë ose gjenden ekonomike në një fushë të caktuar në shtetet “e vjetra”

dhe “të reja” anëtare. Klauzola mbrojtëse për tregun e brendshëm i përfshin të gjitha politikat sektoriale të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet ekonomike me efekte tejkufitare, kurse klauzola mbrojtëse në fushën e gjyqësisë dhe të punëve të brendshme përfshin njohje të ndërsjellë në fushën e të drejtës penale dhe në lëndët civile.

Klauzolat mbrojtëse të cilat kanë të bëjnë me tregun e brendshëm dhe me gjyqësinë dhe punët e brendshme aplikohen vetëm për shtetet “e reja” anëtare, me vërejtje që masat mbrojtëse mund të ndërmerren deri në kalimin e periudhës trevjeçare pas anëtarësimit sipas klauzolave të lartpërmendura, por mund të mbesin në fuqi edhe pas asaj periudhe.

